

BULETINI  
I SHKENCAVE  
GJEOLLOGJIKE

VITI IX (XXVI) I BOTIMIT

4  
1990

Tiranë

# **BULETINI I SHKENCAVE GJEOLOGJIKE**

**ORGAN I PËRBASHKËT I INSTITUTIT TË STUDIMEVE  
DHE TË PROJEKTIMEVE TË GJEOLOGJISË DHE I FAKULTETIT  
TË GJEOLOGJISË DHE TË MINIERAVE TË UNIVERSITETIT  
TË TIRANËS «ENVER HOXHA».**

**4**

**REDAKSIA:** A. Kodra (kand. shk. gjeol.) — Kryeredaktor. S. Meço (Dr. i shkencave) — Zv/kryeredaktor, A. Serjani (Kand. shk. gjeol.) — Sekretar BOARD: A. Çina (Docent) anëtar; A. Xhomo (Bashkëp. shkencor) anëtar; A. Tashko (Docent) anëtar; B. Ostrosi (Docent) anëtar; Ç. Durmishi (Kand. shk. gjeol.) anëtar; I. Tafilaj (inxh. hidrogeolog) anëtar; K. Gjata (Bashk. vj. shkencor) anëtar; K. Karabina (Bashk. shkencor) anëtar; M. Zaçaj (Kand. shk. gjeol.) anëtar; M. Shallo (Bashk. vj. shkencor); P. Pashko (Bashk. shkencor) anëtar; R. Avxhiu (Bashk. shkencor) anëtar.

**Abonimet brënda vendit:**

Për 1 vit 20 lekë. Për 6 muaj 10 lekë. Çmimi për një copë 5 lekë.  
Abonimet bëhen pranë zyrave të PTT.

**Subscription rates abroad:**

Individuals .....	US \$ 20 per year
Companies .....	US \$ 40 per year
Price per copy .....	US \$ 3

Addres to the Board.

Adresa e Redaksisë: Redaksia e Buletinit të Shkencave Gjeologjike

Addres of the Board:

Pranë Institutit të Studimeve dhe të Projekteve  
të Gjeologjisë, blloku «Vasil Shanto» TIRANË.

Telefon 2-20-34, 2-25-11  
Telex 4204 Mimen ab

Tirazhi: 500 kopje

Formati: 70x100/16

Stash. 2204-72

Shtypur: Kombinati Poligrafik.  
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1990

**STUDIMET GJEOFIZIKE NËNTOKËSORE DUHET TË ZENË VENDIN E DUHUR NË KOMPLEKSEN E ZBULIMIT GJEOLGJIK TË VENDBURIMEVE TË KROMIT DHE TË BAKRIT****Llambi Langora\***

Në këtë artikull argumentohet nevoja e zgjerimit dhe e thellimit të studimeve gjeofizike nëntokësore, si një nga rrugët për të rritur më tej efektivitetin e zbulimit gjeologjik të vendburimeve të kromit dhe të bakrit. Analizohen detyrat e shtruarë për zgjidhje përpara gjeofizikës nëntokësore dhe mundsësitë e aftësitetë e saj zgjidhëse. Tregohen drejtimet kryesore të zhvillimit të gjeofizikës nëntokësore në të ardhmen.

Shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve të dobishme të ngurtë ze peshë të ndjeshme në ekonominë e vendit tonë. Lidhur me këtë, shtimi i rezervave industriale dhe gjeologjike është detyrë e rëndësishme për të cilën bëhen investime të mëdha. Kërkimi dhe zbulimi i vendburimeve të mineraleve të dobishme bëhet nëpërmjet punimeve minerare dhe shpimeve të cilat kanë kosto të lartë dhe kohëzgjatje të madhe. Për të rritur efektivitetin ekonomik të zbulimit të vendburimeve, duhet të zgjedhjët në maksimum numri i shpimeve jorezultativë, të rrallohet sa të jetë e mundur rrjeti i shpimeve të kërkim-zbulimit dhe të përshpejtohet procesi i kryerjes së tyre.

Pra, problemi që shtrohet është i gjërë dhe kompleks. Ai kërkon jo vetëm rritjen e mëtejshme cilësore të interpretimit të të dhënave të metodave gjeologjike, gjeokimike dhe gjeofizike, të cilat përdoren në projektimin e shpimeve të kërkim-zbulimit, por sidomos zhvillimin dhe përsosjen e metodave analoge që zbatohen për të studjuar trungun e shpimit dhe rreth tij.

Më poshtë ne do të ndalem më me hollësi në rolin që duhet të luajnë metodat e gjeofizikës nëntokësore, mbasi zhvillimi dhe thellimi në interpretimin e të dhënave të tyre është një nga rrugët kryesore për zgjidhjen e detyrave të mësipërme. Kërkim-zbulimi i vendburimeve realizohet kryesisht me shpime, që për teknologjinë e soime, lidhur dhe me karakteristikat fiziko-mekanike të formacioneve që shpohen, shpesh nxjerin vështirësi të theksuara, deri në mungesë të plotë informacioni

\* Ndërmarrja Gjeofizike në Tiranë.

për zonat e trupat e mineralizuar. Vështirësitë kryesore rrjedhin për arsyet tekologjisë së shpimit, të kualifikimit të pamjaftueshmët të personelit teknik dhe për shkak të veticë fiziko-mekanike të shkëmbinjeve, të cilat ndryshojnë nga një zonë te tjetra.

Në pasqyrën nr. 1 jepen në mënyrë të mesatruar përqindjet e nxjerrjes së kampioneve për disa nga vendburimet e baktit në vendin tonë.

Përqindja e nxjerrjes së kampion.	Pasqyra nr. 1					
	Pesha që zenë përqindjet sipas vendburimeve në %					
	Vendburim e					
Rubik	Palaj	Perlati verior	Perlati jugor	Helshan	Golaj	
40	12%	27%	13%	44%	52%	-
40 - 50	-	7	20	55	18	-
50 - 60	41	-	-	11	17	11
60 - 70	-	33	47	-	13	-
70 - 80	-	13	-	17	-	19
80 - 90	-	-	-	-	-	27
90 - 100	47	20	20	22	-	43

Përqindja e daljes së kampioneve luhatet në kufij të gjërë. Është me interes të theksohet, se në 66% të vendburimeve vetëm në rrëth 20% të shpimeve nxjerra e kampionaturës mund të quhet e kënaqëshme. Nga ana tjetër në rrëth 25% të numrit të përgjithshëm të shpimeve të kryera, nxjerra e kampionit është e pamjaftueshme. Vetëm në rrëth 55% të puseve të kryera, nxjerra e kampioneve është në masën 50-70% të metrazhit të shpuar. Kampionet në të shumtën e rasteve nuk dalin, pikërisht kur shpimet presin intervalt e zonave e të trupave të mineralizuar, nga që ato janë edhe më të përpunuaraat nga pikpamja fiziko-mekanike.

Pasoja e parë negative është, përcaktimi i pasaktë i trashësisë së trupave të mineralizuar, përrnjehojë edhe llogaritja e rezervave.

Nga një studim i kryer për trashësitë e trupave të mineralizuara të përcaktuara nga kampionnxjerra e shpimeve të krahasuara me ato të karotazhit dhe të kontrolluara nga punimet hapëse minerare vërtetohet gjëndja e paraqitur në tabelën 2.

Në të gjitha rastet, trashësitë e trupave të mineralizuar të përcaktuara nga karotazhi janë më të sakta dhe 1.12 deri 3.6 herë më të mëdha se ato të përcaktuara nga kampionet e shpimeve.

Nisur nga kjo, është me vend shtrirja e detyrueshme e procesit të studimit të trungut të shpimeve me metodat gjeofizike të pusit.

Zgjidhjet teorike të njohura dhe përvoya nga vendi ynë, tregojnë se trashësitë e zonave dhe trupave të mineralizuara sulfurorë të baktit mund të përcaktohen me satkësi me metodat gjeofizike. Për këtë, kompleksi më i mirë përbëhet nga metodat e rezistencës elektrike specifike, të fushës elektrike natyrore si dhe të gama rezatimit të difuzuar. Të dhënat e këtyre metodave mund të përdoren edhe për veçinat.

Tabela nr. 2

Raporti i trash. sipas karotazhit dhe kamp. në herë				
Vendburimi				
Rubik	Palaj	Perlati verior	Perlati jugor	Perlati jugor
40	2.6	3.6	2.8	2.6
40 - 50	1.6	2	2	1.85
50 - 60	-	1.48	1.46	1.57
60 - 70	-	-	-	-
70 - 80	-	1.26	-	1.27
80 - 90	1.15	-	-	-
90 - 100	-	1.03	1.0	1.04

min e pjesëve me mineralizim më të koncentruar, brenda zonave minrale edhe kur pasurimi bëhet në mënyrë të doradorshme. Duke shfrytëzuar ndryshimet e dendësisë dhe të predispozitetit magnetik të trupave të kromit ndaj shkëmbinje rrethues, metodat gjeofizike janë të dhëna të sakta edhe në procesin e kërkim-zbulimit të kromit. Komplekse optimale të metodave gjeofizike të pusit mund të përcaktohen edhe për mineralet e dobishme të tjera.

Përparimet e bëra kohët e fundit kanë hapur mundësinë e përdorimit të metodave gjeofizike edhe për vlerësimin sasior të komponentëve të dobishëm në trupat xeherorë sulfurorë, në ato të kromit e të tjera. Kjo mund të arrihet ose nga studimi i koreacioneve ndërmjet variacioneve të parametrave të vrojtuar në funksion të përbajtjeve të komponentëve mineralë të dobishëm, ose drejtpërsëdrejti me zbatimin e disa metodave bërtimore, sikurse janë metoda e gama rezatimit të difuzuar, metoda Neutron-gama dhe ajo e aktivimit neutronik.

Nga përcaktimi i saktë i trashësisë së trupave të mineralizuar nëpërmjet metodave gjeofizike arrihet në gjeometrizime të sakta të formës dhe madhësisë së trupave xeherorë dhe përrnjehojë edhe në llogaritjen e rezervave.

Studimi i bërë në vendburimin e Perlatis jugor tregon, se vetëm përfektë të korigjimit të trashësive të trupave të mineralizuar, bazuar në të dhënat e karotazhit, rezervat e llogaritura u rritën mbi 15%.

Në rajonet ku dalja e kampionit është veçanërisht e vështirë, prerjet gjeologjike deshifrohen me vështirësi. Dokumentimi në bazë të shllamit të nxjerrë nga puset, nuk është i saktë mbasi ai nuk ruani strukturën dhe teksturen e shkëmbit dhe nuk mund të bëhen përcaktimi të sakta të nivelit që përfaqëson. Në të tilla raste studimi i prerjes litologjike, ndjekja e formacioneve në shtrirje e rënje dhe aq më tepër përcaktimi e ndjekja e reperëve litqstratigrafikë udhëzues bëhet tepër i vështirë.

Vetëm duke përdorur metodat gjeofizike të pusit këto vështirësi mund të kapércehen dhe të bëhen intepretime të sakta. Shkëmbinjtë

kanë veti fizike të ndryshme. Për shembull në mjediset periferike të ofioliteve, në prerjen vulkanosedimentare, shkëmbinjtë karbonatikë të bazamentit ( $Tr_3-J_1$ ) kanë rezistencë elektrike specifike shumë të lartë, frejtë 8000 omm, janë jomagnetike, kanë polarizeushmëri shumë të dobët dhe radiacioni të ulët, të rendit 8 Mkr/orë.

Seria vulkanosedimentare, ka rezistencë elektrike specifike të mesatarizuar, shumë më të ulët 80-100 omm, është paramagnetike e dobët dhe me aftësi polarizimi dhe radiacioni dy herë më të lartë se gjelqerorët e bazamentit. Në ndryshim me këta, ultramafikët që vendosen tektonikisht mbi vulkanosedimentarët, kanë rezistencë elektrike specifike të mesatarizuar 100-400 omm, janë magnetikë mesatarë dhe polarizohen deri 10 herë më tepër. Është e qartë se metodat e rezistencës elektrike, ajo e polarizimit të provokuar, magnetometria dhe ato radiometrike, janë në gjëndje të bëjnë dallime të qarta të kolonës litologjike të trungut të shpimit, pa qenë nevoja e nxjerrjes së kampioneve. Bile edhe brenda serisë së shkëmbinjve vollkanosedimentarë për nga rezistenca dhe radiacioni, rreshpet dallohen qartë nga derdhjet vullkanike e kështu me radhë.

Duke shfrytëzuar vetitë specifike të magnetizmit të radiacionit dhe më pak ato të rezistencës elektrike dhe të polarizueshmërisë, kompleksi i metodave gjeofizike mund të ndajë llojet shkëmbore, shkallën e serpentinizimit dhe shtratimet e kromit si në sekuençat kumulative po ashtu edhe në ato tektonite të ultrabajzikëve.

Një problem i shtruar për zgjidhje e që paraqet interes ekonomik është studimi i mundësive që një përqindje sa më e madhe e shpimeve të kërkim-zbulimit të kryhet me ballë të plotë. Shpimi me ballë të plotë ka përparësinë që kryhet me shpejtësi më se dy herë më të madhe kushton më lirë. Kalimi i një pjesë të shpimeve me ballë të plotë është krejtësisht i mundshëm, duke patur parasysh arsenalin e madh të metodave gjeofizike dhe aftësitë e tyre zgjidhëse. Duke bërë një kombinim ndërmjet shpimeve që kryhen me marrje kampioni dhe atyre me ballë të plotë, në të parët kemi mundësi të realizojmë korelationet e nevojshme midis parametrave të vrojtuara me metodat gjeofizike dhe treguesve gjeologjikë, që sigurohen nga studimi i kampioneve. Këto të dhëna mund t'i shfrytëzojmë për të bërë interpretimet të sakta në shpimet me ballë të plotë, ku mund të ndrëtojmë kolonën litologjike me praninë ose jo të trupave të mineralizuar. Sikurse përmendëm, kompleksit të zakonshëm të metodave gjeofizike, mund dhe duhet t'u shtohen ato bërtimore që jepin zgjidhje sasiore për përbajtjen e komponentëve të mineralete të dobishëm. Rrethi i problemeve gjeologjike që mund të zgjidhen nëpërmjet të dhënave gjeofizike të studimit të trungut të shpimit me ato rrëth tij e, sipas rastit, edhe me ato sipërfaqësore është mjaftë i gjërë.

Kombinime të tillë janë përdorur me sukses për studimin e ndërtimit gjeologo-strukturor të mjediseve në periferi të ofioliteve, për të sqaruar pozicionin dhe marrëdhëniet e serisë vulkanosedimentare me shkëmbinjtë rrethues, apo në brendësi, për studimin e masivëve ultrabajzikë ose krahët e tyre etj.

Variacioni i madh i veteve fizike të shkëmbinjve dhe ndryshimi i

tyre me ato të trupave të mineralizuar bën të mundur përdorimin e metodave gjeofizike për studimin e strukturave parësore të vendburimeve të bakrit e të kromit.

Një ndihmë të çmuar ky kompleks jep për studimin e efekteve që rrjedhin prej tektonikës shkëputëse, e cila nxjerr shumë probleme në kërkim-zbulimin e trupave xehlerorë, veçanërisht atyre të kromit. Një pjesë e mirë e shpimeve të kërkim-zbulimit bien në hapje tektonike dhe dalin me rezultate negative. Përveç ulejs së rendimentit ekonomik të zbulimit, rezultatet negative krijojnë vështirësi serioze në lidhjet e trupave nga shpimi në shpim dhe në përgjithësi, në gjeometrizimin e trupave mineralë. Në këto raste metodat gjeofizike, si ato të trungut dhe ato rrëth tij, janë të pazëvendësueshme për të gjykuar mbi pozicionet e pjesëve të trupit xehleror të këputur dhe të zhvendosur nga tektonika e për rrjedhojë në orientimin e shpimeve të kërkim-zbulimit. Është me vend që këto metoda të zbatohen në shpime të posaçme dhe në punimet minerare, gjatë shfrytëzimit të vendburimeve, për të orientuar drejt punimet përgatitore të shfrytëzimit. Metodat gjeofizike jepin ndihmë të vlefshme edhe për të studjuar presionet shtresore, gjëndjen e strukturave konstruktive, lëvizjen dhe debitin e ujраве, etj. të dhëna me shumë rëndësi në procesin e shfrytëzimit të minierave.

Metodat e gjeofizikës nëntokësore po përdoren gjithnjë e më tepër në studimin e problemeve që kanë të bëjnë me karakterin dhe morfoluginë e mineralizimit. Me vlerë janë të dhënat shtesë për ndjekjen në shtrirje dhe rënie të trupave xehlerorë, të cilat mund të shfrytëzohen për studimin e natyrës gjenetike të mylljeve të trupave xehlerorë, për praninë ose jo të trupave paralele ose për rihapjen e tyre në shtrirje, etj.

Në këto raste metodat e gjeofizikës nëntokësore si ajo e polarizimit të provokuar e magnetometrisë vektoriale, e ndriçimit me radiovalë dhe e trupit të ngarkuar ose e elektrokorelimit të kombinuar me të dhënat gjeologjike dhe të gjeokimisë parësore, jepin materiale të mjaftueshme për të bërë interpretimet me cilësi e zgjidhshmëri të lartë.

Parashtrimi i aftësive zgjidhëse të metodave të gjeofizikës nëntokësore bëhet për të térhequr vëmëndjen e opinonit gjeologjik të mbare vendit. Interesat ekonomike të vendit, për atë fazë të re zhvillimi që kërkon Partia e bëjnë të domosdoshme që kompleksi i metodave të gjeofizikës nëntokësore të shtrihet në kërkim-zbulimin e gjithë mineralete të dobishme të vendit. Ndërmarrja Gjeofizike e Tiranës, në zbatim të direktivave të Partisë dhe udhëzimeve të Dikasterit ka ndihmuar në ngritjen e ekspeditave gjeofizike pothuaj në të gjitha ndërmarrjet gjeologjike. Këto ekspedita kanë bërë përparime sidomos në zbatimin e metodave gjeofizike të studimit të trungut të shpimit dhe ka filluar të ndihet ndihmesa e tyre në zgjidhjen e problemeve gjeologjike. Por jemi akoma shumë larg nga ato që kërkon koha dhe një industri e përparuar.

Kjo vjen nga që vetë drejtuesit e ndërmarrjeve gjeologjike nuk e kuptojnë rolin e metodave të gjeofizikës nëntokësore dhe bëjnë përpjekje të pakta që ato të zenë vendin e duhur në ndihmë të studimeve dhe kërkimeve gjeologjike.

Në shumicën e rasteve, drejtuesit e ndërmarrjeve gjeologjike shërbimin gjeofizik e shohin si shtojcë të prodhimit dhe nuk tregojnë kujdes pér mjediset e nevojshme, pér mirëmbajtjen e teknikës, pér krijimin e bërthamave të laboratorëve të studimit të veticë fizike, pér zgjerimin e metodave në përdorim, pér sigurimin e fondeve pér blerjen e aparaturës së nevojshme, pér sigurimin e mjeteve të posaçme, të përshtatshme teknikisht pér transportimi e aparaturës, etj.

Për zhvillimin e përparimin e metodave gjeofizike ka rëndësi të madhe dhe niveli i kualifikimit të gjeologëve, interesimi i tyre pér këto metoda, pér aftësitë zgjidhëse dhe pér interpretimin e përbashkët gjeologjik të rezultateve të tyre. Ndoshta ka ardhur koha të shihet programi i lëndës së gjeofizikës që jepet pér gjeologët dhe mundësia e kualifikimit pasuniversitar të tyre. Një interes më i madh duhet të tregohet pér përgatitjen e gjeofizikëve dhe specializimin e tyre pér metodat e gjeofizikës nëntokësore. Duhen bërë përpjekje më të mëdha, pér të përgatitur specialistë gjeofizikë nga rrjetet, pér të krijuar mundësinë e organizimit të shërbimit gjeofizik të qëndrueshëm dhe me rritje cilësore.

Ndryshimet duhet të bëhen dhe në rregulloret e udhëzimet përkatëse pér përpilimin e projekteve të kërkim-zbulimit dhe në hartinë e raporteve teknike të llogaritjes së rezervave.

Në këto duhet të ketë kërkesa të detyrueshme të kësaj natyre:

1. Në argumentimin e rrjetit të kërkimit apo më vonë të zbulimit (sipas kategorisë së rezervave të pritshme) të parashikohen edhe punimet e gjeofizikës nëntokësore, të trungut të shpimit dhe të hapësirës.

2. Në ndërtimin e kolonave gjeologjike të ndiqet rregulli që të paraqitet veç kolona e ndrtëuar sipas të dhënavë të shpimit, veç kolona sipas parametrave të metodave gjeofizike të përdorura dhe së fundi, të ndërtohet kolona sipas interpretimit gjeologo-gjeofizik. Në bazë të këtyre të fundit të ndërtohen prerjet gjeologo-gjeofizike, kolonat bashkëlidhëse, etj.

3. Të pranohen pér llogaritjen e rezervave gjeologjike trashësítë e trupave xeherorë të nxjerra sipas metodave gjeofizike të trungut të shpimit.

Thellimi i mëtejshëm në studimin e metodave të gjeofizikës nëntokësore do të shpjerë në gjetjen e komplekseve të metodave më optimale të cilat do të rritin efektivitetin e kërkim-zbulimeve gjeologjike.

Është detyrë e shërbimit gjeologjik, e organeve shtetërore përkatëse dhe e gjithë specialistëve, të modernizojnë e të ngrenë në nivel të ri shkencor kërkimet komplekse të minraleve të dobishme. Një nga rrugët pér arritjen e këtij objektivi, është zhvillimi dhe përsosja e metodave të gjeofizikës nëntokësore.

### S u m m a r y

#### The underground geophysical studies

This paper treats the place of the underground geophysical methods in the prospecting works ore deposits and especially of copper and chromium ones.

Based on the study methods of the drilling trunks we can define the thickness and the content of the mineralized bodies and build up the lithologic column. This permits the performing of drillings in full front.

The combination of the geophysical methods for the study of drilling trunk with those which study environment around it may be used in the prospecting of mineralized bodies affected by the tectonics and when the carried out drillings have negative results.

These methods may be used also during the mining exploitation orientating the preparatory and exploiting mining works as well as studying the phenomena of beds pressure, the water bearing structure conditions, the movement and quantity of the underground waters.

The underground geophysical methods can be used for the study of the presence of the other parallel ones etc.

## GJEOLGI

**VENDOSJA TRANSGRESIVE E FORMACIONIT  
KONGLOMERATO-RANORO-KUARCOR MBI  
FORMACIONIN**

**TERRIGJENO-RRESHPOR DHE  
FORMACIONIN VULLKANOOGJENO-SEDIEMENTAR  
NË RAJONIN E GASHIT**

Jakup Hoxha\*, Selam Meço\*\*, Adem Matoshi\*.

Rajoni i Gashit gjeologjikisht ndërtohet nga katër formacione: formacioni terrigen i Ceremit (D-C), formacioni gabro-granodioritik C<sub>1</sub>-P(?), formacioni vulkanogjeno-sedimentar (P<sub>2</sub>) dhe formacioni konklomerato-ranoro-kuarcorë (P-T<sub>1</sub>). Evidentohet vendosja transgresive e formacionit konglomerato-ranoro-kuarcor (Suita Luma) mbi formacionin vulkanogjeno-sedimentar dhe mbi formacionin terigjeno-rreshpor të Ceremit.

HYRJE

Në kuadrin e rilevimit gjeologjik 1: 10 000 në rajonin e Gashit u përftuan një sërë të dhënash të reja për stratigrafinë, magmatizmin dhe tektonikën e këtij rajoni.

Formacioni konglomerato-ranoro-kuarcor, më parë ka qenë nxjerrë në pah vetëm mbi formacionin shistoz konglomeratik të Çeremit (Gjata K. etj., 1970, Gjata K. etj. 1972, Melo V. etj., 1974). Pothuajse gjithnjë këto depozitime janë quajtur pjesë përbërëse e serisë terigjene-rreshpore të Çeremit. Në disa raste ky formacion është krahasuar litologjikisht dhe nga ana moshere me serinë «Verrukano» (Itali) dhe suitën «Luma» (në Albanidet) (Xhomo A. etj. 1975; Melo V. etj., 1974). Gjetja e këtij

\* Ndërmarrja Gjeologjike në Tropojë.

\*\* Fakulteti Gjeologji-Miniera në UT

formacioni edhe mbi atë vullkanogjeno-sedimentar (krahas të dhënave përmarrëdhënet e tij me formacionin rreshpor të Ceremit) na ndihmon shumë, që së bashku me të dhënat litologo-biostratigrafike të ndërtojmë një skemë më të plotë litologo-stratigrafike për depozitimet e rajonit të gashit.

### TË DHËNA TË PËRGJITHSHME STRATIGRAFIKE

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të Gashit marrin pjesë katër formacione:

1. Formacioni terigjen-rreshpor i Çeremit.
2. Formacioni gabro-granadioritik
3. Formacioni vullkanogjeno-sedimentar
4. Formacioni konglomerato-ranoro-kuarcor.




Fig. 1 — Skema e ndarjes formacionale të rajonit të Gashit.

(1) (2) (3) (4) (5) (6), Formime të formacionit konglomerato-ranoro kuarcor.

Fig. 1 Formations scheme of Gashi region.

1, 2, 3, 4, 5, 6 deposits of conglomerato-sandstone-quartzous formation.

1. Siç shihet nga skema, në bazën e depozitimeve të rajonit të Gashit vendoset formacioni terigjen-rreshpor i Ceremit. Ky formacion në bazë të karakteristikave kryesore litologjike është ndarë në dy njësi: pakua filito-alevrolitike (poshtë), dhe pakua ranoro-kuarcore rreshpore (sipër). Në pakon e poshtme filito-alevrolitike janë dalluar tre horizonte: filite të ndërthurura me alevrolite, filite me mineralizim sulfur dhe filite me ndërthurje rreshpe ranore. Kurse në pakon e sipërme janë dalluar gjashtë horizonte: ranoro-kuarcor me pak alternime filitesh, ranoro-kuarcor gri jeshil me pikzime sulfure, ranoro-

### Vendosja transgresive e formacionit konglom. ranoro-kuarcor

-kuarcor dhe rreshpe me ngjyrë vishnje e të kuqëremtë; rreshpe argjilo-ranorë dhe argjilore ngjyrë gri të errët me përbajtje lënde organike, ranor-kuarcor me ngjyrë gri të bardhë, ranoro-kuarcor të kuqërrëmtë dhe rreshpe ranoro-argjilore të errëta.

Pamvarësish nga përpjekjet e bëra deri më sot nga gjithë autorët e mëparshëm (Canko S. etj., 1972; Gjata K. 1970; Gjata K. 1972; Gjata K. 1982; Gjata K. 1985; Gjeologji e Shqipërisë 1982 Xhomo A. 1985; Melo V. 1984) përfshirë këtu edhe autorët e këtij artikulli (Hoxha J. etj. 1988; Hoxha J. etj. 1989) për formacionin në fjalë nuk ka të dhëna direkte paleontologjike. Në këto kushte interpretimi moshor është bërë duke u mbështetur në pozicionin hapsinor, të shkallës së metamorfizmit dhe analogjisë me formacionet e tjera pak a shumë të ngjashëm brenda dhe jashtë truallit të Albanideve.

Nisur nga sa më sipër na duket me interes diskutimi i autorëve V. Melo etj. (1974) lidhur me interpretimin moshor të këtij formacioni për analogji me vazhdimin e tij në zonën e Durmitorit në Jugosllavi (në rajonin e Plavës afér kufirit tonë shtetërorë), ku janë gjetur forma të tilla si *Palmatolepis*, *Polygnathus* e të tjera që vërtetojnë devonianin e sipërm. Brenda Albanideve një farë analogjie mund të bëhet me formacionin e rreshpeve të zeza të zonës së Korabit (Xhomo A. etj. 1985). Në bazë të këtyre të dhënave dhe arsyetimeve ne i përbahemi moshës devonian-karbonifere për këtë formacion.

2. Formacioni gabro-granadioritik është ndarë në pakon e gabrove dhe të granodioriteve të cilat të dyja së bashku përbënë facien plutorike. Koha e formimit të këtij formacioni tanë për tanë është e pa qartë,

3. Formacioni vullkanogjeno-sedimentar. Ky formacion me përhapje të madhe, mendojmë se është me shumë rëndësi për sqarimin e gjeologjisë së gjithë rajonit të Gashit. Një gjë e tillë theksohet sepse tashmë është vërtetuar mundësia e gjetjes së fosileve (konodonteve) që jepin moshë të saktë gjeologjike (Hoxha J. etj. 1988, Hoxha J. etj. 1988, Hoxha J. 1989). Nga ana tjetër formacioni në fjalë paraqet interes praktik sepse me të lidhet mineralizimi sulfur polimetikal. Foi nacioni vullkanogjeno-sedimentar ka ndërtim të larmishëm. Mbi bazën e karakteristikave litologjike, të përbërjes, të ndryshimeve faciale, etj. ai është ndarë në disa pakon nga poshtë lartë:

a. Pakua pikrito-komatitike; b — pakua bazaltike; c — pakua rreshporo-silicore; d — pakua andezitike; e — pakua dacitike f — pakua karbonatike.

Datimi moshor i këtij formacioni ka qenë objekt diskutimesh prej vitesh nga gjeologë të ndryshëm. Në kuadrin e këtyre diskutimeve mendojmë se më tepër tërheq vëmëndjen ai i autorëve V. Melo etj. (1974). Kështu ata kanë konstatuar se formacioni në fjalë përbëhet po nga ata gjymtyrë litologjike që diferencojmë edhe ne, pamvarësish se nuk janë emërtuar si pakon të veçanta. Gjithashtu e gjemë të drejtë mendimin e shprehur prej tyre se formacioni vullkanogjeno-sedimentar i këtij shëm nuk ka të bëjë me formimet vullkanogjeno-sedimentare të zonës së Mirditës, siç kanë menduar autorë të tjera (Gjata K. 1975, Gjata K. 1972, Gjata K. 1982, Gjata K. 1985, Kodra A. 1982). Nga ana tjetër

të dhënat e po këtyre autorëve se andezito-dacitet janë prodhime të vullkanizmit pas ofiolitik, jurasiko-kretak ose më të ri, nă duken të pa argumentuara, sepse këto formime përbëjnë një unitet të qartë brenda formacionit vullkanogjeno-sedimentar pa pakot e tjera.

Shkaku i interpretimeve, shpesh mjafëtë të distancuara me njëri tjetrin, ka qenë mungesa e dokumentave paleontologjike. Për këtë arsyet e fundit nga anajonë vëmëndja u përqëndrua në drejtim të kërkimit e studimit të konodonteve në pakon karbonatike. Konodontet e takuar (ndonëse të paktë) kanë përhapje nga permiani i sipërm në triasikun e poshtëm. Duke marrë për bazë se mbi të vendoset formacion konglomerato-ranoro-kuarcor i triasikut të poshtëm mosha e këtij formacioni duhet të jetë e permianit të sipërm.

4. *Formacioni konglomerato-ranoro-kuarcor.* Ky formacion daljen më të plotë e ka nga Balçina deri në Kërshin e Vujkut. Vitet e fundit ky formacion është takuar edhe rrëth 300 m më në jug të Qafës së Ali Çelës (fig. 1) dhe në disa vende gjatë ballit të mbihypjes. Ndërsa në Balçin dhe në Kërshin e Vujkut (fig. 5,6) ky formacion vendoset mbi formimet e formacionit terrigjeno-rreshpor të Çeremit, në Qafën e Ali Çelës (fig. 2,3) -dhe në ballin e mbihypjes (fig. 4) ai vendoset mbi formacionin vullkanogjeno-sedimentar.




Fig. 2 — Plan-skema e vendosjes së formimeve të formacionit konglomerato-ranoro-kuarcor mbi formacionin vullkanogjeno-sedimentar (Qafa e Ali Çelës).

1. Bazaltë;
- 2 — andezite;
- 3 — gëlqerorë;
- 4 — rreshpe klorit-kuarcorë e kuarc-kloritikë;
- 5 — konglomerate-ranoro-kuarcorë;
- 6 — kufi gjeologjik normal;
- 7 — rrafsh tektonik;
- 8 — kufi gjeologjik transgresiv;
- 9 — kufiri shtetëror.

Fig. 2. Scheme of the emplacement of conglomerate-sandstone-quartzous formation on the volcanogeno-sedimentary one. (Qafa e Ali Çelës).

- 1 — Basaltes;
- 2 — Andesites;
- 3 — limestones
- 4 — Chlorite-quartzous schists etc.
- 5 — Normal geological boundary,
- 7 — Tectonic plane;
- 8 — Transgressive boundary;
- 9 — State border.

Në të gjitha daljet e formacionit konglomerato-ranoro kuarcor vëmë re se ato në përgjithësi paraqesin një ndërtim të trashë dhe përbëhen nga copra kuarci me madhësi deri edhe 5 e 7 cm dhe më pak nga




Fig. 3 — Prerja gjeologjike A-A Qafa e Ali Çelës.

Fig. 3. Geological section A-A — (the explanations like those in (Fig. 2).



Fig. 4 — Prerja gjeologjike skematike Pribuj-Presh.

- (1) shiste argjilo-ranore të zeza;
- 2 — shiste argjilo-ranore të çelta;
- 3 — shtresa gëlqerore në shiste;
- 4 — fragmente konglomeratesh kuarcore;
- 5 — fragmente granodioritesh;
- 6 — gëlqeror shtresor të formacionit vullkanogjeno-sedimentar;
- 7 — vullkanite (basalte);
- 8 — zonë e mineralizuar sulfure 1,2,3 — pjesë të formacionit terigjeno-rreshpor të Çeremit.
- (5) — pjesë e formacionit gabro-granodioritik;
- (7) (8) — pjesë të formacionit vullkanogjeno-sedimentar e (4) pjesë e formacionit konglomerato-ranoro kuarcor e (10) — rrefshi i mbihypjes;
- 9 — mbules deluviale.

Fig. 4. Schematic geological section.

- 1 — Block argillaceous — sandstone schists;
- 2 — light argillaceous sandstone schists;
- 3 — limestone layers in schists;
- 4 — Conglomerate quartzous fragments;
- 5 — granodioritic fragments;
- 6 — layered limestones of the volcanogeno-sedimentary formation;
- 7 — Volcanites (basalte);
- 8 — Mineralized sulphur zone;
- (1), (2), (3). Units of the terrigeno schistous formation fo Çeremi.
- (5). Unit of the gabbro — granodioritic formation;
- (7), (8). Units of the volcanogeno-sedimentary formation.
- (1). Unit of the conglomerate-sandstone-quartzous formation;
- (10) — thrusting plane;
- 9 — deluvional cover.




Fig. 5 — Plan skema e vendosjes së formacionit konglomerato-ranoro-kuarcor mbi formacionin terigjeno-rreshpor të Ceremit.

1 — pjesë të formacionit terigjeno-rreshpor të Ceremit; 2 — gabbro; 3 — granodiorit; 4 — konglomerato-ranore kuarcore; 5 — mbules deluviale; 6 — kufiri shtetëror; 7 — kufi gjeologjik normal; 8 — kufi gjeologjik diskordant.

Fig. 5 Scheme of the emplacement of the conglomerate — sandstone-quartzous formation on terrigenous-schistous one of Ceremi; 2 — Gabbro; 3 — Granodiorite; 4 — Conglomerate-sandstone-quartzous; formation 5 — Deluvional cover 6 — State border; 7 — Normal geological boundary; 8 — Discordant geological boundary.

copra vullkanitesh mjaft të ndryshuara e të kloritizuara, Cimentoja e shkëmbit përbëhet po nga kuarci.

Mikroskopikisht vërehet se këta shkëmbinj përbëhen nga copra kuarci dhe kuarcitesh me strukturë granoblastike. Forma e coprave këndore. Cimentoja është thjeshtë kuarcore. Ajo paraqitet si një masë kataklazuar imët me ngjyrë gri, deri edhe të kuqëzremët. Nganjëherë në të vërehen përzierje kloriti. Mineralet aksesore janë: magnetit, krom shpinelit, leukoksen, cirkon, rutil, galenit, barit. Trashësia e këtij formacioni në të gjithë daljet nuk e kalon 70-80 m.

Duke iu referuar literaturës dhe të dhënave të fituara ne jem të mendimit se ky formacion ka ngjashmëri me suitën «Luma» dhe serinë «Verrukane» mosha e të cilave tashmë pranohet si permiane deri në triasikë e poshtme.

Duke qënë se ky formacion vendoset transgresivisht mbi formacionin vullkanogjeno-sedimentar që është datuar si i permianit të si-

përm, do ishte më e drejtë që formacioni konglomerato-ranoro kuarcor të dotohet vetëm si i triasikut të poshtëm.

Ashtu si për gjithë Albanidet, e më gjërë për gjithë brezin Dinalido-Albanido-Helenid edhe për rajonin e Gashit në veçanti, ky formacion dokumenton mirë tektogjenezën e ciklit variscik në fund të paleozoit.

## PËRFUNDIME

1. Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të Gashit, marrin pjesë karter formacione, formacioni terigjeno-rreshpor i Ceremit, formacioni gabro-granodioritik, formacioni vullkanogjeno-sedimentar dhe formacioni konglomerato-ranoro kuarcor.

2. Formacioni konglomerato-ranoro kuarcor vendoset transgresivisht mbi formacionin terigjeno-rreshpor dhe ato vullkanogjeno-sedimentar. Ai mendohet se ka moshë të triasikut të poshtëm.

3. Pranojmë analogjinë litologjike dhe moshere të formacionit konglomeratò-ranorik me suitën «Luma» dhe me serinë «Verrukane» për pasojë formacionet e ndodhur poshtë tij, duhet të kenë moshë më të vjetër.

## LITERATURA

- Canko S., Haxhia P. 1982 — Raporti mbi rezultatet e punimeve komplekse në sektorin Rupë-B. Cobanëve të rajonit të Gashit B. Curri.
- Gjata K., Elezi E., Haxhia Sh. 1970 — Raport gjeologjik mbi punimet e kërkim-rilevimit për vitet 1968-1969 B. Curri (material pune).
- Gjata K., Haxhia Sh. 1972 — Raport mbi punimet e revisionimit dhe vlerësimit në sektorët e mineralizuar të krahinës së Gashit. B. Curri.
- Gjata K., Kodra A. 1982 — Magmatizmi pas ofioliteve jurasiko-kreta dhe ai më i ri mesataro-acid në vendin tonë. Buletini i Shkencave Gjeologjike Nr. 4.
- Gjata K., Kodra A. etj. 1985 — Studim tematik mbi punimet e kërkimit për sqarimin e perspektivës për minerale të rralla në vendin tonë B. Curri.
- Hoxha J. etj. 1986 — Projekti «Mbi punimet e kërkim-rilevimit kompleks të rajonit të Gashit», B. Curri.
- Hoxha J. 1988 — Studim: «Petrologjia dhe metallogjenia e vullkaniteve të sektorit Rupë-Pribuj në rajonin e Gashit, B. Curri.
- Hoxha J. etj. 1988 — Të dhënat paraprake mbi argumentimin moshorë të serisë vullkanogjeno-sedimentare të rajonit të Gashit. Buletini i Shkencave Gjeologjike Nr. 4 Tiranë.
- Hoxha J. etj. 1989 — Raport: Ndërtimi gjeologjik dhe disa veçoni metallogenike të sektorit Rupë-Ujëzol në rajonin e Gashit. B. Curri.
- Kodra A. 1967 — Mbi moshën jurasike të formacionit vullkanogjeno-sedimentarë. Përb. Stud. Nr. 4 Tiranë.
- Kodra A. 1980 — Gjeologjia e disa pjesëve periferike të zonës së Mirditës. Përb. Stud. Nr. 3, Tiranë.

12. Kodra A., Gjata K. 1982 — Ofiolitet në kuadrin e zhvillimit gjeotektonik të Albanideve të brendshme. Buletini i Shkencave Gjeologjike Nr. 2 — Tiranë.
13. Kodra A. 1977 — Problematika e ndërtimit strukturor të zonës së Mirditës dhe marrëdhëniet e saj me zonat fqinjë. Përmbyt. Stud. Nr. 2, Tiranë.
14. Gjeologjia e Shqipërisë 1982 — Tekst svarues i hartës gjeologjike në shkallën 1 : 200 000.
15. Turku I. 1981 — Disertacion. Petrologjia e vullkaniteve mesozoike të zonave Mirditë e Krastë-Cukali. Tiranë.
16. Meço S. 1989 — Disertacion. Konodontet dhe stratigrafia e depozitimeve paleozoikë e triasike të zonës së Korabit. Tiranë.
17. Xhomo A. etj. 1985 — Stratigrafia e depozitimeve paleozoikë të Albanideve dhe premisat e mineralizimeve që lidhen me këto depozitime, Tiranë.
18. Melo V. etj. 1974 — Probleme të gjeologjisë së pjesës verilindore të Shqipërisë. (Albanideve veriore). Përmbyt. Stud. Nr. 2.
19. Grillo V. etj. 1982 — Studim tematik përgjithësues për kërkimin e polimetaleve (Dukagjin-Vermosh) për vitin 1981-1982. Tropojë.
20. Mitchell A.H.G. and Garson M.S. 1981 — Mineral deposits and global tectonic settings Academic Pres London New York Toronto-Sydney-San Francisc.
21. Shallo M. etj. 1984 — Ofiolitet e Albanideve Tiranë.

## SUMMARY

*The transgressive emplacement, of the conglomerato-sandstone-quartzous formation on the terrigeno-schistous and volcanogeno-sedimentary ones, Gashi region]*

Four formations take part in the geological structure of Gashi region:

- 1 — Terrigeno-schistous formation of Ceremi
- 2 — Gabbro-granodioritic formation
- 3 — Volcanogeno-sedimentary formation
- 4 — Conglomerato-sandstone-quartzous formation.

The conglomerato-sandstone quartzous formation is transgressively situated on the terrigeno-schistous one as well as on the volcanogeno-sedimentary formation. It's thought to be of Middle Triassic age.

The age analogy of this formation with the «Luma» pack and «Verrucano» series is accepted.

## BONINITE NDËRMJET OFIOLITEVE LINDORE TË SHQIPËRISË

Minella Shallo\*

Ndërmjet vullkaniteve të pjesës së sipërme të prerjes së ofioliteve lindore të Shqipërisë takohen xhamë vullkanikë me tipare petrografike e gjeokimike të afërta me boninitet tipike të ishujve Bonin të Paqësorit Perëndimor.

Prania e boniniteve favorizon kërelime petrologjike e paleogeografike të shkallës më globale dhe interpretime më të argumentuara të originës së vullkaniteve dhe të ofioliteve lindore në tërësi. Vihet në dukje se ata janë formuar nga një magmë parësore me natyrë boninitike e gjeneruar në mantelin e varfëruar peridotitik, në kushte ujëmbajtëse, në mëdus harku ishullor mbi një zonë subduksioni intraoceanic; derivate të kësaj shkrirje duhet të janë edhe përbërësit e tjerë të seriës vullkanogjene bazaltodacitike të ofioliteve lindore si dhe analoga e tyre plutonikë e dajkorë.

### HYRJE

Ofiolitet e Shqipërisë janë pjesë përbërëse shumë e rëndësishme e brezit ofiolitik Mesdhetar-Alpin; ndërmjet tyre është vënë në dukje prania e ofioliteve të tipit «perëndimor» (ofiolite të tipit të dytë me sekundare të tipit «A» — plagioklazike) dhe ofiolite të tipit «lindor» (ofiolite të tipit të dytë me sekundare të tipit «B» dhe «C» — piroksenore) (Shallo etj. 1985, 1987, 1989). Për vullkanitet e ofioliteve lindore është vënë në dukje ngashmëria petrografike e gjeokimike me vullkanitet e ofioliteve të Troodosit (Qipro) dhe me serinë marianit-boninite (Shallo etj. 1987), si dhe prania e llojeve xhamore andezit-bazaltike me tipare të afërta me boninitet (Shallo, 1987 në shtyp).

Boninitet sipas Cameron etj. (1979) janë shkëmbinj xhamorë me përbajtje të lartë magneziumi, por relativisht silicorë, që përbajnë një ose më shumë lloje piroksenesh, magnezo-kromit aksesor, e zakonisht sasi të vogël olivine. Sipas tyre megjithëse boninitet mund të emërtohen andezite me përbajtje të lartë magneziumi (andezite

magneziale) ata ndryshojnë nga andezitet tipike prandaj është i justifikueshmë përdorimi i termit të veçantë *boninit*.

Sipas Kuroda etj. (1978) boniniti është një andezit magnezial pa plagioklaz, jo i zakonshëm, që takohet si lava jastëkore bajamore e hialoklastitë, i shoqëruar me andezite e dacite në Chichi-jimi, Ishuj Bonin. Kimizmi i boniniteve karakterizohet nga përbajtja e lartë e MgO, Cr dhe Ni, që është në mospërputhje me përbajtjen relativishë të lartë të SiO<sub>2</sub> (rreth 55 %). Mineralogjia e boninitit përfaqësohet nga olivina (Fo<sub>87-90</sub>), ortopirokseni (En<sub>87-90</sub>), klinopirokseni Wo<sub>38-35</sub> En<sub>37-44</sub> Fs<sub>25-21</sub>), xhami ujëmbajtës dhe kromshpinelidi.

«Suitat» me shkëmbinj të ngjashëm me boninitet me variacion të madh të përbajtjes së MgO e SiO<sub>2</sub> janë takuar në mjaft rajone.

Në këtë artikull jepet për herë të parë një karakteristikë e shkurtër gjeologo-petrografike dhe gjeokimike e boniniteve të vullkaniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë të krahasuara me boninitet e razoneve të tjerë të botës. Evidentimi i boniniteve në vendin tonë paraqit interes të veçantë si për korelime më krahinore ashtu edhe përqartësimin e problemeve të petrologjisë e mekanizmit të formimit të ofioliteve të vendit tonë.

## 2. Karakteristikë e shkurtër gjeologo-petrografike e boniniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë

Vullkanitet e ofioliteve lindore përhapen kryesisht në pjesën ak-siale të ofioliteve. Ata formojnë një sekuencë të plotë të diferencave nga bazaltet e mbingopura me silic dhe me përbajtje të ulët titan drejt andeziteve e daciteve me analogët e tyre xhamorë, të ngjashme me sekuencat e vullkaniteve të harqeve ishullorë ensimativë. Pjesa e poshtme e prerjes me trashësi 1,5-2,0 km përbëhet kryesisht nga lava jastëkore bazaltike e rrallë lava bazaltike masive dhe piroklastite bazaltikë. Llojet petrografike të lavave bazaltike janë: bazalte, porfirite bazaltikë, hialobazalte. Kanë strukturë afirike, porfire, subofitike, mikrovariolitike e vitroporfire. Pjesa e sipërme e prerjes së vullkaniteve me trashësi 0,5-0,7 km ka përhapje më të kufizuar sipërfaqësore përfekte erozonale përbëhet nga lava jastëkore e masive andezitobazaltike, lava e piroklastite dacitike e riodacitike si dhe xhamet vullkanikë të përbërjes dacitike, andezitike, andezitobazaltike e bazaltikë. Andezitobazaltet, andezitet e hialoandezitet kanë strukturë porfire, vitroporfire, mikrolitike, andezitike. Dacitet dhe riodacitet kanë teksturë masive dhe piroklastike, strukturë porfire, glomeroporfire, sferolitike dhe mikrolitike. Fenokristalet përbëjnë 5-15 % të shkëmbit dhe përfaqësohen nga kuarsi, plagioklazi (An<sub>20-40</sub>) e më rrallë nga klinopirokseni ndërsa mezostazisi është sferolitik-mikrolitik kuarc-plagioklazik.

Xhamet vullkanikë janë pjesë përbërëse e rëndësishme e prerjes së pakos së sipërme të vullkaniteve, përhapen kryesisht në pjesën ak-siale (raioni i Mirditës Qëndrore). Ata përbëjnë afersisht 10-20 % të prerjes së pakos së sipërme të serisë vullkanogjene bazalto-dacitike

(fig. 1), takohen në formë trupash të shrregullt ose thjerëzorë me trahësi nga 2-4 m deri në 10-20 m dhe kanë kontakte graduale më rrallë të prerë me riodacitet, andezitet, andezitobazaltët ose me bazaltet.

Nganjëherë formojnë koret periferike të lavave jastëkore ose trupa hialoklastitesh. Përbërja e tyre varion nga bazaltike-andezitobazaltike në andezitike, dacit-riodacitike. Ndërmjet xhamave vullkanikë të sekuencës vullkanike të ofioliteve «lindore» takohen edhe lloje specifike me veçori petrografike e gjeokimikë të afërtë ose të njëjtë me boninitet.

Xhamet vullkanikë boninitikë të vullkaniteve të ofioliteve lindore. Këto lloje shkëmbore takohen në shoqërim me xhamet vullkanike me




Fig. 1. Korelimi i prerjeve skematiqe të pjesës së sipërme të serisë vullkanogjene bazalto-dacitike të ofioliteve lindore të Shqipërisë (Mirdita Qendrore). 1 — Sedimente flishoidale (J<sub>3</sub>t; Cr<sub>1</sub> be); 2 — silicorë radiolaritikë (J<sub>3</sub> k-t); 3 — riodacite aglomeratikë. 4 — xhamë andezitikë e dacitikë; 5 — rhyodacites; 6 — hialoandezite e hialoandezito-bazalte; 7 — hialoandezitobazalte aglomeratikë; 8 — xhamë bazaltikë; 9 — hialobazaltoandezite; 10 — lava jastëkore bazaltike.

Correlation of the schematic sections of the upper part of the volcanic suite from Albanian eastern ophiolite.  
(Central Mirdita).

1. Flyschoidal sediments (J<sub>3</sub>t-Cr<sub>1</sub> be); 2. Radiolarian cherts (J<sub>3</sub> k-t); 3. Agglomeratic rhyodacites; 4. Andesitic and dacitic glasses; 5. Rhyodacites; 6. Hyaloandesites and hialobasaltic andesites; 7. Agglomeratic hyaloandesitic basalts; 8. Basaltic glasses; 9. Hyaloandesitic basalts; 10. Basaltic pillow lavas.

përbërje të ndryshme dhe me përbërësit e tjerë vullkanikë kryesishë pakos së sipërme të serisë vullkanogjene bazalto-dacitike; në disa raste ato janë llojet xhamore mbizotëruese. Më parë është vënë në dukje prania e xhameve vullkanikë bazikë me fenokristale të shumtë klinopirokseni në vullkanitet e Rënjollës (Shallo 1970). Kështu në pjesën e sipërme të prerjes së vullkaniteve të rajonit të Rënjollë-Perlatit (Mirdita Jugore) ata përbëjnë rrëth 40% të prerjes së pakos së sipëri me (Fig. 2); në prerjet e kryera në disa shpimë të vendburimit të Perlatit ata së bashku me hialoandezitobazaltet përbëjnë rrëth 40-60% të prerjes.




Fig. 2 — Prerje skematike në pakon e sipërme të vullkaniteve të ofioliteve në sektorin Rënjollë-Lëkundë (Mirdita Jugore).

1 — Sedimente flishoidale ( $J_3$ - $Cr_1$  be); 2 — silicorë radiolaritikë ( $J_3$  k-t); 3 — tufë ranorikë; 4 — tufë aglomeratikë; 5 — Xhamë vullkanike andezitobazaltike (boninite); 6 — hialobazalte e hialobazalandezite; 7 — bazalte.

Schematic sections of the upper part of the volcanic suite of the eastern ophiolites in Rënjollë-Lëkundë area (Southern Mirdita).  
 1. Flychoidal sediments ( $J_3$ - $Cr_1$  ba); 2. Radiolarian cherts ( $J_3$ k-t); 3. Sandstone tuffs; 4. Agglomerate tuffs; 5. Andesito-basaltic glasses (boninite); 6. Hyalobasalts and hyalobasalt andesite; 7. Basalts.

Llojet xhamore të afërt me boninitet takohen edhe ndërmjet dalojeve të xhameve vullkanikë në Gurth Spac-Lëtitnë, Kodër Spac, Munnellë, Lumzi, Peshqesh, Simon etj. ku ata shoqërohen me xhamë vullkanikë andezitodacitikë, dacitikë e më rallë andezitobazaltikë-bazaltikë. Në prerjen e Rënjollës veçimet thjerezore-brezore të xhameve vullkanike boninitikë me trashësi 10-15 m ndërthuren me vullkanitë andezitobazaltikë-bazaltikë dhe ndiqen për dhjetra e qindra metra. Ata janë masivë ose jastëkorë, (fig. 3), jastëkorë piroklastikë herë herë bajamorë, me ngjyrë gri të errët deri në të zezë, kanë strukturë vitroporfë-mikroporfë, vitrofire deri në andezitike. Përbëhen nga klinopirokseni e rrallë nga ortopirokseni e shumë rallë olivina si dhe nga mezostazisi xhamor i freskët ose i ndryshuar.



Fig. 3. — Lava jastëkore boninitike. Boninite pillow lavas. Gurth Spac area.

Klinopirokseni takohet në formë mikrofenokristalesh prizmatike të gjatë që dëshmojnë për një rritje të shpejtë (fig. 4a) dhe përbën deri në 30-50% të volumit të shkëmbit; është i zhystur në masën xhamore. Në disa raste klinopirokseni formon kristale të vogla ose mikrolite prizmatikë të gjatë që përbëjnë rrëth 40-60% të masës së shkëmbit (Fig. 4b). Klinopirokseni është i llojit diopsid-augit. (En 51.29, Fs 5,2 Wo 49,58), përbërja kimike e tij e përcaktuar me mikrosokrosondë elektronike jepet në pasqyrën Nr. 1. Rrallë në këta shkëmbinj takohen fenokristale olivine të zëvendësuar tërësisht nga serpentina, dhe ortopirokseni.

Nga njëherë në disa lloje të shkëmbinjve shoqëruar krasas prizmave të vegjël të klinopiroksenit takohen edhe mikrolite plagioklazi. Në disa boninite takohen vetëm fenokristale klinopirokseni (diopsid-augit), që përbëjnë 10-12% të masës së shkëmbit dhe që janë të zhystur në masën themelore izotrope të murme të gjelbër të zbehtë të ri-



Fig. 4 — a) Boninit Dallohen prizma klinopirokseni të zhytur në masën xhamore të rikristalizuar. Pa analizator, 33°.  
a — Boninit. Clinopyroxene prisms set in recrystallised glass 33°.



b). Boninit Prizma të shumë klinopirokseni në masën xhamore të ceolituar. Pa analizator, 33°.  
b — Boninit. Abundant clinopyroxene prisms set in zeolitised glass. 33°.

kristalizuar dobët në klorit. Masa themelore ka tregues thyerjeje 1,515 deri 1,550. Përbërja kimike e saj e përcaktuar me mikrosondë elektro-nike jepet në pasqyrën 1. Mineralet aksesore janë shumë të pakët ose mungojnë, rrallë takohen kokrriza të vetmuara oktaedrike (0,2 mm) të kromshpinelidit. Në disa nga hialoandezitobazaltet shoqëruar bajamorë vërehen fenokristale plagioklazi të kuarcëzuar e karbonatizuar ose kloritizuar e ceolitizuar dhe fenokristale augiti, në to masa themelore xhamore pjesërisht e kloritizuar përmban mikrolite të shumtë klinopirokseni e plagioklazi në sasi afërsisht të njëjtë. Në boninitet nga njëherë takohen edhe bajame të mbushura me klorit, ceolit, kuarc e rrallë prenit e epidot.



c) Boninit Në masën xhamore pjesërisht të rikrisalzuar me elemente variolitikë dallohen prizma të klinopiroksenit. Pa analizator, 33°.  
c — Boninit. Clinopyroxene prisms are set in partly replaced variolitic glass. 33°.

Xhamet vullkanikë boninitikë shoqërohen edhe nga xame andezitikë e andezitodacitikë me fenokristale plagioklazi e kuarcit e xham mesataroacid.

Në bazë të veçorive petrografike xhamet boninitike të ofioliteve lindore të Shqipërisë ngjasojnë me boninitet tipike të ishujve Bonin të Paqësorit Perëndimor të përshkruar nga Kuroda etj. (1978) dhetatë të ofioliteve të Troodosit (Cameron etj. 1979).

### 3. Veçoritë gjeokimike të boniniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë

Kimizimi i boniniteve të ofioliteve lindore është përcaktuar në bazë të një sërë analizash kimike të provave të zgjedhura. Në pasqyrën Nr. 2 jepen rezultatet e analizave kimike si dhe përbërja minrale normative e tyre; për krahasim janë paraqitur edhe përbërja kimike e minrale normative e disa vullkaniteve shoqëruar dhe e një dajke me natyrë boninitike nga seria e dajkave paralele të ofioliteve si dhe përbërja kimike e boniniteve nga ishujt Bonin dhe nga ofiolitet e Toodosit.

Boninitet nga ofiolitet lindore kanë përbajtje më të lartë të  $H_2O$  se boninitet e ishujve Bonin dhe ata të ofioliteve të Troodosit. Ata rezultojnë toleite të mbingopur me përbajtje të ulët të Ti dhe K. Në diagramën  $K_2O-SiO_2$  (Fig. 6) ata, sikurse edhe xhamet vullkanikë të ofioliteve «lindore» përkjnë me serinë e toleiteve me K të ulët që është tipike për harqet ishullorë (Hughes 1982). Përbajtja e ulët e  $TiO_2$  dhe vlerat relativisht të larta të  $MgO$  në to pasqyrohen edhe në diagramën  $TiO_2-MgO$  (Fig. 5).

Përbërja kimike e minraleve përbërës të boninitere.

	Pasqyra Nr			
	Boninite nga ofiolitet lindore të Shqipërisë	Boninite nga ishujt Bonit (Kuroda etj. 1978)		
	Klinopiroksen	Xham vulkanik	Ortopiroksen	Klinopiroksen
SiO <sub>2</sub>	56,75	63,53	55,0	49,2
TiO <sub>2</sub>	—	—	0,06	0,24
Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	3,45	19,05	1,94	5,44
Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	0,59	0,54	0,33	0,33
FeOt	3,00	1,54	10,10	12,70
MnO	—	—	0,28	0,32
MgO	16,9	2,8	31,0	14,9
CaO	19,98	7,85	1,94	16,6
Na <sub>2</sub> O	—	3,10	0,03	0,19
K <sub>2</sub> O	—	—	0,01	0,02
Shuma	100,66	98,41	100,68	99,62
Si	2,009	—	1,930	1,850
Al	0,144	—	0,079	0,241
Ti	—	—	0,002	0,001
Cr	0,016	—	0,009	0,001
Fe <sup>2+</sup>	0,089	—	0,296	0,400
Mn	—	—	0,009	0,010
Mg	0,892	—	1,622	0,835
Ca	0,758	—	0,073	0,668
Na	—	—	0,002	0,014
K	—	—	—	0,001
Shuma	3,908	—	4,019	4,027
En 51,29	—	En 85	—	44
Fs 5,12	—	Fs 15	—	21
Wo 43,58	—	Wo —	—	35

Shënim: Përcaktuar me mikrosondë elektronike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës në  
A. Marto




Fig. 5. — Diagrama TiO<sub>2</sub> (%) ndaj MgO (%) pëxhamet vulkanike (·) dhe boninitet (—) nga ofiolitet e Shqipërisë.  
— TiO<sub>2</sub> versus MgO diagram for volcanic glasses and boninites from Albanian ophiolites.

**PERBERJA KIMIKE E MINERALE NORMATIVE (LAVACIAS) TE RRAHEVE VULLKANIRE BONINITIR TE OFIOLITEVE LINDORE TË SHQIPERISE TE RRAHASUARA ME BONINITËNGA ISHUJT BONIN DHE NGATROODOSI**

XHAME VULLKANIK BONINITI TË OFIOLITEVE LINDORE	Bajkeandritëboninitike														
	0.13 <sup>c</sup>	0.780 <sup>d</sup>	0.750	0.754	0.765	0.770	L.8	2100A	3037	0465	0471	051	075	0.10	
SiO <sub>2</sub>	47.03	46.89	53.04	50.45	51.20	49.68	52.87	50.80	52.27	54.28	51.25	53.56	50.53	48.51	
TiO <sub>2</sub>	0.39	0.30	0.44	0.45	0.64	0.57	0.97	0.21	0.7	0.59	0.16	0.26	0.35	0.24	
H <sub>2</sub> O <sub>j</sub>	9.70	11.15	14.85	12.99	14.41	15.20	13.32	13.82	15.33	12.87	9.86	10.47	13.12	11.55	
F <sub>2</sub> O <sub>j</sub>	5.06	4.18	3.06	3.2	4.30	5.90	4.25	3.63	3.30	6.96	4.58	1.23	4.43	3.23	
FeO	3.11	4.71	4.73	5.22	4.40	3.68	3.92	5.73	7.26	3.55	5.10	4.62	3.66	5.1	
WnO	0.19	0.16	0.02	0.11	0.74	0.12	0.76	0.19	0.10	0.18	0.22	0.28	0.34	0.15	
MgO	12.12	15.30	9.94	9.28	2.80	9.63	7.28	8.65	9.62	9.67	15.12	17.11	19.34	11.12	
CoO	9.26	6.48	6.51	10.49	6.60	6.42	7.57	8.70	2.81	4.73	2.37	3.53	2.83	6.44	
Nd <sub>2</sub> O	0.54	0.66	2.12	1.91	3.22	1.89	0.55	0.58	2.85	0.46	0.46	1.83	1.83	1.90	0.80
F <sub>2</sub> O	0.32	0.14	1.14	0.39	0.41	1.39	0.41	0.33	0.05	0.59	0.15	0.18	0.43	0.65	0.21
NiO	—	0.05	0.01	0.015	0.032	0.019	—	—	—	0.03	—	—	—	—	—
CaO <sub>j</sub>	—	0.03	0.035	0.062	0.065	0.03	—	—	—	0.22	0.38	—	—	—	—
P <sub>2</sub> O <sub>5</sub>	—	0.07	—	—	—	0.11	—	—	—	—	0.06	—	—	—	—
H <sub>2</sub> O <sub>j</sub>	12.59	10.02	4.28	4.91	6.4	5.4	8.57	7.83	5.31	6.24	2.85	3.26	2.37	5.50	
H <sub>2</sub> O <sub>g</sub>	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	0.26	1.17	2.25
Shuma	100.31	100.17	100.20	99.50	99.82	100.05	99.25	99.33	99.71	99.72	99.88	99.94	100.3	99.95	99.95
Si	5.76	1.99	4.54	2.32	2.89	3.46	18.07	11.81	8.79	24.86	5.17	4.29	21.8	3.29	—
CO	—	—	—	—	—	0.47	—	—	6.75	2.42	—	—	—	—	—
OR	2.15	0.92	3.01	2.46	2.58	8.69	2.77	2.74	0.93	5.86	0.95	1.1	2.71	3.90	—
AB	5.51	6.47	19.67	18.09	30.87	13.17	5.51	5.75	26.95	3.91	4.11	4.91	2.47	6.26	—
AN	26.25	29.47	28.45	27.07	25.10	32.91	36.67	37.5	14.66	23.54	27.25	20.1	19.3	23.6	—
WnO	10.42	2.02	1.97	11.16	3.89	—	2.46	2.31	—	—	0.16	9.33	6.63	3.49	—
EN	38.37	46.92	28.03	22.21	23.12	28.3	22.74	26.44	28.14	21.58	42.57	24.92	21.04	29.72	—
FS	8.71	9.99	7.13	8.42	8.73	9.59	9.55	11.36	10.95	—	11.31	11.37	9.41	11.21	—
MT	2.27	2.06	2.09	2.15	2.39	2.25	1.96	1.96	2.47	10.08	1.19	1.39	2.08	0.93	—
IL	0.62	0.47	0.64	0.67	0.86	0.80	0.27	0.32	1.03	1.14	0.23	0.29	0.55	0.46	—
AP	—	0.12	—	—	—	0.25	—	—	—	—	0.10	—	—	—	—
SAL	39.67	38.85	59.66	50.39	61.51	58.8	63.02	57.2	57.47	60.59	32.94	42.61	51.71	39.72	—
REM	60.33	61.35	40.34	49.61	38.49	41.2	36.98	42.8	42.53	33.16	61.05	57.71	39.72	—	—

0.13<sup>c</sup>, 0.51, 0.75<sup>d</sup> Reniallë

0.780A Simonji

0.750, 0.754, 0.765, 0.770 Perlaf:

L.8-Lumbardhë

2100<sup>A</sup> 3037, 0468, 431 Kodën-Spac-Gurth

B-Baminitë i Freskët, Tsuri-Rama (Kurodatet 1978)

10.-Biominitë Troodes (Qibro) Caneroni 1983




Fig. 6. — Diagrami i përbajtjes së  $K_2O$  ndaj përbajtje së  $SiO_2$  për xhamet vullkanike (·) dhe boninitë (·) nga ofiolitet e Shqipërisë i kahasuar me prirjet e serive të ndryshme orogenjike (Sip Hughes 1982).

$K_2O$  versus  $SiO_2$  diagram for volcanic glasses and boninites from Albanian ophiolite compared with trends of various orogenic series (after Hughes 1982).

Në bazë të përbërjes së  $TiO_2$  e  $K_2O$  boninitet e ofioliteve lindore rezultojnë toleite me Ti të ulët dhe K të ulët sipas Marcell dhe Ohnensteter (1984). Përbajtja e ulët e  $TiO_2$  (mesatarisht 0,42%) e  $K_2O$  (mesatarisht 0,43%) dhe rapporti i ulët i  $CaO/Al_2O_3$  (mesatarisht 0,51) i afroboninitet e ofioliteve lindore me serinë marianit-boninite. Në diagramat  $SiO_2$  dhe  $TiO_2$  ndaj rapportit  $FeO$  tot/ $MgO$  (Fig. 7,8) boninitet nga ofiolitet lindore së bashku me xhamet vullkanike shoqëruesh afrojnë me vullkanitet e ishujve Bonin e Tonga sipas Miyashiro (1975) dhe shprehin vlera të ulta të rapportit  $FeO$  tot/ $MgO$  për efekt të magnezialitetit të lartë. Në diagramën e Jensenit (fig. 9) boninitet nga ofiolitet lindore lokalizohen afër kufirit të fushës së bazalteve toleitik me magneziele dhe hekurore si dhe në fushën komatiteve bazaltike, ndërsa në diagramin AFM (fig. 0) ata lokalizohen më afër vijës kufizuese M-F dhe kulmit M, duke ndërtuar skajin më magnezial të prigesë evolutive të xameve vullkanike të ofioliteve lindore në tërësi.

Përbërjet kimike të boniniteteve dhe xameve vullkanikë të ofioliteve lindore të Shqipërisë janë kahasuar me prirjet për xhamet boninitike të Troodosit dhe boninitet e Marianës në diagramat  $FeO$ - $MgO$  dhe  $Al_2O_3$ - $MgO$  (fig. 11, 12) të dhëna nga Thy (1984); përbërjet e tyre janë të ngjashme, por xhamet vullkanike dhe boninitet e Shqipërisë dallohet për përbajtje pak më të ulët të Al; në diagramën  $Al_2O_3$ - $MgO$  ata lokalizohen në fushën ndërmjet prigesë së boniniteteve të Troodosit dhe Marianës dhe asaj të xameve abisalë; në diagramën  $FeO$ - $MgO$  atë




Fig. 7,8. — Diagramet e  $SiO_2$  (%) dhe  $TiO_2$  (%) ndaj rapportit  $FeO$  tot/ $MgO$ , për xhamet vullkanikë (·) dhe boninitet (·) nga ofiolitet e Shqipërisë. Prirjet sipas Miyashiro (1975).

$SiO_2$  and  $TiO_2$  versus  $FeO$  tot/ $MgO$  diagrams for volcanic glasses (·) and boninites (·) from Albanian ophiolite, Trends after Miyashiro (1975).

janë miaft afër prigesë së xameve boninitikë të Troodosit dhe Marianës, gjithashtu bie në sy lokalizimi i pikave figurative të boniteve të Shqipërisë në fushën me magnezialitet më të lartë.

Në diagramën  $CaO/TiO_2$ ,  $Al_2O_3/TiO_2$  kundrejt  $TiO_2$  boninitet nga ofiolitet lindore lokalizohen shumë afër fushave të veçuara për boninitet e Paqësorit Perëndimor nga Hickey dhe Fray (1982) (Fig. 13), ndërsa në diagramën  $Mg/(Mg+Fe)$  kundrejt  $SiO_2$  (Fig. 14), ata përkijnë me fushën e boniteve të Paqësorit Perëndimor sipas Hickey dhe Frey (1982). Në diagramën  $CaO$  kundrejt  $MgO$  (fig. 15), boninitet nga ofiolitet lindore të Shqipërisë lokalizohen në sektorin ndërmjet fushave të bonitimeve të Qipros që janë më kalijumorë dhe Kep Vogël që janë më pak kalijumorë dhe ngjasojnë më shumë me boninitet nga ishujt Bonin sipas Cameron etj. (1983), ndërsa në diagramën  $SiO_2$ - $MgO$  boninitet e Shqipërisë afrojnë më shumë me fushën e boniteve të Qipros të veçuar nga Cameron etj. (1983).

Të dhënat petrografike e gjeokimike të parashtruara në këtë artikull mbështetin plotësisht përdorimin e termit boninit për xhamet bazalto-andezitike-andezitike të pjesës së sipërme të prigesë së vullkaniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë.

#### 4. Mbi origjinën e boniniteteve dhe rrjedhimet petrologjike për ofiolitet e Shqipërisë

Të gjithë studjuesit e boniniteteve theksojnë se origjina e tyre është e lidhur me shkrirjen e pjesëshme të lëndës ultramafike të mantelit. Kuroda etj. (1978) theksojnë se studimet eksperimentale tregojnë se




Fig. 9 — Diagrami kationik i Jensenit që përfshin përqindjet e  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{FeO}+\text{Fe}_2\text{O}_3+\text{TiO}_2$  dhe  $\text{MgO}$  (Jensen 1976), i përdorur për xha met vulkanikë (·) dhe boninitet (·) nga ofiolitet e Shqipërisë.

Fig. 9 — Jensen cation diagram involving the cation percentages  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{FeO}+\text{Fe}_2\text{O}_3+\text{TiO}_2$  and  $\text{MgO}$  (Jensen 1976), used for volcanic glasses (·) and boninites (·) from Albanian ophiolites.

magma e përbërjes boninite mund të jetë në ekuilibër me peridotitin e mantelit të sipërm në presion më pak se 17 Kb. dhe temperaturë 1200–1050° nën  $\text{P}_{\text{H}_2\text{O}}$  të lartë. Është sugjeruar së boniniti është një produkt i ftohur (900°C) në fundin e detit i një shkrirjeje të pjesëshme të drejt për drejtë të mantelit të sipërm. Shiraki etj. (1980) ritheksojnë se boninitet mund të kenë qenë formuar nga shkrirja e pjesëshme ekstensive e peridotitit të hidratuar në presione relativisht të ulta dhe nga ftohja e shpejtë në thellësi të vogla. Sipas eksperimenteve të Green (1973) për shkrirjen e pjesëshme të pirolitit të ngopur me ujë ka rezultuar një shkrirje në temperaturë 1200°C e presion 10 Kbar që ka veçuar rrëth 35% shkrirje të llogaritur me përbajtje 54%  $\text{SiO}_2$ , 14%  $\text{MgO}$ , raport  $\text{Mg}/(\text{Mg}+\text{Fe})=0,73$  dhe  $\text{CaO}/\text{Al}_2\text{O}_3=0,88$ , që janë karakteristikat kryesore të boniniteve. Cameron etj. (1979) i konsiderojnë boninitet si ekuivalente fanerozoikë nga ana petrologjike, mineralogjike e kimike të komatiteve bazaltike. Ka mundësi që boninitet dhe ofiolitet që përbajnjë boninite të janë formuar në vend nga shkrir-




Fig. 10 — Diagrami AFM i boniniteteve nga ofiolitet e Shqipërisë.

a) Kufiri ndarës i serisë toleitike dhe kalçium-alkalinore (sipas Irvine dhe Baragar 1971).

b) Prirja e evolusionit të xhameve vulkanike të ofioliteve të Shqipërisë (sipas Shallø 1987).

AFM plot of boninites from Albanian ophiolite.

Boundary line between tholeiitic and calc-alkaline series after Irvine and Baragar (1971). Evolutionary trend of volcanic glasses from Albanian ophiolite (after Shallø 1987).

ja e pjesëshme e peridotiteve që i mbishtrohen pllakës zhytëse nga një mjedis harku ishullor. Sipas Crawford etj. (1981) natyra refraktare e magmave parësore boninitike shpreh qartë se ato janë veçuar nga një peridotit shumë i varfëruar i cili tashmë ka pësuar një ose më shumë episode të shkrirjes në shkallë relativisht të lartë. Beccaluva etj. (1986) theksojnë se rivlerësimi i serisë boninite dhe shkëmbinjve të lidhur me ta nxjerr në pah se bazaltet me Ti të ulët, që emërtohen edhe si boninite kalimtare megjithëse janë të ndryshme nga boninitet, janë gjeneruar nga magma primare që kërkojnë shkallë shkrirjeje të lartë (15-20 %) të një burimi mantelik të varfëruar nën kushte hidrike por jo medoemos të ngopur me ujë në presione kur ortopirokseni shkrin në mënyrë inkongruente (10 kb). Jacques dhe Green (1980) theksojmë se magmat primare të natyrës së toleiteve kuarcore magneziale ose të toleiteve të varfër në olivinë, të bazalteve të ofioliteve të Troodosit, Papuasë etj., janë formuar nga shkrirja e pjesëshme dhe segregimi i magmës nga peridotiti refraktar në 10-25 km thellësi. Gjithashtu këta studjues theksojnë se toleitet kuarcore të varfër me Ti




Fig. 11,12 — Diagramat e varacionit  $\text{FeO}-\text{MgO}$  dhe  $\text{Al}_2\text{O}_3-\text{MgO}$  që tregojnë xhamet vullkanikë nga ofiolitet e Troodosit dhe hullia Mariana (sipa Thy 1984) dhe xhamet vullkanikë e boninitet nga ofiolitet e Shqipërisë.

1. xhamet vullkanikë dhe boninitet nga ofiolitet e Shqipërisë; 2. boninitet e Troodosit; 3 boninitet e Marianës; 4. marianitet; 5. andezitet oceanikë; 6. andezitet kontinentale; 7. xhamet vulkanikë abisale.

Variation diagrams  $\text{FeO}-\text{MgO}$  and  $\text{Al}_2\text{O}_3-\text{MgO}$ , showing boninite glasses from the Troodos ophiolite and Mariana (after Thy 1984) and boninite glasses from Albanian ophiolites.

1. Volcanic glasses and boninites from ophiolite.
2. Troodos boninite.
3. Mariana Boninite. 4. Marianite; 5. Oceanic andesites; 6. Continental Andesites; 7. Abyssal glasses.

me raporte të larta  $\text{Al}_2\text{O}_3/\text{TiO}_2$  mund të jenë gjeneruar nga shkrirje anhider e peridotitit të varféruar në kushte të presionit të ulët, dha se boninitet mund të përfaqësojnë shkrirje të ngopur me ujë të peridotitit refraktar në thellësi të vogël (Green 1973, 1976). Hickey dhe Fray (1982) theksojnë se sektorët e peridotitit më pak të varféruar mund të prodrojnë toleitet ndërsa sektorët e peridotitit refraktar mund të prodrojnë boninitet. They dhe Moores (1988) theksojnë se mjaf të dhëna nga ofiolitet Troodosit janë në favor të formimit të këtyre ofioliteve në një basen jetëshkurtër të formuar me anë të rrëshqitjes (splitting) në një hark nëndetar të pamaturuar. Në bazë të pranisë së vullkaniteve të ngjashme me serinë marianit-boninite ose të xhameve vullkanike të ngjashme me boninitet (S.L.) në ofiolitet lindore të Shqipërisë është theksuar se ata janë gjeneruar në kushte të ngjashme me ato të sugjeruara për ofiolitet e Troodosit; origjina e magmës primare të xhameve vullkanike dhe të shkëmbinjve të tjera vullkanikë e plutonikë shoqëruar të ofioliteve lindore të Shqipërisë kërkon një shkallë të lartë shkrirjeje të burimit mantelor të varféruar në kushte hidrike mbi një mjesid supra-subduksioni intraoceanik (Shallo 1987 në shtyp).

Prania e boniniteteve ndërmjet vullkaniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë paraqet interes të veçantë për interpretimet petrologjike. Mbëbasën e pranisë së tyre mbështetet veçimi në ofiolitet e vendit tonë i ofioliteve të tipit të dytë (lindor) analog me ofiolitet lindore Mesdhetare-Alpine (Shallo etj. 1985, 1987). Në bazë të ngjasimit petrografik e




Fig. 13 — Variacioni i raporteve  $\text{CaO}/\text{TiO}_2$  dhe  $\text{Al}_2\text{O}_3/\text{TiO}_2$  me përbajtjen e  $\text{TiO}_2$  në shkëmbinjtë e seri të boninitë, toleitet e harqeve ishullorë nga shpimi DSDP 458 dhe bazaltet e kurizoreve mesooceanike (MORB) e boninitet shqiptare. Të dhënat si dhe fushat jepen sipas Hickey dhe E. Fray (1982).

Variation of  $\text{CaO}/\text{TiO}_2$  and  $\text{Al}_2\text{O}_3/\text{TiO}_2$  ratios with  $\text{TiO}_2$  content in boninite series rocks, island arc tholeites from DSDP Site 458 and MORB and Albanian Boninite. Data and fields after Hickey and Fray (1982).





Fig. 14. — Diagrami  $\text{Mg}/(\text{Mg} + \text{Fe})$  kundrejt  $\text{SiO}_2$  që tregon shkallën e varacionit në shkëmbinjtë e seri të boninitë. Shkallët për bazaltet e MORB të pasur me Mg dhe komatitet janë treguar për krasim. Të dhënat dhe fushat jepen sipas Hickey dhe Fray (1982).

Plot of  $\text{Mg}/(\text{Mg} + \text{Fe})$  versus  $\text{SiO}_2$  showing the range of variation in boninite series rocks. Ranges for Mg-rich MORB-s and Komatiites are shown for comparison. Data and fields after Hickey and Fray (1982).






Fig. 15 — Variacioni i  $\text{SiO}_2$  dhe  $\text{CaO}$  në lidhje me përmbytjen e  $\text{MgO}$  (pesha në përqindje) në boninitë e rillogaritur anhider; fushat jepen sipas Cameron et al. (1983); fusha e boninitëve të ofioliteve të Shqipërisë.

$\text{SiO}_2$  and  $\text{CaO}$  variations with  $\text{MgO}$  content (wt. %) in boninites, recalculated anhydrous. Data and fields after Cameron et al 1983; field of boninite from Albanian ophiolites.

gjeokimik të xameve boninitike të ofioliteve të vendit tonë me ato të Troodosit dhe të Pajesorit Perëndimor favorizohen korelime të shkalle më globale dhe interpretime më të drejta të mjedisit paleogeografik të formimit të ofioliteve lindore të Shqipërisë. Duke marrë parasysh arritjet eksperimentale në fushën e sintezave petrologjike shkëkohore mbi origjinën e boninitëve mund të supozohet se formimi ofioliteve lindore të Shqipërisë është i lidhur me zhvillimin e shkrirjeve lindore të Shqipërisë në zonë e një peridotiti mantelik paraprakisht të vështirë pjesëshme intensive të një peridotiti mantelik paraprakisht të vështirë.

fëruar, që mund të kenë qenë përfaqësuar nga peridotiti analoge me ato të brezit perëndimor të ofioliteve të Shqipërisë në kushte ujmbajtëse e të presionit të ulët. Shoqërimet shkëmbore vulkanike si dhe analogët plutonikë të tyre dhe seria e dajkave paralele në ofiolitet lindore mund të konsiderohen si derivate të shkrirjes parësore boninitike, ndër të tjera llojet dacitike-riodacitike mund të konsiderohen si prodhimet më skajore relativisht të pasura në silic e hekur pas largimit të porcioneve më bazike. Mjedisi paleogeografik që favorizon zhvillimin e dukurive të tillë mund të këtë qenë ai pranë një harku ishullor mbi një zonë subduksioni intraoceanik.

## PERFUNDIME

1. Nëpërmjet vulkaniteve të pjesës së sipërme të prerjes së serisë bazalto-dacitike të ofioliteve lindore takohen boninitë, veçoritë petrografike e gjeokimike të të cilëve janë të afërtë me ato të boninitëve të ofioliteve të Troodosit (Qipro) dhe me boninitet e Paqësorit Perëndimor.

2. Prania e boninitëve ndërmjet vulkaniteve të ofioliteve lindore të Shqipërisë mbështet plotësisht veçimin e ofioliteve lindore dhe përkatesinë e tyre në tipin e dytë (lindor) të ofioliteve Mesdhetare-Alpine.

3. Origjina e boninitëve të ofioliteve lindore në analogji me interpretimet e origjinës së boninitëve të rajoneve të tjera dhe në bazë të rezultateve të studimeve eksperimentale pranohet e lidhur me zhvillimin e shkrirjes së pjesëshme intensive të një peridotiti mantelik paraprakisht të varfëruar në kushte ujëmbajtëse e të presioneve të ulta.

4. Shoqërimet shkëmbore vulkanike e plutonike shoqëruan të ofioliteve lindore mund të konsiderohen si derivate të shkrirjes parësore boninitike, ndërsa llojet dacitike-riodacitike mund të konsiderohen si prodhimet më skajore relativisht të pasura me silic dhe hekur.

5. Mjedisi i formimit të boninitëve dhe i ofioliteve lindore në tërësi pranohet ai i një harku ishullor ensimatik mbi një zonë subduksioni intraoceanik.

## LITERATURA

- Beccaluva L., Serri G., Dostal J. (1986). Geochemistry and petrology of tholeiitic lavas from Mariana and Yap, trenches bearing of the genesis of low Ti island basalts and boninites (Extended abstract). Ophioliti 11 (2).
- Cameron W.E., Nisbet E.G., Dietrich W.J. (1979). Boninites, Komatiites and ophiolite Basalts. Nature vol. 280.
- (1980) Petrographic dissimilarities between ofiolitic and ocean-floor basalts. Ophiolites. Proceedings International Ophiolite Symposium. Cyprus.
- Cameron W.E., McCullough M.T., Walker D.A. (1983). Boninite petrogenesis: chemical and Nd-Sr isotopic constraints. Earth Planet. Sci. Lett. 65.
- Cameron W.E., Nisbet E.G. (1982). Komatiites.

- Crawford A.J. Beccaluva L, Serri G. (1981). Tectono-magmatic evolution of the West Philippine-Mariana region and the origin of boninites. *Earth Planet. Sci. Lett.* 54.
- Jacques A.L., Green D.H. (1980). Anhydrous Melting of Peridotite at 0-15 Kb Pressure and the Genesis of Tholeiitic Basalts. Contributions to Mineralogy and Petrology. 73.
- Jensen L.S., Pyke D.R. (1982). Komatiites in the Ontario portion of the Abitibi belt. *Komatiites*.
- Kuroda N, Shiraki K, Urano H. (1978). Boninite as a Possible Calc-alkalic Primary Magma. *Bull. Volcanolog.* V. 41-4.
- Kuroda N, Shiraki K, Urano H. (1988). Ferropigeonite quartz dacites from Chichijima, Bonin Islands: Latest differentiates from boninite-forming magma. Contributions to Mineralogy and Petrology. 100.
- Pearce J.A., Lippard S.J., Roberts S. (1984). Characteristics and tectonic significance of supra-subduction zone ophiolites. In B.P. Kikeleau Howells (Eds): «Marginal basin Geology», Geological Society Blackwell Scientific Publication.
- Hickey R.L. and Fray F.A. (1982). Geochemical characteristics of boninite series volcanics: implications for their source. *Geochimica et Cosmochimica Acta* vol. 46.
- Shallo M. (1970). Informacion mbi rezultatet paraprake të punimeve tematike në vendburimin e Rënollës, Tiranë. AQGjeol.
- Shallo M, Kote Dh, Vranai A, Premiti I. (1985). Magmatizmi ofiolitik i RPSSH Tiranë. Arkivi Qëndror i Gjeologjisë.
- Shallo M, Kote Dh, Vranai A. (1987) Geochemistry of the volcanics from ophiolitic belts of albanides. *Ofoliti* 12 (1).
- Shallo M. (1987) Volcanic glasses of the ophiolitic belt of Albanides. In Ophiolites and oceanic lithosphere, Proceedings International Symposium Cyprus. Në shtyp.
- Shiraki K, Kuroda N, Urano H. (1980) Clinoenstatite in boninites from the Bonin Islands, Japan. *Nature* vol. 285.
- Sund S.S., Nesbitt R.W. (1978). Geochemical regularities and genetic significance of ophiolitic basalts. *Geology*, 6.
- Thy P. (1984). The nature of Troodos boninites, Cyprus. *Ofoliti* 9 (3).
- Thy P, Moores E.M. (1988). Crustal actretion and the tectonic setting of the Troodos ophiolite. Cyprus. *Ofoliti* 13 (1).

Dorëzuar në redaksi në gusht 1990

#### Summary

#### BONINITE AMONG THE «EASTERN» OPHIOLITES OF ALBANIA

The rhyodacitic andesitic and basaltandesitic volcanic glasses are widely spread among the volcanites which build up the upper part of the Albanian eastern ophiolite suite. Among them, boninites of petrographic and geochemical features similar to the typical boninites of Bonin islands in the western Pacific occur. The boninites of Albanian ophiolite outcrop in the lensbanded shape of

about 10-15 m thickness, alternating with andesite-basalt volcanicites (fig. 2). They are of massive, pillow, pillow-pyroclastic form, sometimes amygdaloid of dark grey into black colour with vitropothyre, vitrophyre and andesite structure. They are constituted by clinopyroxene, and rarely orthopyroxene and olivine phenocrysts and andesitic-basaltic glass ( $N = 1,515$ ), partly replaced by chlorite. Sometimes the clinopyroxene forms a lot of microphenocrysts and microlites (about 40-60% of the rock mass). They are set in the glass mass (fig. 4). The accessory chromespinel rarely occurs.

The chemical and normative mineral composition of the albanian boninites is given in the table Nr. 1;2; for comparison are given chemical compositions of boninites from Troodos ophiolite and Bonin islands. They are characterized by high content of  $H_2O$  and Si. They are oversaturated tholeiites with low content of Ti and K. The lower  $TiO_2$  content (average 0,42%),  $K_2O$  content (average 0,43%) and lower  $CaO/Al_2O_3$  ratio (average 0,51) approach them to the marianite-boninite series: they are typified as magnesian, iron-magnesian tholeiites and komatiite basalts (fig. 9); the comparison between the chemical composition of boninites of albanian eastern ophiolites and those of Troodos ophiolite and Bonin islands (table Nr. 1 and fig. 11,12,13,14,15) show a remarkable similarity.

The presence of the boninite series amongst the Albanian eastern ophiolites support the belonging of those ophiolites to the second type (eastern) of mediterranean-alpine ophiolites, and favours global correlations of the Albanian ophiolites with those of the other regions of the world.

The origin of boninites of eastern ophiolites, on the analogy with boninites of the other regions and on the base of the experimental data, is connected with the evolution of an intensive partial melting of a depleted peridotite mantle under hydrous and low pressure conditions.

The associated volcanic and plutonic rocks of the Albanian eastern ophiolites, may be considered as derivates of the boninitic primary magma while the rhyodacitic-dacitic ones may be considered as the final products relatively enriched in iron and silica.

The generation of the boninites and of the Albanian eastern ophiolites in general requires a supra-subduction intraoceanic setting.

## GJEOLOGJIA E RAJONIT TË VERMOSHIT

Luftulla Peza\*, Dëfrim Shkupi\*, Ismail Turku\*\*, Iliaz Terolli\*

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të Vermoshit marrin pjesë formacionet e tre njësive të ndryshme tektonike, të cilat mbihipin njëra mbi tjetrën me drejtum veri jugë: Zona e Gashit, zona e fllshit të Kelmendit dhe nënzonë e Valbonës, nga të cilat dy të parat janë objekt i këtij artikulli.

### H Y R J E

Vitet e fundit përfundoj studimi: «Stratigrafia, paleogeografija dhe mineralizimi i hekurit në depozitimet mesozoike të rajonit të Vermoshit» (Peza etj. 1988).

Nga punimet u mblohdhën të dhëna, të cilat dhanë mundësinë, që të avancohet njohja gjeologjike e rajonit në aspektet e stratigrafisë, tektonikës, paleogeografisë, vullkanizmit, mineralmbajtjes etj. Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të Vermoshit marrin pjesë formacionet gjeologjike të tri njësive të ndryshme tektonike, të cilat njëra me tjetrën kanë marrëdhënie mbihipëse-mbulesore. Këto njësi nga veriu në jug janë: Zona e Gashit (sektori i Vermoshit) analoge e Zonës së Durmitorit, zona e fllshit të Kelmendit (analoge e zonës Bosnjake), dhe nënzonë e Valbonës e zonës së Alpeve Shqiptare (analoge e zonës Përkarstike (fig. 1). Dy të parat janë objekt i artikullit.

Të dhëna të shkurtra mbi studjueshmérinë gjeologjike të rajonit.

Të dhënat e para gjeologjike për rajonin e Vermoshit jepen nga Franc Nopçë (1929).

Studimet e para më të plota për ndërtimin gjeologjik të rajonit të Vermoshit janë kryer gjatë goditjes së përqëndruar të ndërmarrë në Shqipërinë e Veriut (S. Dede etj. 1972). Në vitet 1972-1977 në këtë rajon janë bërë shumë vrojtime e studime nga gjeologët e N.Gj. Shkodër të

\* I.S.P. të gjeologjisë në Tiranë.

\*\* Fakulti i gjeologjisë dhe Minierave në UT «ENVER HOXHA».




Fig. 1 — Harta gjeologjike e rajonit të Vermoshit.

1 — Kuaternar; 2 — nëazona e Valbonës; 3 — fliš i zonës së Kelmendit; 4 — triasi i mesëm-ladinian; 5 — formacioni vullkanogeno-sedimentar; 6 — triasi i mesëm-anizian; 7 — triasi i poshtëm-kampilian; 8 — triasi i opshtëm-seisian; 9 — kufi midis formacioneve; 10 kufi mbihipë midis zonave.  
Geological map of Vermoshi region.

1 — Quaternary; 2 — Valbona subzone; 3 — flysch of Kelmendi zone; 4 — middle Trias-Ladinian; 5 — volcanicogen-sedimentary formation; 6 — middle Triassic-anisian; 7 — Lower Trias-Campilian; 8 — Lower Triassic-sesian; 9 — Boundary between formations; 10 — Thrust fault.

cilët si qëllim kryesor kanë pas kërkimin e mineraleteve të dobishme, sidomos të polimetaleve. Në vitet 1975-1977 u krye rilevimi gjeologjik në shkallë 1:10 000 nën drejtimin e gjeologut S. Bakri. Gjatë vitit 1975 e më pas në rajon janë kryer punime kërkim-vlerësimi për polimetale e zhivën në Trojan, Sefercë, Përbicë etj., të shoqëruara me punime gjeofizike. Këto punime janë kryer nga S. Bakri, E. Delaj, K. Treska, S.

Rudha, M. Malaveci etj. Autorët A. Papa etj. (1977) përmendin flišin mesozoiq të Vermoshit të cilin e datojnë kretë e poshtme-cenomanian në bazë të Ticinellave. Këtë fliš autorët e paralelojnë me flišin bosnjak në Dinaride dhe me flišin e Gramozit. Më vonë për këtë në rajon janë kryer studime petrografike (A. Duraj, 1979) e mineralogjike (H. Tuzi, 1979). Në punimin mbi kretën e zonës së Alpeve Shqiptare (Peza 1981) në luginën e Vermoshit ndahet zona e flishit të jurës së sipërme-kretës që është vazhdim e paralelohet me zonën bosnjake të Dinarideve. Sipas tij, ky fliš mbihip mbi nënzonën e Valbonës dhe mban mbi vete depozitimet triasike të zonës së Grashit. Në hartën gjeologjike të Shqipërisë në shkallën 1:200 000 dhe në tekstin e saj sqarues (1982), në rajonin e Vermoshit dallohen depozitimet terigjene të triasit të poshtëm si dhe ato karbonatike dhe vullkanitet e anizianit. Flishi që kufizon me këto formacione jepet me moshë jurë e sipërme-kretë e poshtme dhe mbihip mbi nënzonën e Valbonës.

Me studimet e tyre V. Grillo, I. Turku, S. Bakri (1983) dallojnë depozitimet terigjene të permo-triasit, gëlqerorët shtresëhollë të zinj të verfenian-anizianit, gëlqerorët masiv të dolomituar të anizianit, shkëmbinjtë vullkanogeno-sedimentarë, gëlqerorët, rrreshpet silicore të ndërthurura me tufë e tufite të andeziteve të anizianit, gëlqerorët plakorë dhe thjerza silicorësh të ladininanit dhe gëlqerorët masiv ngjyrë hiri në bezhë të triasit të sipërm-jurës së poshtme. Në këto punime pjesa më e madhe e ndarjeve kronostratigrafike nuk kanë mbështetjen faunistike.

Në vitin 1984 nga gjeologët V. Kici, D. Marku, E. Dodona e J. Kanani në rajonin e Vermoshit u ndërmorën punime stratigrafike (Th. Gjata etj., 1985-1987). Në këto studime autorët veçojnë depozitimet terigjeno-karbonatike të verfenianit të sipërm dhe depozitimet karbonatike bashkë me vullkanitet e anizianit. Autorët mendojnë se në rajonin e Vermoshit ka dy formacione vullkanitesh (andezitesh) të ndarë njëri nga tjetri nga një pako gëlqerorësh e silicorësh. Niveli i sipërm i vullkaniteve mbyll prerjen në rajon dhe gëlqerorët që ndodhen faktiskisht mbi vullkanitet autorët i paralelojnë me ato që ndodhen në vullkanitet duke i menduar të dalë sipër përfekte të rrudhosjes.

Sipas vrojtimeve tona në rajonin e Vermoshit ka vetëm një nivel vullkanitesh, gjë që konfirmohet edhe nga të gjithë autorët e tjerë të vendit ose të huaj që kanë studjuar rajonin e Vermoshit e zonën e Durmitorit në Dinaridet.

Kohët e fundit A. Duraj (1987) ka shkruar për përbërjen petrografike të shkëmbinjve vullkanikë të zonës së Vermoshit duke i përcaktuar këto të llojit efuzivo-sedimentar, mesataro-acid dhe të përbërjes petrokimike andezite, riolite, me pamje tipike porfire dhe analogët piroplastikë të tyre: tufet dhe tufitet. Në këtë artikull është dhënë dëshni që dukuri e vogël shkëmbinjsh plutonikë granodioritikë në sekitorin e Seferçës i cili nuk konfirmohet nga punimet tona.

## STRATIGRAFIA

### Zona e Gashit (sektori i Vermoshit)

Në rajonin e Vermoshit janë ndeshur depozitimet e triasikut të poshtëm e të mesëm si dhe shkëmbinjtë vulkanogjeno-sedimentar (fig. 2).




Fig. 2 — Korelimi i prerjeve të rajonit të Vermoshit (Shkalla 1:4000).

1. Gëlqerorë; 2 — gëlqerorë nodularë (Hanbulog); 3 — gëlqerorë me silicorë; 4 — gëlqerorë mergelorë; 5 — gëlqerorë brekçiorë turbiditike; 6 — gëlqerorë shtresëtrashë deri në masivë; 7 — dolomite; 8 — mergele tufite; 13 — riolite; 14 — hekur.

#### Correlation of sections of Vermoshi region.

- 1 — V Limestones; 2 — nodular limestones (Hanbulog); 3 — siliceous limestones; 4 — marly limestones; 5 — turbiditic breccia limestones; 6 — thick-bedded up to massive limestones; 8 — dolomite; 8 — marls; 9 — sandstones; 10 — conglomerate; 11 — volcanites condesites; 12 — tuff tuffites; 13 — rhyolites.

### Depozitimet e triasit të poshtëm

Depozitimet e triasit të poshtëm ndeshen në sektorin e Vuçinit dhe në formën e një brezi të ngushtë zgjaten deri në kufirin lindor shtetëror. Brenda depozitimeve të triasit të poshtëm janë dalluar dy facie karbonatike që i përgjigjen respektivisht nën-katit Seis dhe atij Kampil.




Fig. 3 — Profili i Kërcit të Djegur

1. Gëlqerorët shtresëtrashë; 2 — gëlqerorë shtresëtrashë; 3 — dolomite; 4 — formacione vulkanogjeno-sedimentare; 5 — flishi Kelmendit; 6 — flishi nënzonës së Valbonës (Mastrichtian); 7 — mbihipje; 8 — gëlqerorë të zinj K-kampil A-anizian, L-ladinian.

#### — Profile of Kërci i Djegur

- 1 — Thick-bedded limestones; 2 — layered limestones; 3 — dolomite; 4 — volcanogenous sedimentary formations; 5 — Kelmend flysch; 6 — flysch of Valbona subzone (Mastrichtian); 7 — thrust; 8 — black limestones; K-Campilian; A-Anisian; L-Ladinian

Nënkatni Seis takohet vetëm në sektorin e Vuçinit dhe përbëhet nga shkëmbinj të formuar në ujra të cekta të facies klastike të përfaqësuara nga ndërthurje e imët e ranorëve kokërrimët, kokërrtrashë e mikrokonglomeratik dhe rreshpeve argjilore e alevrolitike. Rrallë ndërmjet tyre takohen dhe shtresa të holla gëlqerorësh mikritik. Trashësia e këtyre depozitimeve është mbi 50 m.

Në rajonet fqinjë në depozitime të njëjta janë takuar bivalvorët: *Claraia claraia*, *C. aurita*, *Homomya fassaensis*, *H. canalensis* etj. që vërtetojnë moshën e nënkatit Seis (Pantic 1975).

**Nënkatni kampil.** Depozitimet e këtij nënkatni janë të përhapura në trajtën e një brezi të ngushtë gjatë gjithë buzës veriore të luginesë së lumit të Vermoshit. Ato përfaqësohen nga ndërthurje të gëlqerorëve të zinj biomikritikë e mikritike shtresëhollë e rrallë shtresorë me shtresa mergelesh dhe gëlqerorësh mergelorë e rrallë dolomite. Në këto depozitime janë ndeshur: *Spirobis phiyctaenia*, *Ammodiscus parapriscus*, *Meandrospira pusilla*, *Glomospirella facilis*, *G. Sinensis*, *G. triphonensis*, *G. cf. elburorum* si dhe *krinoide*, *ostrakode* të rrallë etj. të cilët déshmojnë plotësisht për moshën e kampilit. Fragmente të kë-

tyre depozitimeve ndeshen dhe në malin e Trojanit. Trashësia e tyre luhatet nga 80-213 cm.

### Depozitimet e triasit të mesëm

**Aniziani** — Depozitimet aniziane paraqiten me ndryshime faciale nga një sektor në tjetrin. Në prerjen e Kërcit të Djegur përbëhen nga dy pako litologjike, të cilat nga poshtë lart janë:

a — *Pakua e gëlqerorëve dolomitik*. — Përbëhen nga gëlqerorë shtresëtrashë deri në masiv që kalojnë në shtrirje në gëlqerorë dolomitik e dolomite. Gëlqerorët janë të facies neritike, kryesisht biomikrosparitikë e më rrallë biomikritikë, në pjesën e sipërme algorë. Në to janë ndeshur: *Trochammina*, *Endothyranella* sp., *Thaummatoporella* sp. dhe *ostrakodë*, *radiolarë* e *kronoidë* të rrallë, të cilat dëftojnë për praninë e anizianit.

b — *Pakua dolomitiko-gëlqerore rozë*. — Përbëhet nga gëlqerorë shtresëtrashë dhe masivë ngjyrë rozë me shtresa dolomitesh (dolosparitesh). Gëlqerorët janë të llojeve biomikritike, biopelmkritikë etj. Këto depozitime i përkasin facies neritike algore dhe përbajnjë hidroksid hekuri që u jepin atyre ngjyrën e kuqerremtë. Rrallë ndërsa mjet tyre ka shtresa gëlqerorësh ngjyrë hiri. Mbi këta gëlqerorë vendoset një horizont i hollë hekuri disa centimetra i trashë e me ngjyrë të kuqe në vishnjë. Në këto depozitime janë ndeshur komplekse të varfra fosilesh, pasi janë mjaft të rikristalizuar, nga të cilat përmendim: *amonite* të ruajtura dobët të gjinisë *Ptychites*, dhe mikrofauna *Reophax* sp., *Nodosaria* sp., *Dentalina* sp., si dhe *bivalorë pelagjike*, *radiolarë*, *krinoidë* etj. Këta gëlqerorë i përkasin facies hambuloge të anizianit, megjithëse jo në pamjen e saj tipike. Përbëjnë pjesën e sipërme të anizianit dhe pikërisht zonën me *Paraceratites trinodosus*. Trashësia e pakos është 148 m.

Në prerjen e Majës së Bojës depozitimet e anizianit përbëhen nga katër pako litologjike që nga poshtë lart janë (fig. 4).

a — *Pakua e gëlqerorëve shtresëtrashë* deri masivë, algorë, biomikrosparitik rozë rrallë me ndonjë shtresë dolomiti brekçiozë. Trashësia e tyre është 35 m.

b — *Pakua e gëlqerorëve algorë* të llojeve biomikritikë e biomikrosparitikë, ngjyrë hiri, shtresëtrashë deri në masivë. Në to janë takuar: *Endothyranella* cf. *wirzi*, *Earlindita* sp., *bivalve pelagjike radiolarë*, *krinoidë*, që datojnë triasin e mesëm. Trashësia e tyre është 128 m.

1) Përcaktimet petrogafike u kryen nga P. Theodhori, ndërsa ato paleontologjike nga A. Pirdeni, të cilëve u shprehim falenderimet tona.




Fig. 4 — Prerja në majën e Bojës.

1. Gëlqerorë shtresorë ladinianë; 2 — gëlqerorë të laminuar; 3 — gëlqerorë shtresëtrashë masiv; 4 — dolomite; 5 — gëlqerorë mergelorë të triasit të poshtëm (campilian); 6 — formacioni vulkanogeno-sedimentar; 7 — flishi i Kelmendit; 8 — flishi i nënzonës Valbonës; 9 — horizonti i hekurit; 10 — gëlqerorë të triasit të sipërm; 11 — rrafshi i mbihipjes; K-Campilian, A-Anizian; L-Ladinian.

#### Profile of Maja e Bojës.

1 — Ladinian layered limestones; 2 — laminated limestones; 3 — massive thick-bedded limestones; 4 — dolomites; 5 — marly limestones of Lower Trias (Campilian); 6 — volcanogenous-sedimentary formation; 7 — Kelmendi flysch; 8 — flysch of Valbonë subzone; 9 — Iron horizon; 10 — limestones of Upper Trias; 11 — Thrust plane. K-Campilian; A-Anisian L-Ladinian.

c — *Pakua e gëlqerorë brezorë*: të facies algore, me pamje brezore, shtresëhollë, të rikristalizuar. Trashësia e pakos është 125 m. Midis gëlqerorëve të kësaj pakoje vendoset horizonti i hekurit (hematitik-magnetitik) (Shkupi etj. 1989).

d — *Pakua e gëlqerorëve* të facies algore, të cilat ndërthuren rrallë me shtresa dolomitesh. Në ta ndeshen: *Endothyranella* cf. *wirzi*, *Thaummatoporella* sp. e alge, të cilat dëshmojnë për anizianin. Trashësia është 120 m.

Në prerjen e Jaçicës depozitimet aniziane përbëhen nga dy pako:

a — *pakua e gëlqerorëve algorë* masiv dhe b — *pakua dolomitike*.

Në prerjen e Vuçinit depozitimet aniziane përbëhen nga dy pa-

ko: a — pakua gëlqerore-mergelore dhe b — pakua e dolomiteve të kuq.

Në prerjen e Sefergës (fig. 5) depozitimet e anizianit përbëhen nga ndërthurje paketash gëlqerorësh shtresëhollë të llojeve biomikritikë me paketa gëlqerorësh nodularë, shtresorë, të llojeve biomikritikë e radiolaritike. Këta gëlqerorë ndërthuren dhe me shtresa të rralla mergelesh ngjyrë hiri. Përbajnjë dhe thherza apo shtresa të rralla silicorësh të kuq.




Fig. 5 — Profil i Sefergës

1 — Dolomite shtresëtrashë; 2 — gëlqerorë plakorë; 3 — gëlqerorë plakorë e silicorë; 4 — gëlqerorë konglomeratik; 5 — gëlqerorë shtresëtrashë; 6 — formacioni vulkanogjeno-simentar; 7 — prishja tektonike, L-Ladinian, A-Anizian.

**Profile of Seferça**

1 — Thick-bedded dolomites; 2 — Platy limestones; 3 — siliceous and platy limestones; 4 — conglomeratic limestones; 5 — Thickbedded limestones; 6 — volcanogenous sedimentary formation; 7 — Fault. L-Ladinian A-Anisian

Në këto depozitime takohen foraminiferët, algë, amonite, bivalvë pelagjike, krinoide, radiolarë e ostrakodë, ndër ta janë përcaktuar *Meahdrospira dinarica*, *M. Pusilla*, *Globochaeta alpina*, *Glomospirella sp.*, *Glomospira sp.*, *Endothyranella sp.*, që datojnë anizianin. Pamje e jashtme, ngjyra e këtyre gëlqerorëve si dhe pamja e ammoniteve vërtetojnë praninë e facies Hanbulog, që përbën zonën me *Paraceratites trinodosus* të anizianit të sipërm. Trashësia është 280 m.

Një sektor tjetër me përhapje më të kufizuar të depozitimeve të triasit të mesëm është dhe ai i Malit të Trojanit (fig. 6). Në këtë sektor pjesa e poshtme e karbonateve, që ndodhet në vullkanitet i për-

ket anizianit. Veçanti për këtë sektor është se brenda vullkaniteve ka thherza gëlqerorësh me trashësi 5-6 deri 20 m. Trashësia e tyre arrin në 150 m.

**Ladiniani** — Depozitimet e ladinianit kanë ndryshime të volgla faciale, nuk përbajnjë thherza silicorësh, janë të zhvilluar në facien algore e shtrihen mbi formacionin vulkanogjeno-simentar. Në prerjen e Kërcit të Djegur fig. 3) depozitimet e ladinianit përfaqësohen nga dy pako:

1. *Pakua dolomitiko-gëlqerore rozë* me trashësi 122 m. Në to janë takuar: *Clomospira sp.*, *Haplophragmella inflata*, *Reophax sp.*, *ostrakodë*, alge etj. të cilat vërtetojnë triasin e mesëm.

2 — *Pakua e gëlqerorëve algorë* — biomikrosparitik që mbizotërojnë në prerje, por që ndërthuren nga gëlqerorë biomikritikë, brekçiozë e dolomite. Brenda pakos ndahen katër nivele litologjike:

a — Niveli i poshtëm me gëlqerorë biomikrosparitik shtresëhollë të ndërthurur me shtresa gëlqerorësh biomikritikë me thherza të rralla silicorësh dhe me hidrokside hekuri. Në këta gëlqerorë me trashësi 73 m. janë ndeshur fragmente *Baccanella floriformis* (Përcaktimi i P. Theodhorit e L.H. Peza), *Endothyra sp.*, *Glomospira sp.*.

b — Niveli i dolomiteve (dolospariteve) shtresore 35 m. të pasur me pigmentë hekurore.

c — gëlqerorë brekçiozë hiri shtresorë, 54 m. të trashë që kanë edhe shtresa dolomitesh e përbajnjë hidrokside hekuri.

Në malin e Bojës mbi formacionin vulkanogjeno sedimentar shtrihen gëlqerorë hiri shtresorë të facies algore me shtresa të rralla dolosparitesh. Depozitimet rrallë përbajnjë material argjilor e hidrokside hekuri.

Në Sefergë në depozitimet ladiniane dallohen dy pako litologjike:

a — *Pakua gëlqeroro-strallore* e vendosur normalisht mbi formacionin vulkanogjeno-simentar dhe b — *pakua e gëlqerorëve algorë*, me të cilat ndërthuren shtresa dolomitesh (dolosparite). Fauna e ndeshur në këto depozitime përbëhet nga *Glomospirella sp.*, *Glomospira sp.*, *Ophalmidium sp.*, *Reophax sp.*, *Baccanella floriformis*, bivalve *pelagjike*, *ostrakode* etj. që vërtetojnë ladinianin.

Në malin e Trojanit mbi vullkanitet janë ndeshur gëlqerorë shtresëtrashë deri masivë e mjaft të rikristalizuar që zenë të njëjtin pozicion stratigrafik si depozitimet e lartpërmendura.

Depozitimet e mësipërme të trajtuara si ladiniane nuk kanë përfaqësimin e plotë facial për një argumentim të tillë, për shkak të rikristalizimit të lartë të shkëmbinjve, por duke i krahasuar me rajojet fqinjë, ku këto depozitime e kanë mbështjetjen fosile ladiniane, mendimi i dhënë është i justifikueshëm. Në zonën e Durmitorit në Mal të Zi (analog me rajonin e Vermoshit) mbi depozitimet aniziane të përfaqësuara me gëlqerorët e facies hambuloge shtrihen derdhjet e andeziteve, deciteve etj. dhe piroklastiket e tyre. Mbi vullkanitet, që përbëjnë vetëm një nivel shtrihen gëlqerorë të ndryshëm me *Posidonina widalina*, *Vidalina martana*, *Omphaloptycha aldrovandi*, *Daonella lomeli*, *Frondicularia woodwardi* etj. të cilat karakterizojnë ladinian (Mirkoviç 1970).




Fig. 6 — Profili në perëndim të Trojanit

1. Gëlqerorë shtresorë hiri (anizian); 2 — andezite;
- 3 — riolite; 4 — tufito; 5 — gëlqerorë masivë (ladinian).

#### — Profile in west of Trojan

- 1 — Bedded limestones (Anisian); 2 — Andesites;
- 3 — Phyllites; 4 — Tuffites; 5 — Massive limestones (Ladinian).

Edhe në rajone të tjera malazeze ka të njëjtën situatë gjeologjike (Pantiç 1975).

#### Formacioni vullkanogjeno-sedimentar

Ky formacion në rajonin e Vermoshit përfaqësohet nga shkëmbinj efuzivë dhe piroklastikë të përbërjes mesatare, mesataro-acide dhe acide (andezite, dacite dhe riolite). Veprimitaria vullkanike i përket ciklit tektono-magmatik të triasikut të mesëm dhe ka patur karakter nenujor. Vullkanitet gjenden ndërmjet shkëmbinjve sedimentar kryesisht karbonatike të triasit të mesëm dhe këta të fundit ndeshen dha si ndërshtresa ndërmjet vullkaniteve. Kemi të bëjmë me një seri vullkanogjeno-sedimentare, që ka përhapje të gjërë në Albanide, Helleni-

de e Dinaride ku emërtohet formacioni porfirit-strallor (B. Çiriç 1976).

Në sektorë të veçantë të rajonit të Vermoshit vihen re ndryshime relative në lidhje me zotërimin e facies, llojut petrografik dhe trashësisë së tyre. Këto p.sh. në Smutirogë derdhja e efuzivëve arrin trashësi rreth 3 m. me përbërje andezite. Në Seferçë pothuajse gjithë prerja përfaqësohet nga andezite. Trashësia është rreth 70 m. Në Gurin e Üjit të kuq zotërojnë tufitet e andezitet. Në Kérçin e Djegur formimi vullkanogjeno-sedimentar ka trashësi rreth 323 m dhe përfaqësohet nga shkëmbinj piroklastikë e efuzivë të përbërjes andezite dhe dacitike.

Në Trojan formacioni vullkanogjeno-sedimentar ka trashësi rreth 320 m dhe përfaqësohet kryesisht nga facia efuzive andezitike, dacitike dhe riolitike.

#### Zona e fllishit të Kelmendit

Këto depozitime takohen në shpatin verior të luginës të lumi të Vermoshit dhe zgjaten si brez i gjatë dhe i hollë në të dy anët e kufirit shtetëror. Ndeshen edhe në pjesën perëndimore të malësisë së Trojanit. Ato ndërtohen nga tri pako litologjike.

Pakoja e parë përbëhet nga shtresa të holla ranorësh, gëlqerorësh kalkarenitikë e më rrallë biokalkarenitike, shiste mergelore e më rrallë konglomerato e ndonjë thjerzë stralli.

Në depozitimet e kësaj pakoje dallohen dy nivele: 1 —niveli i poshtëm me mergele, në të cilët ndeshen *kalpionella* të neokomanit dhe 2 — niveli i sipërm me margele ku janë takuar *Orbitolina sp.*, *Bacinella irregularia*, *copra rudistesh*, të cilat mendojmë se dëftojnë për praninë e barremian-aptianit.

Pakua e mesme përbëhet nga ndërthurja e shisteve mergelore, biomikritike, ranorëve dhe shisteve argjilore, rrallë ndër to ka dhe shtresa të holla gëlqerorësh brekçiorë. Kanë trashësi rreth 620 m.

Pakua e sipërme ndërtohet nga ndërthurje të mergeleve mikritikë e biomikritikë, që mbizotërojnë, me ranorë, gëlqerorë biokalkarenitikë e shtresa të holla argjilore.

Në bazë të të dhënavë tonë brenda fllishit të Kelmendit faktohet neokomiani dhe barremian-aptiani, por nga një punim i mëparshëm (A. Papa etj. 1977) në këto depozitime fllshore afër Budacit janë ndeshur dhe *Ticinella sp.*, *Planomalina sp.*, dhe *Pithonella ovali* që dëshmojnë për kretakun e mesëm (albian deri në cenomanian). Në këtë mënyrë depozitimet e fllshit të Kelmendit nga njohja e gjertanishme vërtetohen si të kretës së poshtme gjër në cenomanian.

Edhe në rajonet fqinjë malazeze (Blanchet etj. 1969) fllishi bosnjak analog me të Kelmendit, ka gati të njëjtën përbërje litologjike dhe është mjaft i varfër në fosile. Përveç dy niveleve të përmendor nga ne në Kérçin e Djegur, është takuar edhe niveli me *Hedbergella* e *Ticinella* që mbrrin deri në cenomanian.

## Tektonika

Rajoni i Vermoshit përfshihet në zonën e Gashit dhe në zonën e Kelmendit. Në vendin tonë zona e Gashit përfaqëson dy kindet më jugore të zonës së Durmitorit (A. Crubiç 1980). Formacionet e zonës së Gashit janë të mbihipura mbi ato të zonës së Kelmendit.

Amplituda e zhvendosjes horizontale mendohet të jetë jo më pak se 10-15 km. në bazë të matjeve të fragmenteve në të gjithë zonën. Kjo zhvendosje ka ndodhur nga fundi i eocenit, në saj të lëvizjeve të fuqishme të tektojnëzës së fazës pireneje si rrjedhojë shkëmbinjtë e rajonit të Vermoshit paraqiten të rrudhosur, të deformuar e të shartojzhuar në drejtim VL-JP.

Në një studim më parë (S. Dede etj. 1975) pjesa triasike e rajonit të Vermoshit është trajtuar si antiklinali i përbysur i Marlulës, duke patur në bërthamë formacionin vulkanogjeno-sedimentar. Në tekstin svarues të hartës tektonike të RPSSH trajtohet si monoklinal ku evindentohen rrudha me përbysje jugore. Në kumtesën e J. Kananit, E. Dodonës, V. Kicit (1987), rajoni i Vermoshit ndahet në dy nënzonat: të vetë Vermoshit dhe të Seferçës. Nënëzona e Vermoshit paraqitet si sinklinal i përbysur me ndërtim luspor, duke i trajtuar dolomitet të vëndosura tektonikisht mbi shkëmbinjtë efuzivë.

Autorët mendojnë se nuk ka pse të ndahet kjo pjesë e Zonës së Gashit në dy nënzonat, pasi pothuajse janë të pranishme të njëjtat depozitime në të dy anët e sinklinalit të Vermoshit dhe depozitimet e facies Hanbuloge, që janë përshkruar vetëm në Seferçë (J. Kananit etj. 1987) janë gjetur prej nesh (L. Peza, etj.) dhe në krahun e mirilltë të Vermoshit, në Kërcin e Djegur.

## Paleogeografi

Gjatë epokës së hershme verteniane (nënkatni Seis) fundi i pellgut të sedimentimit ka qenë me mjaft oshilime. Rajoni i Vermoshit ka zë në pjesët anësore të këtij pellgu, ku sedimentohen formimet klastike me ranorët, konglomeratet, alevrolitet rreshpet etj. Në këtë mëdës janë zhvilluar në mikrofaciet e gëlqerorëve *brahiopode*, *bivalvorë*, *Europalia*, *Spirorbis* etj. në bazë të të cilave mund të themi se ujrat e këtij pellgu detar kanë patur përgjithësisht energji të lartë (zona lindore). Ato kanë qenë të ngrohta e me kripesi normale.

Gjatë epokës së vonshme verfeniani (nënkatni kampil) sedimentet u formuan pak më larg bregut, por gjithësesi në sfondin e një platforme karbonatike të cekët e me ujra të ngrohta. Në këto kushte më të qeta se më parë e me energji të lartë, u grumbulluan kryesisht llumra karbonate me prerje materiali argjilor që përfaqësohen nga karbonate e rreshpe argjilore (fig. 7).

Gjatë epokës së hershme aniziane (zona me *Paraceratites trinodosus*) pellgu pëson një farë thellimi e në këto kushte të reja formohen depozitimet e facies Hanbuloge.

Karakteristikë e kësaj epoke është zhvillimi i veprimtarisë vulkanike në të gjithë rajonin.

Formacioni vulkanogjeno-sedimentar u formua në pjesën e brendshme e relativisht të thellë të basenit, ndërsa në pjesët anësore të basenit ku thellësia ishte më e vogël, vazhduan të depozitohen llumrat karbonate me organizma të mëdiseve të cekta. Me këtë shpjegohet edhe fakti që në malin e Vuçinit (pjesa më përendimore e rajonit) dhe malin e Bojës (pjesa më lindore e tij) nuk takohen në prerje vulkanikë sepse përbëjnë sektorin e jashtëm të basenit.

Komponentë të rëndësishëm në pellgun e sedimentimit krahas  $\text{SiO}_2$  janë edhe oksidet e Mn dhe Fe, të cilat sillen si dhe silici nga shpërthimet vullkanike. Oksidet e Mn dhe të Fe shpërndahen në formë koloidesh në pellg dhe precipitojnë si sedimente kimike. Rol të rëndësishëm luajnë në këtë mes edhe organizmat, (Markoviç 1961). Kështu formohet horizonti i hekurit në malin e Bojës, i cili vazhdon në drejtim të përendimit në Kërcin e Djegur, Jaçicë etj. megjithëse i dobësuar.

Në fillim të epokës ladiniane vijon sedimentimi i facies Hanbuloge. Më pas kushtet detare bëhen më të qeta e rivendoset regjimi i platformës shelfore dhe depozitimet llumore karbonatike që dhanë gëlqerorët e dolomitet të formuara pas proceseve të diagjenezës. Në këtë kohë pellgu ka qenë i cekët me ujë të ngrohtë e kripesi normale.


Gjatë triasit të sipërm-jurës në trevën e studjuar janë depozituar llumra karbonate, por këto depozitime janë më vonë. Nën ndikimin e lëvizjes së fazës paleokimerike gjatë triasit të vonë e jurës së hershme, ndërsa filloi të formohet hullia bosnjake më në veri, rajonet e zonës së Durmitorit ngrihen e dalin mbi sipërfaqen e detit e cila pa sohet nga karstëzimi e boksitizimi (Aubouin 1970).

Gjatë neokomanit të vonë zona e Durmitorit (Gashi) ngrihet mbi ujë dhe mbi të vendosen ofiolitet e zonave të brendshme.

Gjatë kretës së sipërmë rajonet që i përkasin zonave të Gashit, Kelmendit e nënzonës së Valbonës ngrihen mbi ujë, ndryshime që ndodhin nga veprimi i lëvizjes tektonike të fazës austriake, edhe në fillimin e mastrihtianit, nënëzona e Valbonës ulet përsëri e në këto kushte sedimentohet flishi i Vermoshit me trashësi qindra metra (fazë subhercine) (Peza etj. 1988).

## Përfundime

1. Në rajonin e Vermoshit përfshihen dy njësi të veçanta tektonike: zona e Gashit dhe zona e Kelmendit. E para mbihip mbi të dytën me një amplitudë rrëth 10-15 km.
2. Ladiniani që dokumentohet për herë të parë në rajonin e Vermoshit, është zhvilluar kryesisht në facien karbonatike neritike.
3. Depozitimet karbonatike së bashku me shkëmbinjtë vulkanikë



në rajonin e Vermoshit përbëjnë një sinklinal me shtrirje pothuajse JL-VP i përpunuar më vonë nga tektonikë shkëputëse dhe rrudhoshëse.

4. Zhvillimi paleogeografik i rajonit karakterizohet nga ndikime të forta të fazave të orogjenezës alpine: kimerike e vjetër kimerike e re, Mirdita, austriake, subhercinike, pireneje.

## LITERATURA

1. Aubouin I., Blancnet R., Cadet J-P., Charvet I., Celet P., Chorowicz I., Cousin M., Rampnoux I. (1970). — Essai sur la géologie des Dinarides B.S.G.F. (7) t. XII. Paris.
2. Babani 'Gj. etj. (1986) — Relacion mbi punimet gjeologjike të kryera në objektin e Trojanit.
3. Bakri S. (1977) — Materiale të punimeve të rilevimit gjeologjik në shkallë 1 : 10 000 të kryera në rajonin e Vermoshit. Shkodër.
4. Bakri S. (1977) — Projekt mbi punimet e kërkim-zbulimit në zonën e Vermoshit. Shkodër.
5. Besic Z. (1980) — Geologia Crne-Gore-Stratigrafia e facialni sostav Crne Gore Knjiga I., Sveska 2. Titograd.
6. Blanchet R. et al (1969) — Sur l'existence d'un importante domaine de flysch titonique — Crétace inférieur B.S.G.F. 7<sup>e</sup> Seriet E. XI.
7. Cadet J.P. (1978) — Essais sur l'évolution alpine d'une paleo marge continental. Les confins de la Bosnie-Herzegovine et du Montenegro (Jugoslavi). Mem. S.G.F. t. LVII. Paris.
8. Ceric B., Karamata S. (1960) — L'évolution du magmatisme dans le geosynclinal Dinarique au mesozoïque et au cénozoïque B.S.G.F. (7). V. 2 Paris.
9. Dede S. etj. (1973) — Ndërtimi gjeologjik me mineralet e dobishme të Shqipërisë së veriut. Tiranë.
10. Doçi I., Kosho P. etj. (1986) — Projekt mbi punimet e kërkim-vlerësimit dhe zbatimit paraprak në objektin e hekurit të Majës së Bojës-Vermosh.

Fig. 7 — Evoluciuni paleogeografik i rajonit të Vermoshit

1. Shkëmbinj klastik; 2. gëlqerorë neritik; 3 — vullkanite; 4 — tufite; 5 — shiste; 6 — gëlqerorë të facies Hambuioge (anizian); 7 — gëlqerorë pelagjik me silicorë; 8 — radiolarite; 10. gëlqerorë me megalodonte (trias i sipërm); 11. flihi i Kelmendit; 12. ophiolite; 13. gëlqerorë me rudiste; 14. flihi i Selcës (paleocene-eocene i mesëm); 15. mineralizimi i hekurit; 16. deti.
- Paleogeographic evolution of Vermoshi region.
- 1 — Clastic rocks; 2 — Neritic limestones; 3 — Volcanites; 4 — Tuffite; 5 — Schists; 6 — Limestones of Hambulog facie (Anisian); 7 — Pelagic limestones with siliceous; 8 — Radiolarites; 10 — Limestones with megalodontes (Upper Trias); 11 — Kelmend flysch; 12 — Ophiolites; 13 — Limestones with rudists; 14 — Selca flysch (middle Paleocene-Eocene); 15 — Iron mineralization; 16 — Sea.

11. Dokic V. (1970) — Pojava flishin sedimentata i obllom Ordu kod Andrijevice (crna gora). Geol. Glasnik. K. VI: Titograd.
12. Duraj A. (1979) — Petrografia e shkëmbinjve magmatikë të zonës së Vermoshit.
13. Duraj A. (1987) — Mbi përbërjen petrografike dhe petrokimike të shkëmbinjve vulkanik të zonës së Vermoshit. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3.
14. Grillo V., Turku I., Nikolla N. (1983) — Studim tematiko-përgjithësues e rivelues për kërkimin polimetalarë në rajonet Dukagjin-Vermosh.
15. Grubic A. (1980) — Situation de la Yougoslavie dans son cadre européen et ses caractéristiques géologiques (Géologie des Pays Européens). Dunod-Paris.
16. Grup autorësh (1984) — Tektonika e Albanideve (tekst, sqaures i hartë tektonike të R.P.S.S.H. në shkallën 1:200000. Tiranë.
17. Gjata Th., Kici V. etj. (1985) — Studim mbi stratigrafinë e depozitimeve mesozoike triasiko-jurasike të Albanideve lindore dhe premisat për mineralmbajtjen e tyre. Tiranë.
18. Gjata Th., Theodhori P., Kici V., Marku D., Pirdeni A., Kanani J., Dodona E. (1987) — Stratigrafia dhe kushtet e formimit të depozitimeve triasike në Albanidet lindore. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2 Tiranë.
19. I.S.P.GJ. (1982) — Harta gjeologjike e RPSSH në shkallë 1:200 000 dhe teksti i saj.
20. Kanani J., Dodona E., Kici V. (1987) — Të dhëna mbi ndërtimin gjeologjik dhe stratigrafinë e rajonit të Vermoshit. (Referate kumtësa të sezonit shkencor të vitit 1984. Tiranë. Përmbyt. Stud., Botim UT Enver Hoxha.
21. Markovic B. (1961) — Uslovi stvaranja diabaz roznacke formacie trijasike starosti III Kongres Geologe Jugosllavie. Titograd.
22. Mirkovic M. (1970) — Prilog poznavanju razvica trijasa i jure na Vdnjaku, Moglici i Zelengori; Geolog. Glasnik K. VI Titograd.
23. Nopca F. (1929) — Geologie und geographie Nordalbaniens. Budapest.
24. Pantic S. (1975) — Les mikrofacies triassiques des Dinarides Titograd.
25. Papa A., Shallo M., Dalipi N., Cili P., Pasho S., Jahja B. (1977) — Mbi prani nje e një flihi të poshtëm në krahinën e Vermoshit dhe mbi mundësinë e vazhdimit të nënzonës së Valbonës në këtë krahinë. Përmbyt. Stud. Nr. 2. Tiranë.
26. Pavlovic P. (1960) — Nalazzak hanbuloske faune o hematitu Smreke Varesa u Bosni. Geol. An. Balk. Knji. XXVII. Beograd.
27. Peza L.H. (1987) — An outline of the cretaceus of Albania III cretaceus Symposium. Tubingen.
28. Peza L.H., Shkupi D. (1988) — Flishet dhe fazat erozionale në Shqipërinë e Veriut dhe rëndësia e tyre gjeotektonike. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3.
29. Peza L.H., Shkupi D., Turku I., Terolli I. (1988) — Stratigrafia paleogeografija dhe konkretizimi i perspektivës për hekur në zonën e Vermoshit. Tiranë.
30. Rrudha S., Malaveci M., Juta J. (1980) — Raport mbi punimet komplekse gjeofizike-gjeokimike të kryesës në rajonin e Vermoshit.

Dorëzuar në redaksi në tetor 1989

### Summary

#### Geology of Vermoshi region

The deposits of Gashi zones, the flysch zone of Kelmendi and Valbona subzone are present in this region.

**Gashi zone (Durmitor):** It is composed of clastic rocks, as sandstones micrococlerates, shales Sessian level Upriods, the section continues with black limestones with rare marly layers Campion level. The Anisian is represented by limestones with chert lenses and of dolomite of hanbulog facies as well as by bandol and algal limestones. Ladinian is represented by limestones which are spread on the andesite, dacite and rhyolite formation.

**Flysch zone of Kelemendi (Bosnian zone)** consists of the interbedding of marls, sandstones, conglomerates and schists. Campionella occur there. (Neocomian level). In the upper part are founded Orbitolina and later Pithonella which prove Bareman up to Cenomanian.

The deposits of Gashi zone form a scaly synclinal which thrusts over flyschoidal deposits of Kelmendi zone. The last one thrusts over the deposits of Valbona subzone. The thrusting amplitude is 10-15 km in NE-SW direction.

## STRATIGRAFIA E JURASIKUT TË SIPËRM — KRETAKUT TË POSHTËM TË ALBANIDEVË LINDORE DHE DISA PROBLEME GJEOLGIKE

Thanas Gjata\*, Dedë Marku\*\*

Në artikull trajtohet lito e biostratigrafia dhe disa aspekte paleogeografike të depozitimeve të jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm. Bëhen interpretime që bien ndesh me disa studime të mëparshme, apo kanë përputhje të pjesshme dhe ngrihen probleme gjeologjike për të ardhmen.

### Për historikun e studimeve gjeologjike

Depozitimet e datuara nga autorë të ndryshëm si jurasik i sipërm-kretak i poshtëm si në Hartën Gjeologjike dhe atë Tektonike të RPSSH në shkallë 1:200000 si dhe në shumë studime të tjera, (2, 3, 4, 5, 6, 9, 17, 18, 19, 21) janë trajtuar shumë herë në literaturën tonë gjeologjike dhe ka pasur interpretime të ndryshme për to. Në pikëpamje kronostratigrafike, me të dhënat biostatigrafike që janë fituar, ato nuk janë të argumentuara në masën e duhu'r dhe paraqesin vështirësi. Në, disa studime të autorit Shallo M. (20, 21) flitet për depozitimet që ai i emëron «pako éfuzivo-rreshpore» dhe herë të tjera «suita argjilito-copëzore» i daton të Titonian-Valanžhinian dhe i vendos me shtrije normale mbi serinë vulkanogjene të jurasikut të mesëm-të sipërm. Në punime të tjera ky autor (17,18,19) i vendos depozitimet e argjilites me copa me një pushim të shkurtër mbi depozitimet e pjesës të sipërm të gëlqerorëve të triasikut të sipërm-jurasikut të poshtëm. Autorë të tjerë si Gjata K. dhe Kodra A. etj. (8, 9, 10, 11, 12) kësaj pakoje i japin emra të ndryshëm dhe e vendosin në pozicione të ndryshme stratigrafike (fig. 1), por gjithmonë brenda diapazonit moshor jurasik i sipërm-kretak i poshtëm. Këto depozitime, ata i vendosin me një suksesivitet normal mbi depozitimet jurasike dhe me ndonjë rast me ndonjë episod të shkurtër pushimi. V. Shehu (22) depoziti-

\* Instituti i Studimeve dhe Projekteve të Gjeologjisë, në Tiranë.

\*\* Ndërmarrja Gjeologjike në Pukë.

meve shistozo-argjilore të rajonit të Porav-Miliskasë u jep moshën asike të poshtme — të mesme si dhe vetë serisë efuzivo-sedimentare. Autorët e këtij artikulli Gjata Th. etj. (5, 6, 7) depozitimet e jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm i kanë konstatuar me shtrirje mospat tuese stratigrafike, duke filluar që nga depozitimet më të vjetra, verfenianit të serisë konglomerato-ranorike të Varukanos, apo serisë Luma në rajonin e Fierzës si dhe mbi depozitime të tjera të vjetra. Autorët Bezhani V. (1) dhe Kodra A. etj., (10, 11, 12) njësinë litostatigrafike argjilite me copa, kur copat janë shkëmbinj efuzivë e ngatërojnë me serinë efuzivo-sedimentare.

Vrojtimet tona të terrenit, analiza petrografike dhe paleontologjike e coprave shkëmbore dhe e matriksit të pakos argjilite me copa trengjnë, se në të gjitha rastet dhei për të gjitha rajonet bëhet fjalë përmes njëjtën njësi litostatigrafike që dathet si e jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm. Në fig. 2 ku janë paraqitur prerjet stratigrafike të rajoneve Kçirë, Fierzë, Rubik etj., del e qartë se pakua argjilite me copa vendoset me pushim stratigrafik mbi formacione të moshave të vjetra. Nga ana tjetër në të njëjtin rajon pakua ka shtrirje njëherësh mbi efuzivo-sedimentarët dhe mbi depozitimet karbonate të triasikut të sipërm e deri mbi ata të liasikut të poshtëm-të mesëm në sektorin e Velës. Në prerjen e Kishaxhiut fig. 3A duket sikur mbi pakon argjilite me copa (poshtë) në vijueshmëri normale vijnë depozimet e gëllqerorëve të triasikut të mesëm (anizian) sipër saj. Po ashtu në prerjen e Maknori (fig. 3B) duket sikur kemi kalim normal nga depozitimet e gëllqerorëve të ladinian-triasikut të sipërm (poshtë) dhe pakos argjilite me copa (sipër). Kjo pamje nuk është e vërtetë. Kemi mendimin, se depozitimet e pakos argjilite me copa fillimisht janë shtrirë mbi depozitimet më të vjetra me pushim stratigrafik. Tektonika e mëvonshme këto depozitime ( $J_3-Cr_1$ ), përfshirë efekt të plasticitetit që ato zotërojnë i kanë përpunuar me depozitimet e shtangëta triasike. Këtë dukuri që ne e interpretojmë në këtë rrugë dhe mendimet e tjera të studjuesve të ndryshëm ilustrohen në figurat 1, 2 dhe 3 AB.

Depozitimet e datuara si jurasik i sipërm-kretak i poshtëm janë përshkuar në tre njësi litostatigrafike.

1 — Pakua argjilite me copa.

2 — Pakua e konglobrekjive ofiolitike ose përzierje sedimentare-tektonike.

3 — Pakua flishore-mergelore me tintinidë.

Përsa i përket kronostratigrafisë së tyre vazhdojnë diskutimet midis studiuesve. Të dhënat faunistike të këtyre depozitimeve tanë përfshinë të tilla që mund të flitet përfshirë datim moshor global si jurasik i sipërm-kretak i poshtëm, kurse imtësimi kronostratigrafik dhe vendosja në pozicione stratigrafike të tyre paraqet mjaft vështirësi.

Ne mendojmë që të tria këto njësi litostatigrafike mund të janë të njëkohshme dhe formimi i tyre si njësi të veçanta të ketë të bëjë me kushtet paleogeografike të basenit të sedimentimit si dhe me zonat e burimeve të ardhjes së materialit që depozitohet në basen. Më poshtë po japim pëershkrimin stratigrafik, ashtu siç ndeshen në prerjet stratigrafike të kryera në rajone të ndryshme të Albanideve Lindore.

Shallto M. 1966, 1975	Pezo L. etj. etj. 1972	Mariashos Girinxhi A etj. 1973	Mustafa F 1974	Kodra A 1975, 1976	Shallto M 1979	Kodra A 1981	Shallto M etj 1982	Gjata K etj 1982	Kodra A etj 1984	Shallto M etj 1982	Gjata K etj 1982	Kodra A etj 1984	Grupi stratigrafik të dep triasikut-jurasikut 1985
Pako efuziv vo-rreshpo- re. Në fillim ka shiresa te rralla vulkanteshi bazite.	Pako argillito- copezo- re.	Pako shishone me copa	Suita "Melanzhi vertere" "Kimza"	Pako shishone me copa	Suita "argillito- copezore e Mirshas"	Konglobre- cie e tufo ranore	Reshpoe reshpoe me copa argillite lipure	Serio vullkanike	Reshpoe reshpoe me copa argillite lipure	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	Serio vull- kanogene e Mirshas e Juras- iku	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	Pako argillite me copa
Diabaze Suita "Magjoli"	Diabaze Suita "Magjoli"	Pako stra- tore tufrag se troshc holle me strati ose gëll masiv	Diabaze Suita "Magjoli"	Pako stra- tore tufrag se troshc holle me strati ose gëll masiv	Diabaze Suita "Magjoli"	Pako stra- tore tufrag se troshc holle me strati ose gëll masiv	Diabaze Suita "Magjoli"	Pako stra- tore tufrag se troshc holle me strati ose gëll masiv	Diabaze Suita "Magjoli"	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	Diabaze Suita "Magjoli"	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	
Berrioids - Hoberi ka shiresa te rralla vulkanteshi bazite.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Serio vullkano- gjone.	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	Serio vullkano- gjone.	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )	Tirolian-Volcanization (J <sub>3</sub> -Cr <sub>1</sub> )
Paleogen	Tirolisk i poshtem	Doger	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem	Tirolisk i poshtem

Fig. 1 — Vendosja e Pakos Argillite me copa në prerje sipas autoreve të ndryshme si në fig. 2). The extension with stratigraphic break of "Argillite-clastic Pack" of Upper Jurassic-lower Cretaceous over the deposits of different ages in some sections of eastern Albanides.




Fig. 2 — Shtrirja me pushim stratigrafik e depozitimeve të «Pakos Argjilite me Copă» të jurasikut të sipërm-kretakut tē poshtëm në disa prerje tē Albanideve Lindore. (sipas Th. Gjata, V. Kici, D. Marku etj. viti 1985).




Fig. 3a — Zhveshja në Përroin e Kishaxhiut.

Pakua argjilite me copa e  $J_3$ - $Cr_1$  me shtrirje transgresive mbi gëlqeroret me silicorë të triasikut të mesém (anizian).

## **Outerop in Pérroi i Kishaxhiut.**

The argillic-clastic pack of  $J_3$ - $Cr_1$  with transgresiv extention over the limestones with cherts of  $T_2$  (anizian).

Fig. 3b — Zhveshja në Koman (Përroi i Maknorit).

Shtrirja transgresive e pakos argjilite me copa mbi depozitimet karbonatike tjet riasikut te mesem te siperm.

1 — gëlqerorë me silicorë të anizianit; 2 — formacione të ndryshme të argjilites me copa.

**Outerop in Koman (Pērroi i Maknorit).**

The transgresiv extention of argillitic-clastic pack over the carbonatic formations of  $T_{2-3}$ .

1 — limestones with cherts of anizian; 2 — formations of argillic-cistic pack.

### Stratigrafia e depozitimeve të jurasikut të sipërm — kretakut të poshtëm

1 — «*Pakua argjilite me copa*» është studiuar në rajonet e Rubikut, Kçirës, Gominës, Komanit, Fierzë-Miliskasë, Stravecit, Pobregut, Mirakës, Sinanit, Qarrishtës etj. Ajo ka përhapje edhe në shumë vendet tjetra, siç përmendet nga shumë studiues të Hartës Gjeologjike dhe asaj Tektonike të RPSSH etj. (2, 3, 7, 18, 19, 21, 23). Depozitim i kësaj pakoje në rajonin e Fierzës shtrihen me pushim stratigrafik si mbi konglomeratet e verfenianit (Verukano), ashtu edhe mbi efuziv-sedimentarët dhe mbi granitet. Në rajonin e Kçirës ato vendosen mbi nivele të ndryshme stratigrafike; mbi depozitim e Verfenianit të sipërm, mbi ato të anizianit, mbi serinë efuzivo-sedimentare, mbi gëlqerorët e triasikut të mesëm e të sipërm; në Koman shtrihet mbi ato ladinian — triasikut të sipërm dhe mbi depozitim e serisë efuzivo-sedimentare, në Gominë mbi serinë efuzivo-sedimentare, në Qarrishtë mbi triasikun e sipërm dhe në Mirakë mbi triasikun e mesëm. Në shumë rajone të zonës së Mirditës kjo pako shtrihet mbi shkëmbinjtë ofiolitikë (2, 3, 21 etj.).

Nga ana litologjike pakua ndërtohet nga një matriks argjilor-klorit-sericitik, herë herë pak i metamorfizuar (shiste argjilore) ngjyrë gri, gri të errët, herë tjetër tjetër kafe çokollatë. Në shistet argjilore vërehet kuarc alevritik në sasi të ndryshme.

Materiali copëzor përfaqësohet nga copra të vogla deri në olistolite e olistostroma. Në disa raste vërehet vendosje disi e orientuar e materialit copëzor. Ky material përfaqësohet nga ranorë kuarcorë, me pak feldshpat, herë herë ranorë të tipit grauvak, ranorë me material vulkanik, kokërrtrashë-mesëm, alevrolit kokërrimët feldshpat kuarcorë, me çimanto argjilo-sericitike, me pikëzime piriti, spilitë bajamorë, diabaze të albitizuara dhe efuzivë të tjerë, gëlqerorë radiolaritikë mergelorë deri mergele me bivalvë pelagjikë, gëlqerorë brekçiorë-mikrobrekçiorë, gëlqerorë turbiditikë ose biosparitikë dhe biomikrosparitikë, silicorë radiolaritikë deri radiorolarite, copra e biloqe shkëmbinj ultrabazikë (ofikalcite, klorit serpentinite, serpentinitë të prejardhur nga harzburgitet) të cilët janë takuar në rajonet e Rubikut, Komanit, Provin e Magjypit, Pobreg etj. si dhe copa rodokroziti të takuara pothuajt, në të gjitha prerjet e studiuara. Në rajonin e Fierzë-Miliskasë janë takuar copra albitofiresh dhe granitesh mikropeggmatitikë.

2 — «*Konglobrekçiet ofiolitike*» janë studiuar në Lunik, Sina, Ndërlinë (Lan-Lurë), Resk, Tartaj, Vinjollë, Qarrishtë (Maja e Zezë), Zabzun, Fushë Studën etj. Përbërja e tyre është mjaft heterogjene me mbizotërim të shkëmbinjeve ofiolitikë dhe me ndërtim trashaman. Përbëhen kryesisht nga shkëmbinj ultrabazikë (serpentinitë dhe peridotite), më rrallë takohen troktolite, gabro olivinikë, vullkanite të përbërjes bazike, amfibolite, shiste amfibolitike, shiste kuarc-mikrogranitike, gëlqerorë, radiolarite, ranorë ofiolitikë etj.

Në Qarrishtë, pikërisht në Majën e Zezë midis konglobrekçies

ofiolutike është takuar një paketë mergelesh shtresëhollë gri me tintindë.

3 — «*Flishi mergelor me tintindë*» është takuar në Lunik, Gurëbardhë, (në jugë të Klosit), në Gurin e Topit, Katundin e Vjetër (Rubik) etj. Flishi mergelor ka shtrirje të madhe. Ashtu si pakua argjilite me copa dhe konglobrekçiet ofiolitike edhe depozitim e flishit mergelor shtrihen mbi bazamente të ndryshme. (fig. 1). Nga ana litologjike flishi përfaqësohet nga ndërthurje mergelesh e gëlqerorësh radiolaritikë me tintindë, alevrolitesh, ranorësh, konglomeratesh me ndërshtresa gëlqerorësh mikrobrekçiorë turbiditikë e radiolaritesh. Përvec përbërsave ofiolitike që mbizotërojnë, takohen dhe copriza gëlqerorësh jasiko-jurasikë dhe silicorësh radiolaritikë. Karakteristikë e këtyre depozitimeve është se ato janë flishore e flishoidale.

Përsa i përket datimit moshor të depozitimeve si jurasik i sipërm — kretak i poshtëm kemi këto mendime:

Në matriksin e pakos argjilite me copa nuk është gjetur makrò e mikrofaunë e përcaktueshme, ndërsa në coprat janë takuar forma që datojnë mosha të ndryshme duke filluar nga ato të Verfenianit të sipërm — anizianit si Meandrospira pusilla, Earlandia sp., Glomospira sinensis (Gominë e Kçirë), të triasikut të mesëm si Trochammina altitensis etj. (Fierzë), të ladinian — triasikut të sipërm si Involutina sp., Trochammina sp. etj. (Fierzë, Resk), si dhe Ophthalmodium sp., Glomospira sp., bivalvorë pelagjikë, Krinoidë (Koman), të liasikut si Involutina liassica etj. (Koman), të jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm me Calpionella etj., që i përmendin Gjata K. etj. në studimet e tyre (9, 17, 18, 19, 21, 23).

Në shtresat mergelore brenda konglobrekçieve ofiolitike (në M. e Zezë, Qarrishtë) jepen në studimin e Gjata Th. etj., (5, 7). Calpionellopsis oblonga, Tintinopsella carpathica etj., në flisin mergelor të Gurit të Topit janë takuar Clypeina jurassica, Stomosphaera sp. etj., në Lunik në flisin mergelor janë takuar Calpionellopsis oblonga, Tintinopsella longa, Calpionelites darderi etj. Kompleksi i cituar daton moshën berriasan — valanzhinianit. Këtu në konglobrekçiet ofiolitike argumentohet mosha e berriasanit të mesëm, ndërsa në flisin mergelor ajo e berriasan — valanzhinianit. Në përfundim mosha e depozitimeve të përshkruara pranohet titonian i sipërm deri në valanzhinian.

### Disa mendime për kushtet paleogeografike

Karakteristikat stratigrafike të depozitimeve të Jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm, tregojnë për aspekte të veçanta paleogeografike që janë zhvilluar gjatë kësaj kohe në Albanidet Lindore.

Në shekujt e ndërmjetmë dhe të vonshëm jurasikë në Albanide, si rezultat i hapjes së kores kontinentale dhe i daljes së kores oceanike shtë krijuar zona tektonike ofiolitike e Mirditës, që ka histori zhvillimi të veçantë nga ajo e zonave anësore të saj. Në zonën e Mirditës dolën shkëmbinjtë ofiolitikë, të cilët zenë një territor të gjerë e të gjatë të Albanideve Lindore. Në basenin e zonës ofiolitike të Mirditës, për shkak të zhvillimit të tektonikës bllokore, disa pjesë të saj ishin më

të ngritura kurse disa të tjera më të ulura. Në këtë mënyrë është krijuar një paleoreliev mjaft i aksidentuar me ngritje dhe depresione nëndetare, që në ndonjë rast ngritet ishin mbi nivelin e detit.

Nga mbarimi i jurasikut dhe fillimi i kretakut në pjesët e themilluara të basenit dhe në pjesët anësore të tij u krijuan kushte të përshtatshme për depozitim e llumrave karbonatike, mergelore, argjilore si dhe krijimi i kushteve të favorshme për jetesën e zhvillimin e radiolarëve dhe kalpionellideve. Këto llumra mbas diagjenezës kanë formuar gëlqerorët radiolaritikë, mergelet radiolaritikë shiste mergelore si dhe silicorët radiolaritikë diagjenetik.

Në pjesët relativisht më pak të thella dhe në ato të ngritura të basenit, ku shtriheshin shkëmbinjtë ofiolitikë, si dhe në ato anësore ku kemi pasur formacione karbonatike (që në ndonjë rast, me sa duket mund të kenë qenë edhe mbi nivelin e detit) kanë ndodhur shpëlarje të trevave të dala mbi ujë edhe të atyre të ngritura nëndetare. Në këto të fundit shpëlarja duhet të jetë bërë për shkak të rrymave turbiditike të fuqishme. Materialet e gryera transportoheshin në pjesët e tjera të basenit në largësi të ndryshme. Në gropat ato mund të mbeteshin edhe afér burimit të gërryerjes, por kur paleorelievi ka qenë me pjerrësi graduale, materiali i gërryer pësonte transport dhe përpunim më të largët. Kështu, formimet e «pakos argjilite me copa» tregojnë për një formacion kaotik ku, copat, poplat, bloqet, olistolitet etj., përfaqësojnë shkëmbinj me përbërje dhe mosha të ndryshme nga triasike e jurasike e deri në jurasiko-kretake. Këta përbërës me sa duket janë shtytur e rrokuallur në një mjedis argjilor të basenit të sedimentimit që formon matriksin e këtij formacioni. Ky formacion takohet si në vetë zonën ofiolitike të Mirditës ashtu dhe në anët lindore e perëndimore të saj.

Pakua e konglobrekçieve ofiolitike përbën një moment tjetër të rëndësishëm në historinë gjeologjike të këtij shekulli, është një dukuri e shfaqjes me intensitet të lartë të rrjedhjes së coprave për gravitet e dhe të rrymave të turbullta, të cilat gërryenin kryesisht material ofiolitik të zonës Mirdita dhe e transportonin atë më tej në Sinan, Resk, M. e Thatë, Stavec, Ndërlinë etj. Herë herë në vende, apo edhe kohë të ndryshme aktiviteti intensiv i shpëlarjes ulej dhe në basenin e sedimentimit të qetë dhe deri diku të thellë depozitoheshin llumra karbone dhe argjilore të imëta; me sa duket në këtë kohë në basej u zhvillua mikrofaunë e familjes Tintinidae. Mbështetës e litifikimit ato kanë dhënë gëlqerorët mergelorë dhe mergelet me tintinid.

Sic e përmendëm, dalja e zonës ofiolitike të Mirditës në Jurasic të mesëm e të sipërm, është një eveniment i rëndësishëm gjeologjik për Albanidet. Gjatë kohës jurasik i sipërm-kretak i poshtëm zona ofiolitike e Mirditës, për shkak të zhvillimit të tektonikës shkëputëse në të dhe rrudhosëse, me të dy shpjetimet, sipas hipotezave të tektonikës së plakave apo edhe asaj «diapirike ofiolitike» ka bërë që masat ofiolitike të mbihipin në pjesët anësore të saj në drejtim të perëndimit dhe të lindjes. Por vërehet që shkalla e mbihipjes të pjesës perëndimore të kësaj zone është më e avancuar për arsy se në tërësi drejtimi i forcave tektonike të lëvizjes së Albanideve është nga lindja në perëndim.

## PERFUNDIME

1. Nga studimet tona vërtetohet shtrirja me mospajtim stratigrafik e depozitimeve të jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm mbi depozitimet më të vjetra.

2. Gjeneza e depozitimeve të jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm flet për rolin e madh që kanë luajtur proceset e rrjedhjes së copave për gravitet si dhe për ekzistencën e rrymave turbiditike gjatë kësaj kohe.

3. Vendosja e depozitimeve të jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm mbi depozitimet karbonatore të kornizave të asaj lindore e perëndimore si dhe vetë zonën ofiolitike të Mirditës e përjashton paleosharazhimin e tyre në këtë kohë.

4. Paleorelievi i kornizave karbonatike si dhe vetë zonës ofiolitike të Mirditës në kohën e  $J_3-Cr_1$  ka qenë shumë i aksidentuar me ngritje dhe depresione nëndetare.

5. Ndërmarrja e një studimi tërësor për depozitimet e jurasikut të sipërm-kretakut të poshtëm në kuadrin e Albanideve Lindore është e domosdoshme të bëhet për deshifrimin më të imtësuar stratigrafik të tyre jo vetëm duke u mbështetur në studimin e foraminiferëve, por edhe të grupeve të tjera si radiolare, nanoplanktonë e sporopalmë. Studimi duhet të kompletohet edhe në aspektin e karakterit tektonik e të atij paleogeografik.

6. Mendojmë se zona Mirdita si ajo ofiolitike ashtu dhe ajo periferike karbonatore rezulton autoktone në truallin e vendit tonë, por ka prirje më tepër mbihipëse me sens drejt perëndimit.

## LITERATURA

1. Berxhani V., Çakalli P. etj. (1986) — Disa kritere gjeologjike të kërkimit të mineralizimeve sulfurore të bakrit në serinë efuzivo-sedimentare të rajonit Poravë-Kingjel. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4. Tiranë.
2. Grup autorësh (1982-1983) — Harta Gjeologjike e R.P.S.SH. në shkallën 1:200 000. dhe teksti i saj shpjegues.
3. Grup autorësh (1984-1985) — Harta tektonike e R.P.S.SH. në shk. 1:200 000 dhe teksti i saj shpjegues. Tiranë.
4. Çili P., Braçe A., Kotani V. (1988) — Stratigrafia e depozitimeve vulkanogeno-sedimentare, metamorfike e karbonatike kryesisht të sektorit Q. Thanë-Rajcë-Skënderbej. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1. Tiranë.
5. Gjata Th., Kici V., Marku D., etj. (1985) — Studim mbi stratigrafinë e depozitimeve mesozoike (triasike jurasike) dhe premisat mineralmbajtëse të tyre. Fondi i I.S.P.Gj. Tiranë.
6. Gjata Th. (1982) — Gjeologjia dhe premisat mineralmbajtëse të njësive të Krastë-Cukalit, Kolonjë-Leskovik dhe periferisë së tyre. (Disertacion). Tiranë.

7. Gjata Th., Theodhori P. etj. (1987) — Stratigrafia dhe kushtet e formimit të depozitimeve jurasike në Albanidet Lindore. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 4. Tiranë.
8. Gjata K., Kodra A. etj. (1980). — Gjeologjia e disa pjesëve periferike të zonës Mirdita. Përmb. Stud. Nr. 3. Tiranë.
9. Kodra A., Gjata K. etj. (1980) — Nivelet e doger-malmit në rajonin e Mirditës Përmb. Stud. Nr. 4. Tiranë.
10. Kodra A., Delaj E. (1975) — Ndërtimi gjeologjik i rajonit Fierzë-Dardhë.
11. Kodra A. (1974) — Mbi moshën jurasike të formimeve vullkanogjene sedimentare në zonën e Mirditës. Përmb. Stud. Nr. 2 Tiranë.
12. Kodra A. (1984) — Të dhëna të reja për prerjen e Fushë Lurës Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3. Tiranë.
13. Kici V. (1987) — Stratigrafia dhe paleogeografija e depozitimeve flišhor dhe karbonatike të rajonit Kostenjë-Okshtun (Disertacion). Tiranë.
14. Qirici V., Kodra B. etj. (1981) — Studim tematik përgjithësues kompleks për sqarimin e perspektivës hekurmbajtëse të zonës Zallardhë-Togjan. Tiranë.
15. Melo V. Dodona E. (1967) — Mbi një transgresion të titonian-beriasianit të zonës së Mirditës. Bul. Shk. Nat. Nr. 2 Tiranë.
16. Petro Th. (1980) — Përfytyrime të reja për gjeologjinë e rajonit të Korçës. Përmb. Stud. Nr. 2.
17. Shallo M., Gjata Th., Vranai A. (1980) — Përfytyrime të reja për gjeologjinë e Albanideve Lindorë nën shembullin e rajonit Martanesh-Çermenikë-Klenjë. Përmb. Stud. Nr. 2 Tiranë.
18. Shallo M., Gjata Th., Vranai A. (1980) — Gjeologjia e rajonit Korçë-Kolë një-Leskovik. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3 Tiranë.
19. Shallo M., Vranai A., Gjata Th., Gjeçi K. (1983) — Rreth gjeologjisë së rajonit të Rubikut. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1, Tiranë.
20. Shallo M. (1966) — Disa të dhëna të reja mbi magmatizimin efuziv në rajonin e Munellës. Bul. U. Tiranës seria shk. nat. Nr. 4. Tiranë.
21. Shallo M. (1978) — Mbi suitën argjilo-copëzore të Mirditës Përmb. Stud. Nr. 1 Tiranë.
22. Shehu V. (1977) — Tiparet strukturore-faciale të luginës së lumit Drin dhe vlerësimi inxhiniero-gjeologjik i tyre për ndërtimin e hidrocentrit të Komanit. (Disertacion).
23. Shima G., Kodheli P. (1983) — Depozitimet e flishit të hershmët të verilindjes të Komanit. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2 Tiranë.
24. Vranai A., Kote Th. (1965) — Seria konglomeratike e Klenjë-Studës. Bul. U.Sh. T. Seria shk. nat. Nr. 2.

Dorëzuar në redaksi në nëntor 1988.

### *Summary*

#### **Stratigraphy of Upper Jurassic-Lower Cretaceous of Eastern Albanides**

The stratigraphy of the Upper Jurassic-Lower Cretaceous deposits in eastern Albanides and some geological problems connected with them.

In the beginning, the achievements of the earlier stratigraphic studies are given. The lithostratigraphic description of the Upper Jurassic-Lower Cretaceous sediments as well as the conditions of their sedimentation and some paleogeographic aspects of the morphology and of the paleorelief of the sea bottom during this time are also presented.

The age argumentation of the deposits in question is done on the basis of biostratigraphic data. On the other hand they are divided into three lithotratigraphic unites and are as follows:

1. argillite-clastic pack; 2) ophiolitic-conglobreccia; 3) marly flysch with tintinides.

Basing on the lithostratigraphic data as well as on the setting conditions and on the presentation of the deposits of the Upper Jurassic Lower Cretaceous interpretations of paleogeographic character are made.

Finally some conclusions are given, some of which are firstly, The studied deposits ( $J_3-Cr_1$ ) spread in stratigraphic discordance with the oldest deposits as that of Werfenian (Verucano serie) and also with other sediments as of the Upper Werfenian-Anisian, Anisian, Ladinian, Upper Trias-Jurassic and the radiolarites of Malm.

Secondly, the deposits of  $J_3-Cr_1$  are formed in conditions of a basin where are combined the sedimentary processes by gravity and turbiditic flows.

It's reaffirmed the autochthony of Mirdita tectonic zone and is excluded the paleocharriage of this zone in this period. It's reaffirmed also the thrusting character of Mirdita zone over the other zones and the tendency of this phenomenon in western direction.

## MINERALOGJI-GJEOKIMI-PETROLOGJI

**KORIGJIMI I NDIKIMIT TË SERPENTINIZIMIT MBI  
PËRBËRJEN KIMIKE TË SHKËMBINJVE  
ULTRABAZIKË**

Ilir Alliu\*, Neki Kuka\*

Në artikull trajtohet problemi i korigjimit të ndikimit të procesit të serpentinizimit mbi kimizmin e shkëmbinjve ultrabazike, duke u bazuar në analizën e hollësishme të dukurive të vrojtuar të këtij procesi me ndihmën e metodës së katrorëve më të vegjël. Metodika e propozuar paraqitet përmes zbatimit konkret për shkëmbinjtë e masivit ultrabajzik të Bëlgzisë.

H Y R J E

Aspektet e gjeologjisë, strukturës, tektonikës, petrografisë dhe gjeokimisë së shkëmbinjve ultrabajzike kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në qendër të diskutimeve të ndryshme. Një aspekt më vete përbën studimi i kimizmit të tyre dhe përdorimi i tij për deshifrimin e masivëve ultrabajzike. Përbërja kimike e shkëmbinjve përdoret gjérësisht në studimet petrologjike si kriter për veçimin dhe klasifikimin e llojeve të ndryshme shkëmbore. Ajo është e lidhur drejtpërsëdrejtë me përbërjen mineralogjike të tyre dhe pasqyron kryesisht këtë përbërje.

Në vendin tonë, ky aspekt, është trajtuar në mjaft studime, sidomos rië dhjetëvjeçarëin e fundit, gjë që ka dhënë ndihmesë në njojhen më të thelluar të këtyre masivëve dhe në një orientim më të drejtë të kërkimit të mineralizimeve që lidhen me to (Cili P. 1985., Dobi A. 1981; Premti I. 1984, 1986; Qorlaze S. 1986; Stërmasi Sh. 1989; Shallo M. 1985; Tërshana A. 1985). Megjithatë, përvoja e deritanishme dhe një analizë e thelluar e metodave të përdorura për përpunimin e të dhënavëve mbi kimizmin e shkëmbinjve ultrabajzike, nxjerr në pah edhe mjaft mangësi dhe shtron nevojën e përpunimit të metodave e metodikave të reja më efikase për trajtimin e këtij aspekti me rëndësi shkencore e praktike.

Serpentinizimi duke patur karakter allokimik, që shoqërohet me largimin e një pjese të Si dhe Mg, në sasi relativisht të mëdha (deri 8-10%), vështirëson së tepërtmi mundësinë e deshifrimit të prerjes ultrabajzike në bazë të kimizmit. Prandaj para se analizat silikate të përdoren për qëllime praktike, është e domosdoshme që ato të korigjohen nga ndikimi i procesit të serpentinizimit mbi përbërjen kimike.

\* Institut i Stud. dhe Projektimeve të Gjeologjisë në Tiranë.


Sot në zgjidhjen e këtyre problemeve po gjejnë përhapje gjithnjë më të gjërë metodat matematike dhe teknika llogaritëse elektronike (Le Maitre, 1982).

Më poshtë do të parashtrojmë përdorimin e metodës së katorrëve më të vegjël në korigjinim e ndikimit të serpentinizimit mbi përbërjen kimike të shkëmbinjve ultrabazike në shembullin e masivit të Bulqizës.


**Proçesi i serpentinizimit të shkëmbinjve ultrabazikë dhe ndikimi i tij në kimizmin e tyre.**

Serpentinizimi është proçes i temperaturave më të ulta se 550° që çon në shndërrimin e shkëmbinjve ultrabazike dhe shoqërohet me hidrolizën e silikateve me shumë magnezium. Shumica e studiues pranojnë se ky proçes ndodh për llogari të fluideve ujore në shkëmbinj. Nisur nga ky pranim, proçesi i serpentinizimit është shprehur me anë të shumë reaksioneve kimike që mund të grupohen në variantet kryesore që vijojnë (Velinskij V.V. 1978).


#### I — Për shkëmbinjtë olivinike:



#### II — Për shkëmbinjtë olivinike-piroksenore:



#### III — Për shkëmbinjtë piroksenore:



Proçesi i serpentinizimit mund të përcaktohet si formimi i serpentinës nga mineralet paraekzistuese ferromagneziale dhe nga solucionet ujore. Nuk ka dyshim se mineralet e serpentinës janë formuar nga olivina dhe piroxeni.

Teoritë e sotme mbi origjinën e serpentinizimit të shkëmbinjve ultrabazike pranojnë një, nga mënyrat e mëposhtme:

1 — alterimi deuterik i peridotitit dhe dunitit nga një magme peridotite hidroze

2 — Kristalizimi direkt i serpentinës nga një magme peridotit hidroze.

3 — Shndërrimi i dunitit dhe peridotitit nga tretësirat hidrotermal;

4 — Serpentinizimi i shkaktuar nga metamorfizmi oqeanik.

Për shprehjen cilësore të serpentinizimit jepen reaksiione kimike të shumtë, ndërsa si tregues sasior pranohet treguesi i humbjes në kalcinim (HK). Problemi se në çmasë e pasqyron HK modifikimin e kimizmit parësor të shkëmbit origjinues është i patrajtuar. Pikërisht shprehjes sasiore të këtij ndikimi do të synojmë t'i japim zgjidhje në paragrafin e mëposhtëm.

Modelet petrologjike të përzierjes (MPP) janë modele që zgjidhen me metodën e katorrëve më të vegjël. Në rastin më të thjeshtë çështja reduktohet në zgjidhjen e problemit të mëposhtëm.

Njihet përbërja kimike e një mostre shkëmbore dhe ajo teorike ose e matur e çdo faze minerale që bën pjesë në ndërtimin e këtij lloji shkëmbor. Kërkohet të vlerësohet përbërja mineralogjike (përbërja modale) e kësaj mostre.

Si shembull të thjeshtë mund të përmendim:

bazalt = andezit + olivinë + pirokseni

Në pikpamje matematike, MPP-ja mund të shkruhet si më poshtë:  
 $a_1x_1 + \dots + a_px_p = b_1w_1 + \dots + b_qw_q \quad (5)$ , ku  $x_1, \dots, x_p$  dhe  $w_1, \dots, w_q$  janë përkatësish vektorët e përbërjes së p fazave minerale parësore shkëmbformuese dhe të q produkteve të reaksiionit, ndërsa  $a_1, \dots, a_p$  dhe  $b_1, \dots, b_q$  janë raportet që minimizojnë shumën e katorrëve të diferencave midis dy anëve të ekuacionit (5).

Zgjidhja e problemit reduktohet (Le Maitre, 1982) në përcaktimin e  $a_1, \dots, a_p$  dhe te  $b_1, \dots, b_q$  që minimizojnë madhësinë:

$$S = (Z_1 - a_1z_1 - \dots - a_rz_r - b_1v_1 - \dots - b_sv_s) \quad (6)$$

ku:  $r = p - 1$ ,  $s = q - 1$ ,  $Z_i = x_{pi} - w_{qi}$ ,  $z_{ji} = x_{pi} - x_{ji}$  dhe  $v_j = w_j - w_{qi}$ .

Në këtë trajtë, ekuacioni është identik me modelin e thjeshtë të metodës së katorrëve më të vegjël dhe mund të zgjidhet duke përdorur të njëjtat teknika programimi. Nëqoftëse ose p ose q, por jo të dyja njëkohësisht, janë të barabarta me 1, modeli reduktohet në modelin e thjeshtë të përzierjes.

Thekojmë se përvëç intuitës, nuk ekziston ndonjë metodë tjetër e kënaqshme për të përcaktuar në se modeli është i «mirë» ose «i keq». Për modelin e thjeshtë të përzierjes, ka patur përpjekje përtë zhvilluar metoda për kontrollin e rëndësise së modelit duke u bazuar në statistiken Hi — kator. Megjithatë këto metoda duhen përdorur me kujdes meqënëse ato mbështeten në hipotezën që mbetjet janë të pakoreluara, gjë që nuk është e vërtetë për të dhënat e mbyllura (me shumë konstante). Për më tepër, problemi i mësipërm, në të vërtetë është një problem gjemometrik dhe jo statistik, sepse nga të dhënat nuk mund të merret informacion mbi dispersionet, meqë-nëse nuk përdoren vrojtime të përsëritura. Çdo fazë minerale ka një përbërje të përcaktuar dhe i vetmi burim i gabimeve janë gabimet eksperimentale që lindin nga matjet.

### Proçesi i serpentinizimit në masivin ultrabazik të Bulqizës.

Serpentinizimi është proçesi kryesor metasomatik që ka ndikuar shkëmbinjtë e masivit ultrabazik të Bulqizës (MUB). Shkalla e zhvillimit të këtij proçesi dhe ndikimit të tij nuk është e njëjtë në të gjithë masivin. Kjo bën që në sipërfaqen e sotme erozionale të tij të dallohen sektorë që ndërtohen nga shkëmbinj ultrabazike krejt të freskët, nga shkëmbinj me shkallë të ndryshme serpentinizimi, deri në shkëmbinj serpentinite-talkore.

Proçesi i serpentinizimit zhvillohet gjërësisht në sektorët perëndimore dhe jugperëndimore të masivit, ndërsa në drejtim të lindjes ai zbehet gradualisht, deri sa kalohet në shkëmbinj të freskët. Intensiteti i serpentinizimit fillon e zbehet edhe në drejtim të thellësisë së masivit.

Prania e disa llojeve të serpentinës dhe e mineraleve të tjera dytësore, që flasin për kushte të ndryshme të temperaturës dhe presionit në sistem, dëshmon se masivi ultrabazik i Bulqizës, ka pasur serpentinizim të disa fazave.

Nga mineralet shkëmbformuese më i ndikuar nga serpentinizimi është olivina, pastaj pirokseni e më pak kromshpinelidi aksesor. Varësia e oksideve shkëmbformuese nga shkalla e serpentinizimit (HK) për MUB-in ilustrohet në fig. 1 të ndërtuar mbi bazën e 394 provave.

Siq shihet, me rritjen e shkallës së serpentinizimit, HK, zvogëlohen në mënyrë të ndjeshme edhe  $\text{SiO}_2$  edhe  $\text{MgO}$  si në dunitet ashtu edhe në harcburgitet. Në varësi të HK, «ulja» e  $\text{SiO}_2$  përfekt të këtij proçesi, si në dunitet ashtu edhe në harcburgitet, luhatet nga 0-8%  $\text{SiO}_2$ , kurse për  $\text{MgO}$  luhatet nga 0-10%  $\text{MgO}$ . Gjithashtu vihet re se përbajtja e  $\text{SiO}_2$  në harcburgitet është rrëth 2.6 njësi më e lartë se në dunitet, kurse  $\text{MgO}$  rrëth 2.5 njësi më e ulët (pas serpentinizimit). Përsa i përket  $\text{Fe}_2\text{O}_3$ , me rritjen e HK, si në dunitet ashtu edhe në harcburgitet vihet re një rritje e dukshme e këtij përbërësi. «Shtesa» e  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  përfekt të serpentinizimit luhatet nga 0-4%  $\text{Fe}_2\text{O}_3$ . Me rritjen e HK, në të dy llojet shkëmbore sasia e  $\text{FeO}$  zvogëlohet në masën 0-4%  $\text{FeO}$ . Vihet re se  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{MnO}$ ,  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ,  $\text{NiO}$  nuk janë ndikuar aspak nga proçesi i serpentinizimit, kurse për  $\text{K}_2\text{O}$ ,  $\text{Na}_2\text{O}$ ,  $\text{CaO}$ , ky ndikim është i papërfillshëm.

Nga sa u parashtrua më sipër arrijmë në përfundimin se proçesi i serpentinizimit ka shkaktuar ndryshime të ndjeshme në përbërjen kimike të llojeve shkëmbore ultrabazike të MUB-it, kryesisht për  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$ ,  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  dhe  $\text{FeO}$ .

Serpentinizimi ka ndikuar në ndryshimin e tabllosë së kimizmit të masivit ultrabazik të Bulqizës në krahasim me gjëndjen e tij të pa serpentinizuar. Prandaj edhe pamja që merret sot në bazë të analizave silikate nuk është ajo fillestare. Si rrjedhojë edhe krahasimet e sektorëve të ndryshme në bazë të këtyre analizave nuk mund të bëhen për gjëndjen fillestare. Rindërtimi i pamjes fillestare të kimizmit përfërshi i gjithë masivin do të jepte të dhëna më afër të vërtetës dhe krahasimet ndërmjet sektorëve të veçantë të masivit do të ishin më të




fig. 1. Varësia e  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$ ,  $\text{Fe}_2\text{O}_3$  dhe  $\text{FeO}$  nga shkalla e serpentinizimit (HK).

1 — Për dunitet, 2 — për hartzburgitet.

— The dependence of  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$  ( $\text{Fe}_2\text{O}_3$ ) and  $\text{FeO}$  on the serpentization scale (HK) for the dunites (1) and hartzburgites (2).

bazuara dhe më shprehëse. Ky rindërtim është realizuar nëpërmjet modelimit të proçesit të serpentinizimit duke u bazuar në metodën e katrorëve më të vegjël.

### Modelimi i proçesit të serpentinizimit dhe korigjimi i modelit të tij.

Për korigjinimin e ndikimit të proçesit të serpentinizimit, së pari duhet përcaktuar reaksiioni që karakterizon në mënyrë më të plotë e më të saktë këtë proçes në masivin ultrabazik të Bulqizës. Nga reaktionet e shumta që jepin studiues të ndryshëm, ne kemi zgjedhur si më të përshtatshëm reaksiionin:


Olivine + Opx + Cpx + Chr +  $\text{H}_2\text{O} \rightarrow$  Serpentinë + Talk + Brusit + Magnetit + Olivinë + Opx + Cpx + Chr +  $\text{H}_4\text{SiO}_4$  + Brusit i larguar (7). Ky reaksiion, mendojmë, e karakterizon në mënyrë më të plotë proçesin e ndryshimeve metasomatike përmes shkëmbor të marrë në studim. Mineralet kryesore shkëmbformuese (fazat minerale) kanë qenë olivina, ortopirokseni e në sasi më të vogla klinopirokseni dhe kromiti aksesor, që të përzjerë në raporte të ndryshme ndërmjet tyre dhanë shkëmbinjtë pârësorë të freskët ultrabazikë të masivit. Më pas, ata, nga bashkëveprimi me fluidet ujore dhanë llojet e serpentinizuar që takojmë sot. Ana e majtë e ekuationit (7) që shpreh këtë reaksiion përbëhet nga O1, Opx, Cpx dhe Chr aksesor që janë mi-

neralet shkëmbformuese të MUB-it dhe nga uji i domosdoshëm për zhvillimin e procesit të serpentinizimit. Në këtë rast, në ujin e reaksiionit nënkuptohen edhe fluidet e përbërjeve të ndryshme të pranishme në ujin e serpentinizimit, ndonëse në sasi mjaft të vogla.

Zhvillimi i procesit të serpentinizimit ka si produkt anën e djathtë të reaksiionit (7). Nga komponimet e produktit të serpentizimit serpentina, talku, magnetiti (të formuar rishtas), elivina dhe pirokseni (të pashëndruar nga ky proces) dhe pjesërisht silica dhe brusiti, përfaqësohen së bashku nga ana cilësore nga shkëmbi i serpentinizuar që kemi kampionuar, kurse nga ana sasiore nga analiza silikate respektive e çdo prove.  $\text{SiO}_2$  i çliruar largohet kryesisht në solucion si acid silicik  $\text{H}_4\text{SiO}_4$  i padisocueshëm bashkë me ujrat nëntokësore e sipërfaqësore. Edhe brusiti largohet pjesërisht pa në këtë formë.

Përbërja kimike e humbjes në kalcinim, e konstatuar nëpërmjet analizimit të 20 provave, rezulton të jetë pothuajse tërësisht  $\text{H}_2\text{O}$  (fig. 2). Elementët e mundshëm volatile në të si  $\text{CO}_2$ , etj, gjenden në përbajtje mjaft të ulta, poshtë kufirit të ndjeshmërisë së metodave analitike që përdorim sot. Ky fakt mbështet origjinën e serpentinizimit si rezultat i bashkëveprimit të shkëmbinjve me ujin, pa pjesmarrjen e elementeve të tjera volatile.

Ekuacioni (7) mund të paraqitet në trajtë:



Zgjidhja e ekuacionit (8) kërkon njohjen e përbërjes kimike të mostrës së shkëmbit në studim (analiza silikate) dhe njohjen e përbërjes kimike të të gjitha fazave minerale që marrin pjesë në reaksiون. Por në aktualisht nuk kemi analizat mikroprovë të fazave minerale për çdo mostër të veçantë, prandaj për të kapërcyer këtë problem kemi ndjekur një rrugë të re nëpërmjet përllogaritjeve bazuar në përbërjen kimike të shkëmbit. Kjo rrugë është më e leverdissëhme edhe në aspektin ekonomik.

Sic është vënë re në dukje edhe më lart, përbërja mineralogjike e shkëmbinjve ultrabajzikë të MUB-it është e thjeshtë dhe konsiston nga olivina, ortopirokseni, klinopirokseni dhe kromiti aksesor. Për përbërjen kimike të këtyre fazave minerale për këtë masiv ka pak të dhëna. Këtij problemi duhet t'i kushtohet më shumë vëmëndje në të ardhmen, sidomos për të evidentuar veçoritë e kimizmit të këtyre fazave minerale në faciet e ndryshme petrografike ultrabajzike. Në studimin tonë shfrytëzuam të gjitha të dhënat e këtij karakteri të botuar për MUB-in (I. Premti\*, K. Gjata\*\*). Në tabelën 1 jepen përbajtjet mesatare të 13 oksideve përfazat minerale të shkëmbinjve të këtij masivi. Për ol, oxp, dhe chr janë shfrytëzuar përkatesisht 23, 12, 6 dhe 14 analiza, ndërsa përf silicin, brusitin dhe ujin, përbërjet kimike mesatare u muarën nga literatura (Le Maitre R.W. 1982).

Është e qartë e fazat minerale kryesore shkëmbformuese ol, oxp, cpx dhe chr nuk janë konstante në masiv dhe nuk mund të karakteri-

zohen plotësisht vetëm nga vlerat mesatare të oksideve përbërës. Por po të kemi parasysh se cpx dhe chr si faza minerale në shkëmbinjtë e studiuar ndodhen në sasi mjaft të vogla dhe elementët kryesore të tyre Ca, Cr, nuk ndikohen nga serpentinizimi, gabimi që bëjmë gjatë llogaritjes së përbërjes së shkëmbit, duke pranuar të njëjtën përbërje kimike të tyre përfshirë gjitha mostrat, është i papërfillshëm dhe nuk i kalon kufijtë e gabimit analistik përfshirë oksidet përkatese.

Ndryshe ndodh kur marrim në konsideratë olivinën dhe ortopiroksinin, që janë edhe fazat minerale përbërëse kryesore të shkëmbinjve të MUB-it. Pranimi i vlerave mesatare përfshirë elementeve mesas të vogël ( $\text{TiO}_2$ ,  $\text{Al}_2\text{O}_3$ ,  $\text{MnO}$ ,  $\text{CaO}$ ,  $\text{K}_2\text{O}$ ,  $\text{NiO}$ ,  $\text{Cr}_2\text{O}_3$ ) përfshirë këto dy fazave minerale është i pranueshëm dhe brenda kufijve të gabimeve analitike të metodave që përdorim përfshirë analizimin e tyre. Përkundrazi, një gjë e tillë do të ishte e gabuar dhe papranueshme përfshirë  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$ , dhe  $\text{FeO}$ . Aq më tepër edhe sepse procesi i serpentinizimit ka ndikuar pikërisht këta elementë.




Fig. 2. Varësia e HK nga uji i serpentinizimit  $\text{H}_2\text{O}^+$ . The dependence of HK on the serpentization water  $\text{H}_2\text{O}^+$ .

Përbërja mineralogjike e olivinës dhe e ortopiroksenit është e thjeshtë, përkatesisht nga forsteriti dhe fajaliti përfshirë olivinën dhe nga enstatiti, bronziti dhe hipersteni përfshirë ortopiroksenin. Studimet petrografike e mineralogjike kanë treguar se këto faza minerale luhaten në

\* Analizat janë kryer në Universitetin «La Sapienza» të Romës, Itali.

\*\* Analizat janë kryer në Universitetin e Clermont Ferrandit, Francë.

kufij mjaft të ngushtë. Kështu olivina luhatet nga Fo 88 në Fo 96 dhe ortopirokseni nga En 86-En 96 (Dobi A. 1980, 1981; Premti I. 1984; Stërmasi Sh. 1989; etj). Është e qartë se është pikërisht ky variacion i përbërjes mineralogjike të olivinës dhe ortopiroksenit që kushtëzón edhe ndryshueshmérinë e përbërjes kimike të olivinës dhe ortopiroksenit në shkëmbinjtë e masivit. Për të karakterizuar nga ana sasiore këto marëdhënie u studiuani varësitë që egzistojnë ndërmjet përbajtjeve së  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$  dhe  $\text{FeO}$  tipit 01 e oxp, duke u bazuar në analizat mikroprobe që dispónuam. Siç shihet edhe nga figura 3, varësitë kanë karakter linear, prandaj në të gjitha rastet ato u kërkuan në trajtën:  $y = bo + b_1x$ . Nga përpunimi i të dhënavëve me programin REGLIN (Kuka N., 1987) u përfshuan ekuationet e mëposhtme:

$$\begin{aligned} \text{MgO} &= 1.8868 + 0.5188 \text{ Fo} \\ \text{FeO} &= 66.0922 - 0.6200 \text{ Fo} \end{aligned} \quad (9)$$

## Për ortopiroksenin:

$$\begin{aligned} \text{SiO}_2 &= 81.86242 + 0.2862 \text{ En} \\ \text{MgO} &= 46.3614 - 0.1234 \text{ En} \\ \text{FeO} &= 8.1956 - 0.0186 \text{ En} \end{aligned} \quad (10)$$

Zgjidhja e ekuacionit të serpentinizimit (ekuacioni 8) është bërë për të gjithë kombinimet e mundshme të tipeve të Fö dhe En në shkëmbinjtë e MUB-it (pasqyra 2). Kështu ne kemi variuar olivinën nga Fo 85 deri në Fo 98 dhe otropiroksenin nga En 80 në En 96, pra 238 variante zgjidhjeje për çdo mostër të veçantë. Për secilin variant  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{MgO}$  dhe  $\text{FeO}$  për olivinën dhe ortopiroksenin janë llogaritur sipas ekuacioneve (9) dhe (10). Ndërsa vlerat e oksideve përfazat e tjera janë marrë nga pasqyra 1.

Meqë zgjidhja matematike e ekuacionit (8) nuk është e vetme, nga tërësia e zgjidhjeve të përfshirur veçohet ajo që përkon më shumë me natyrën petrografike të mostrës dhe duke vendosur kufizime plotësuese petrologjike për zgjidhjet e marra. Për realizimin e kësaj kemi vepruar si më poshtë:

Së pari, nga tërësia e zgjidhjeve janë përjashtuar të gjitha ato zgjidhje në të cilat raportet e fazave minerale (sasia në % e tyre) të futura në reaksion për të formuar shkëmbin rezultojnë negative se pse një zgjidhje e tillë nuk ka kuptim petrologjik.

Së dyti, është patur parasysh diapazoni i mundshëm i ndryshimit të sasisë së olivinës, ortopiroksenit, klinopiroksenit dhe kromtit aksesor në shkëmbinitë që studiojmë.

Së treti, është pranuar edhe qëndrueshmëria e sasisë së FeO gjatë proçesit të serpentinizimit. Vërtetë, nga analiza e regresit për varësinë e shkallës së ndikimit të proçesit të serpentinizimit ndaj oksideve kryesore shkëmbformues të llojeve petrografike të MUB-it, rezulton se sas-




Fig. 3. Varësia e përbajtjes së  $\text{SiO}_2$ ,  $\text{FeO}^+$  dhe  $\text{MgO}$  nga lloji i olivinës dhe ortopiroksenit.

sia e FeO nuk ndikohet nga ky proces; ndryshon vetëm rapporti  $\text{Fe}^{2+}/\text{Fe}^{3+}$ , ndërsa balanci total i FeO mbetet i pandryshuar.

Duke patur parasysh vëllimin e informacionit parësor që duhet të përpunohet, numrin e shumtë të zgjidhjeve të reaksionit të serpentinizimit për çdo provë për diapazonin e zgjedhur të Fo, En, si dhe kohën që nevojitet për kryerjen e veprimeve për këto zgjidhje, fazat logjike që nevojiten për përcaktimin e përbërjes kimike të shkëmbinjve ultrabazike në gjëndjen e tyre të freskët para ndikimit nga procësi i serpentinizimit, janë realizuar në tre programe operative: GENMIX

(Le Maitre R.M. 1982), GENMIX1, GENMIX2, (Kuka N., 1988). Procedura e përpunimit pasqyrohet në bllokskemën fig. 4.

Nr	FAZAT MINERALE	PASQYR H 1											
		O	K	S	I	D	E	T	%				
1	OLIVINA $F_0 = 93$	40.70	0.028	0.12	8.39	0.09	50.16	0.05	0.10	0.02	0.35	0.03	0
2	ORTOPIROKSENIT	55.42	0.004	1.15	6.47	0.10	34.97	0.42	0.23	0.00	0.03	0.24	0
3	KLINOPIROKSENIT	53.02	0.16	2.37	2.87	0.12	18.63	20.20	0.68	0.00	0.04	0.88	0
4	KROMITI AKSESOR	0.00	0.12	13.69	7.61	0.23	11.25	0.00	0.00	0.00	0.07	54.83	0
5	H <sub>2</sub> O	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	100	
6	SiO <sub>2</sub>	100	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
7	BRUSITI	0	0	0	0	0	69.00	0	0	0	0	31	

Pasqyra 1. Përbajtjet mesatare të oksideve në fazat minerale të shkëmbinjve ultrabajzikë të MUB.

The average content of the oxides in the mineral phases of the ultrabasic rocks of MUB.

SHMEMBUL TE ZGJIDHJES SE EKUACIONIT TE MODELIMIT TE SERPENTINIZIMIT											
BAZUAR NE METODEN E KATROREVE METE VEGJEL											
REAGENTET SiO <sub>2</sub> TiO <sub>2</sub> Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> FeO <sub>TOTAL</sub> MnO MgO CaO Na <sub>2</sub> O K <sub>2</sub> O NiO Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub> HK FeO											
1. OLIVINE 40.70 0.03 0.12 0.09 50.16 0.05 0.10 0.02 0.35 0.03 0.00 0.39											
2 OPx 55.42 0.00 1.15 0.10 34.97 0.42 0.23 0.00 0.03 0.24 0.00 6.47											
3 CPx 53.02 0.16 2.37 0.12 18.63 20.20 0.68 0.00 0.04 0.88 0.00 2.87											
4 Chr 0.00 0.12 13.69 0.25 11.25 0.00 0.00 0.00 0.07 54.83 0.00 7.61											
5 H <sub>2</sub> O 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 10.00 0.00											
PRODUKTET											
1 SiO <sub>2</sub> 100.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00											
2 BRUSIT 0.00 0.00 0.00 0.00 0.00 69.00 0.00 0.00 0.00 0.00 31.00 0.00											
NUMRI RENDOR NUMRI PROVES											
SASIA 100/1340											
OLIVINE OPx CPx Chr H <sub>2</sub> O SiO <sub>2</sub> BRUSIT 100/1340											
72 72 25.81 0.37 0.99 1.14 8.26 1.56 90/39											
SASIA 100/1340											
OLIVINE OPx CPx Chr H <sub>2</sub> O SiO <sub>2</sub> BRUSIT 100/1340											
72 72 25.81 0.37 0.99 1.14 8.26 1.56 90/39											
ANALIZATE SiO <sub>2</sub> TiO <sub>2</sub> Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> FeO <sub>TOTAL</sub> MnO MgO CaO Na <sub>2</sub> O K <sub>2</sub> O NiO Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub> HK Shuma											
ANA E MAJTE 44.85 0.02 0.58 1.26 0.09 44.59 0.28 0.58 0.01 0.24 0.64 0.14 99.59											
ANA E DZATNE 44.53 0.00 0.63 1.23 0.14 44.59 0.27 0.63 0.09 0.52 0.63 1.10 100.01											
NDRYSHIMI MIDIS 0.00 0.02 0.03 0.03 0.04 0.00 0.01 0.26 0.08 0.07 0.01 0.00											
SHUMA E MBETUR E RATORRE 0.0808 NDRYSHIMI MIDIS PERBERJEVE 0.2843											
PERBERJA MODALE OL 67.26 OPx 31.17 CPx 0.57 Chr 1.00 Fe 94 Er 95											
NUMRI RENDOR NUMRI PROVES											
100/1340											
SASIA 100/1340											
OLIVINE OPx CPx Chr H <sub>2</sub> O SiO <sub>2</sub> BRUSIT 0.75											
80.25 16.40 1.74 0.40 1.75 0.77 1.20 90.02											
ANALIZATE SiO <sub>2</sub> TiO <sub>2</sub> Al <sub>2</sub> O <sub>3</sub> FeO <sub>TOTAL</sub> MnO MgO CaO Na <sub>2</sub> O K <sub>2</sub> O NiO Cr <sub>2</sub> O <sub>3</sub> HK Shuma											
ANA E MAJTE 42.54 0.03 0.39 8.47 0.09 45.95 0.67 0.92 0.02 0.29 0.54 1.15 100.00											
ANA E DZATNE 42.58 0.01 0.54 8.45 0.20 46.99 0.55 0.85 0.00 0.27 0.44 0.19 100.00											
NDRYSHIMI MIDIS 0.04 0.02 0.05 0.06 0.04 0.05 0.59 0.02 0.01 0.01 0.01 0.04											
SHUMA E MBETUR E RATORRE 0.1846 NDRYSHIMI MIDIS PERBERJEVE 0.4359											
PERBERJA MODALE OL 81.03 OPx 16.72 CPx 1.71 Chr 0.48 Fe 92 Er 91											

Pasqyra 2 Shembuj të zgjidhjes së ekuacionit të modelimit të serpentinizimit bazuar në metodën e katorrëve më të vegjel.

Examples of the solution of the serpentization modelling equation after the least squares method.

## Korrigimi i ndikimit të serpentinizimit

Si rezultat i zbatimit të procedurës së mësipërme për çdo mostër përftohen përbërja modale e shkëmbit para serpentinizimit, tipi i olivevinës dhe otropiroksenit si dhe përbërja kimike e mostrës në gjendje të paserpentinizuar. Mbi bazën e këtyre të dhënave janë ndërtuar haratat përkatëse të izovlerave si dhe është bërë studimi i mëtejshëm statistikor i masivit.




Fig. 4. Skema e përpunimit të të dhënave të analizave silikate për korigjinim e ndikimit të procesit të serpentinizimit

në kimizmin e shkëmbinjve.

The scheme of the elaboration of chemical data for the correction of the influence of the serpentization in the chemistry of the ultramafic rocks.

## Përfundime

1. Përpara se analizat silikate të përdoren për qëllime praktike, është e domosdoshme që ato të korigohen nga ndikimi i proceseve dytësore metasomatike. Metoda e katorrëve më të vegjel përbën sot një instrument të fuqishëm për zgjidhjen e problemeve të kësaj natyre. Zbatimi me sukses i saj kërkon si parakusht një studim të hollësisht të problemeve metasomatike për rajonin që studiohet dhe zgjedhjen e reaksioneve që karakterizojnë në mënyrë më të plotë e më e saktë këto procese.

2. Metoda dhe programet e përdoren për korigjinim e ndikimit të procesit të serpentinizimit në përbërjen kimike të shkëmbinjve të masivit ultrabajzik të Bulqizës, mund të përdoren për korigjinim e ndikimit

të proceseve metasomatike jo vetëm për shkëmbinjtë ultrabazike, por edhe për llojet e tjera të shkëmbinjve magmatike.

### LITERATURA

- Cili P. 1985 — Raport mbi studimin tematiko-përgjithësues dhe rilevues kompleks për prognozën e krombajtjes së masivit ultrabazik të Shebenikut, Tiranë.
- Dobi A. 1981 — Petrologjia e masivit ultrabazik të Bulqizës dhe vlerësimi krombajtjes. Disertacion, Tiranë.
- Gusev G.M. etj. 1987 — The modelling of brucite transformation processes. Geologija i Geofizika Nr. 10, f. 54.
- Hodirjev D. Ju. 1986 — Fazovje sootnosheni vsisteme MgO-SiO<sub>2</sub>-H<sub>2</sub>O v prilozhenij k petrologi ultraosnovnih porod manti. Geokimija Nr. 9, f. 1354.
- Kuka N. 1987 — Reglin — program i analizës së regresit linear. Tiranë.
- Kuka N. 1988 — Genmix-programme te MPP Tiranë.
- Le Maitre R.W. 1981 — GENMIX — A generalised petrological mixing model program. Computers and Geosciences vol. 7, pp. 229-247.
- Le Maitre R.W. 1982 — Numerical petrology. Amsterdam.
- Premti I. 1984 — Petrologjia e shkëmbinjve ultrabazike të rajonit të Bulqizës dhe perspektiva e tyre krommbajtëse. Disertacion. Tiranë.
- Premti I. 1986 — Hapja dhe konkretizimi i perspektivës së mineralizimit të kromit të pasur në zonën perëndimore të vendburimit Batër Tiranë.
- Pugin V.A. 1969 — Reakcija serpentinizacija i deserpentinizacije. Geokimija Nr. 10, f. 1188.
- Qorlaze S. etj. 1986 — Çelja e perspektivës dhe konkretizimi i vazhdimesisë së mineralit të pasur në krahun lindor të vendburimit të Bulqizës dhe në zonën ndërmjetëse Bulqizë Almarin-Afer Liqeje Tiranë.
- Rickwood P.C. 1989 — Boundary lines within petrologic diagrams which use oxides of major and minor elements, «LITHOS» volume 22, Nr. 4, April.
- Sllutskij A.B. 1984 — Ustvojclivnost serpentina i talka v sisteme MgO-SiO<sub>2</sub>-H<sub>2</sub>O pri visokih davlenijah (po danim petrograficeskovo analisa). Geokimija Nr. 3, f. 314.
- Stërmasi Sh. 1989 — Studim tematik përgjithësues-rilevues kompleks për përcaktimin e ligjësive të lokalizimit të kromitit hapjen e perspektivës në rajonin Bulqizë-Batër-Thekën.
- Shallo M. etj. 1985 — Magmatizmi ofiolitik i RPSSH Tiranë.
- Velinskij V.V. 1978 — Serpentinizacija giperbazitov. Geologija i Geofizika Nr. 3, f. 52.
- Velinskij V.V/1983 — Dehydration of serpentine and the part that plays secondary mineral formation in ultrabazites. Geologija i Geofizika. Nr. 6, f. 78.

Dorëzuar në redaksi në qershor 1990.

### Summary

#### THE CORRECTION OF THE SERPENTINIZATION IN THE CHEMISTRY OF THE ULTRAMAFIC ROCKS.

The chemical composition of ultramafic rocks, being a reflection of their mineralogical composition, plays an important role in the geological studies for the distinction and classification of the several rocky complexes. But we have to bear in mind that it is influenced very much by the hydrothermal-metasomatic activity which affect these rocks. Thus, it is necessary that the silicate analyses must be corrected from the influence of the above mentioned secondary processes.

Nowdays the least squares method is a powerful means for the solution of problems of this nature. But its successful application needs in advance a detailed study of secondary processes and the selection of reaction which characterize these processes.

This paper presents, through the example of the ultrabasic massif of Bulqiza, the complete method, for the correction of the influence of the serpentinization process in the ultramafic rocks. We stress that the above method and the respective programmes can be used for the correction of the influence of metasomatic processes not only for the ultramafic rocks, but also for the other sorts of magmatic rocks.

## VEÇORITË E PËRBËRJES MINERALE TË XEHERORËVË TË Ni-Cu NË VENDBURIMIN E LUMTHIT DHE KUSHTET E FORMIMIT TË TYRE

**Efigjeni Vllaho\***

Jepet përbërja minerale e vendburimit të Lumthit dhe bëhet përshkrimi i mineraleve kryesore xehore, duke u ndalur vëçanërisht në kushtet e formimit të tyre.

### TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME

Në ndërtimin gjeologjik të vendburimit të Lumthit marrin pjesë shkëmbinj ultrabazik-bazikë dhe shkëmbinj vullkanikë bazikë. Mineralizimi ndodhet në shkëmbinjtë ultrabazikë përfaqësuar kryesisht nga lercolite që formojnë një brez të ngushtë me shtrirje pothuajse meridionale ( $320\text{--}330^\circ$ ) dhe me rënje verilindore me kënd  $70\text{--}85^\circ$ .

Nën ndikimin e ndrydhjes së fuqishme, shkëmbinjtë rrethues janë kataklazuar e millonituar intensivisht, ndërsa nga veprimitaria hidrotermale e mëvonëshme ata janë metamorfizuar e shndërruar në shkëmbinj serpentin-amfibol-kloritike dhe serpentin-kloritikë.

Mineralizimi përfaqësohet nga një sërë zonash xehore brenda të cilave veçohen trupa xehorë pajtues të sulfureve të nikelist e bakrit në formë thjerezore me përmasa në shtrirje e rënje disa dhjetra metra dhe me trashësi 1-2 deri 3-4 m, ndërsa zonat e mineralizuara janë 2-3 herë më të mëdha.

Përhapja e mineralizimit sulfur e sidomos e trupave xehorë është tepër heterogene. Veçohen dy zona kryesore: zonat qëndrore dhe lindore.

\* N. Gjeologjike në Tiranë.

E. Vllaho




Fig. Nr. 1 — Harta gjeologjike e skematike.

1. Shkëmbinj ultrabazikë; 2 — diabaze;
  - 3 — prishje tektonike; 4 — zona e mineralizuar;
  - 5 — trup xehleror.
- Schematic geological map.
- 1 — ultrabasic rocks;
  - 2 — diabases;
  - 3 — fault;
  - 4 — mineralized zone;
  - 5 — ore body.

### PËRBËRJA MINERALE E TRUPAVE XEHORORE

Mineralet kryesore xehlerorë në trupat e Lumthit janë pentlanditi, kalkopiriti, pirotina, piriti si dhe magnetiti i cili mbyll fazën e mineralizimit produktiv (A. Çina 1981, E. Vllaho 1982). Si rrjedhojë tjetërsimeve të mëvonëshme janë formuar sasira të vogla mineralesh dytësore, si: bravoiti, violariti e makinaviti të formuara sipas pentlandit dhe valeriiti, kovelina, kalkozina etj. të formuara sipas kalkopiritit




Fig. 2 — Prerje tërthore e zonave të mineralizuara.  
 1. Punime kërkim-zbulimi; 2 — zona minrale; 3 — trup xehleror; 4 — shkëmbinj ultrabazik të tjetërsuar.  
 Cross section of mineralized zones.

ritit. Në kushte afër sipërfaqësore takohen mallahit dhe hidrokside hekuri. Nga studimet e kryera me prova të mëdha në koncentrate kanë rezultuar edhe përbajtje të ngritura ari, por trajtat minerale të tij nuk janë takuar. Me sa duket ari lidhet me mineralizimin sulfur mbasi vlerat në masën tjetër janë krejtësisht të papërfillëshme. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për elementët platinoidë për të cilën janë bërë një sërë analizash (Orova M. 1985).

Mineralet jo xehlerorë përbëjnë masën kryesore të trupave, dhe përfaqësohen nga antigoriti-mikroantigoriti, krizotili, bastiti, amfiboli dhe kloriti që shpesh ndërthuren me mineralet xehlerore duke krijuar përshtypjen se janë formuar njëkohësisht. Si mineralet aksesore takohen: kromit, sfen, granat si dhe hidrogranat si produkt i tjetërsimit metasomatik. Shpesh takohen karbonate, kryesisht kalcit, i cili ndërpert ose zëvendëson mineralet xehlerore e jo xehlerore.

Nga analizat kimike e spektrale dhe nga vrojtimet e shumta mikroskopike është vërejtur se mineralizimi sulfur ka një shpërndarje sasiore e cilësore tepër heterogjene. Kështu takohen trupa xehlerorë ku mbizotëron pentlanditi me fare pak kalkopirit, trupa me pentlandit e kalkopirit e ndonjë trup kryesisht pirotinor.

Duke u bazuar në karakteristikat tekstuore e strukturore mund të veçohen tre tipe kryesore mineralizimi:

1. Tipi i parë i gjeneracionit më të hershmë, është ai i mineralizimit pirotinor që është zëvendësuar intensivisht nga piriti. Ky tip përfaqësohet nga një trup xehleror i veçantë në zonën qëndrore; në sasi të vogël takohet si mbetje edhe në trupa të tjera xehlerorë.

2. Tipi i dytë përfaqësohet nga bashkëshoqërimi pentlandit-kalkopirit; i përket dy ose më shumë stadeve të veprimtarisë hidrotermale. Takohet në disa trupa xehlerorë të sektorit qëndror dhe karakterizohet nga grumbullime ku mbizotëron kalkopiriti.

3. Tipi i tretë me pentlandit e pak kalkopirit, është tipi më produktiv dhe përfaqësohet nga trupat xehlerorë të sektorit lindor; ai përbën edhe disa trupa më të kufizuara në sektorin qëndror. Me këtë tip lidhen rezervat kryesore të nikelicës vendburimin e Lumthit.

## KARAKTERISTIKAT E MINERALEVE KRYESORE METALORE

### Pentlanditi

Është minerali kryesor i trupave xehlerorë të vendburimit. Ai përbën rreth 70% të masës së sulfureve në sektorin qëndror dhe 90-95% në sektorin lindor. Paraqitet në disa trajta, të cilat përfaqësojnë disa gjeneracione:

1. Kokrriza dhe aggregate kokrrizore alotriomorfë me teksturën e mikrotekstura njollore, rrjetore-nyjore e vargore-damarore. Kjo trajtë përbën masën kryesore të gjithë sasisë së pentlanditit. Përmasat e kokrrizave janë më të vogla se 0.1-0.2 mm dhe të aggregateve kokrrizore nga disa të dhjeta deri në disa milimetra madhësi.

Në periferi të kokrrizave ose aggregateve kokrrizore herë herë pentlanditi ndërthuret me mineralet shkëmb-formues antigoritin, amfibolin etj., duke formuar struktura grafike e luspore, gjë që dëshmon përt njëjtën kohë formimi të tyre. (Foto 1).




Foto 1 — Struktura grafike. Pentlanditi ndërthuret me mineralet shkëmb-formuese (Zm 210x). Graphic structure. Pentlandite is intertwined with rock-forming minerals (X 210).

Nganjëherë pentlanditi rrrethohet, ndërpritet e zëvendësohet nga kalkopiriti, piriti, magnetiti e minerale jo xehlerore të mëvonëshme duke krijuar struktura rrjetore e relikte (foto 2).




Foto 2 — Damar piriti (Pi) me kristale magnetiti (Mt) që ndërpresin jo vetëm masën shkëmbore por edhe dy tipet e tjera të pentlanditit. Pyrite vein (Pi) with magnetite crystals which intersect pentlandite (Pn). (X 210).

2. Pentlanditi i bashkëshoqëruar me kalkopiritin, në forma kokrrizash e damarësh të hollë. Damarët ndërpresin jo vetëm masën shkëmbore por edhe dy tipet e tjera të pentlanditit. Ky tip ka raste që shohet edhe me magnetitin.

3. Pentlanditi në kokrriza të vogla me përmasa deri 50 mikron kryesisht idiomorfë me prerje shumëkëndëshe, takohet si ndërfutje në masën shkëmbore e përhapur pothuaj uniformisht në të, ose në formë follesh. Kjo trajtë përbën rreth 10-15% të gjithë sasisë së pentlanditit. (Foto 3).



Foto 3 — Grumbullime kokrrizash pentlanditi ndërmjet masës shkëmbore (Zm 25 x). Pentlandite grains accumulation among the rock mass (X 25).

Nga vrojtimet e kujdesëshme të anshlifeve dhe shlifeve janë evidençuar disa veçori të cilat dëshmojnë për veprimtarinë e mëvonëshme hidrotermale e tektonike të pasmineralizimit:

a. Në trupat që i janë nënshtuar një tektonike të fuqishme, si rrjedhojë e së cilës shkëmbinjtë rrethues janë shndërruar në rreshpë millionitike, pentlanditi karakterizohet nga një rreshpëzim i imët, sipas të cilit kanë penetruar minerale jo xehore, duke krijuar strukturën mikrorjetore.

b. Në disa trupa të tjerë sipas rreshpëzimit zhvillohet magnetit gjë që dëshmon për qarkullimin e tretësirave me potencial oksidues të lartë.

c — Shkëmbinjtë rrethues dhe trupat e zonat e mineralizuara të vendburimit ndërpriten nga damarë krizotili e amfiboli mikroashklor të mbushur herë-herë me magnetit. Në këtë rast, pentlanditi është ndarë në copa të veçanta që qimentohen nga mineralet jo xehore ose magnetiti.

Karakteristikat e përmendura tregojnë për tre gjeneracione pentlanditi pa ndonjë ndërprerje të theksuar ndërmjet tyre; megjithatë gjeneracioni i tretë mund të veçohet më qartë.

Sipas të dhënave të përbërjes elementare të përcaktuar me mikrosondë elektronike të tre tipet e pentlanditit kanë pothuaj të njëjtën përbajtje (pasqyra 1).

Kalkopiriti — është minerali i dytë përbërës i trupave xehorë për nga sasia e rëndësia. Përbajtja e tij në trupat xehorë të vendburimit, bille edhe brenda të njëjtët trup ka luhatje të theksuara. Ka trupa ku kalkopiriti është përbërës i rëndësishëm, kurse në vende të tjera pothuaj mungon. Paraqitet në disa trajta morfologjike:

1. kokrriza ose aggregate kokrrizore ksenomorfë ndërmjet masës shkëmbore ose aggregateve të pentlanditit. Ka raste që në përfperi të kokrrizave ose aggregateve kokrrizore të tij, vërehen struktura luspore e grafike si rrjedhojë e ndërthurjes së tij me mineralet shkëmbformuese. Kjo trajtë kalkopiriti është si duket e të njëjtë gjenerator me pentlanditin, por kalkopiriti ka kristalizuar pak më vonë dhe vendoset në periferi të kokrrizave të pentlanditit e në ndonjë rast penetron në të sipas rreshpëzimit; nuk përashtohet mundësia që të kemi dhe formime të strukturave të ndarjes të tretësirave të ngurta gjatë proceseve të mëvonëshme të dinamometamorfiçimit me të.

2. Një trajtë mjaft e përhapur e ndodhjes së kalkopiritit është ajo damarore. Damarët e dejet e kalkopiritit me trashësi deri disa dhjetra mikron ndërpresin masën shkëmbore dhe aggregatet e pentlanditit e të kalkopiritit të formuar më parë. Vende vende takohen bashkëshoqërimë me pentlanditin me të cilin krijon aggregate vargorë. Ka raste kur rreth damarëve të kalkopiritit vërehen oreola kalkopiriti në trajtë kokrrizash' sferike me përmasa deri 0.2 mm, përmasat dhe sasia e të cilave vijnë duke u zgogluar në drejtim të masës shkëmbore.

3. Rrallë takohen damarë e trajta të rrumbullakta me strukturë kollomorfe sferike e festone. Këta damarë ndërpresin formimet më të hershme dhe shpesh lokalizohen në mikroçarje, gjë që vërteton formimin e tyre nga një tretësirë e mëvonëshme e temperaturave të ulta.

Kalkopiriti ashtu si pentlanditi ndërpritet e rrethohet shpesh nga magnetiti (Foto. 4).




Foto 4 — Sipas rreshpëzimit e çarjeve të kalkopiritit depertojnë damarë magnetiti. (Zm 150 x); After chalcopyrite fractures are developed the magnetite veins. (X 150).

Pasqyra 1

Nr.	Nr. kampionit	Lloji strukturor i pentlanditit	Elementët %			
			S	Fe	Ni	Cu
1.	393	Agregat kokrrizor	29.03	40.62	30.34	
2.	393	Pjesërisht i shndërruar sipas shpëtëzimit në magnetit	34.43	28.70	36.87	
3.	751	Kokrriza të veçanta	35.92	26.38	35.86	1.83
4.	751	Agregat kokrrizor	34.75	35.89	28.95	0.41
5.	1077	Veçime sipas jometalore.	34.49	28.77	36.74	
6.	1077	Agregat kokrrizor	34.45	28.88	36.67	
7.	1077	Copa ndërmjet aggregateve kokrrizore	34.04	28.78	37.17	

*Pirotina* — takohet rrallë, por krijon aggregate kokrrizore me teksturë masive kompakte. Përgjithështë eshtë e shndërruar në pirit e magnetit me strukturë grafike nën veprimin e tretësirave të mëvonëshme, kështu, prej pirotinës ruhet vetëm trajta tabelore dhe shpëtëzimi (Foto 5).




Foto 5 — Mbetje piriti (i rrjedhur nga tjetërsimi i pirotinës) në pentlandit. Pentlanditi eshtë intensivisht i zëvendësuar nga magnetiti; struktura mikrorjetore. Zm 250x.  
Pyrite relic remained from the alteration of pyrhotine in pentlandite. This one is intensively replaced by magnetite. The — micronet structure (X 250).

*Piriti* — takohet në të gjithë vendburimin. Duke gjykuar nga forma, struktura e marrëdhëniet me minqralet e tjerë përbërës të trupave e zonave të mineralizuara, supozohet se eshtë formuar në dy rruge:

1. Si rrjedhojë e tjetërsimit të mineralevë sulfure të formuar më parë e kryesisht të pirotinës.

2. I kristalizuar direkt nga tretësirat që kanë qarkulluar në çarjet e pasmineralizimit produktiv. Ky pirit paraqitet në trajtë damarore e vende vende kokrrizore. Ndërpërt e zëvendëson masën shkëmbore e mineralizimin produktiv të vendburimit. Jo rrallë bashkëshoqërohet me magnetit e markazit. Ky i fundit dëshmon për formime të temperaturave të ulta.

*Magnetiti* — eshtë i dy llojeve: i kristalizuar nga tretësirat hidrotermale në kushte të një potenciali të lartë oksidues dhe dytësor, i formuar si nga tjetërsimi i mineralevë shkëmbformues ashtu edhe i atyre sulfurore.

Duke pasur kushte e burime të ndryshme formimi edhe trajtat e ndodhjes së tij janë të ndryshme:

7. Në trajtë pikëzimesh të imta, dejesh të holla vende vende vëmesh skeletere të përhapura në masën shkëmbore. Ky lloj magnetiti eshtë formuar nga proceset e dinamometamorfizmit.

2. Në trajtë kokrizore e agregati kokrizor me strukturë damarore e vargore. Kokrrizat e magnetitit janë nga ksenomorfe deri idiomorfe dhe herë herë të rrumbullakosura. Kjo trajtë takohet si veçim në masën shkëmbore, dhe shpesh në periferi të veçimëve sulfure të pentlandit-kalkopiritit, duke krijuar përshtypjen e formimit nga e njëjtë tretësirë, por e kristalizuar në fundin e saj.

3. Në trajtë dejzash të hollë në pentlandit ku krijon struktura rrjetore. Ky magnetit zhvillohet kryesisht sipas rreshpëzimit të pentlanditit, si rezultat i metamorfizmit e veprimit të tretësirave të mëvonëshme. Kur veprimitaria eshtë intensive krijuhen struktura relikte.

#### MENDIME PËR KUSHTET E FORMIMIT TË VENDBURIMIT

Nga të dhënat e vrojtimeve makro e mikroskopike në vendburimin e Lumthit, të parashtruara pjesërisht edhe në këtë artikull, mund të jepen mendime për kushtet e formimit të tij.

Peridotitet që janë shkëmbinjtë rrethues të vendburimit, i janë sënshtruar një veprimitarie dinamometamorfike të fuqishme, që ka çuar në optim intensiv dhe serpentinizimin e tyre të shoqëruar me mjaft magnetit dytësor. Më vonë në këto zona kanë qarkulluar tretësira hidrotermale të pasura me Ni, Cu, S, O<sub>2</sub> dhe elementë të tjerë në sasi më të vogla. Këto tretësira kanë çuar më tej tjetërsimin e mineralevë shkëmbformuese (krijimi i shkëmbinje serpentin-klorit-amfibolikë) dhe në mqedise të përshtatshme, prej tyre janë kristalizuar mineralet metalore, kryesisht sulfure. Eshtë e kuptueshme që gjatë kësaj veprimitarie janë cliruar e ri grupuar jo vetëm elementë të tillë si Mg, Al, S, Fe etj., por edhe Ni, i cili ndodhet i pranishëm në trajtë izomorfe në olivinë. Nuk përjashtohet mundësia që në shkëmbinjtë parësorë të ketë patur si mineral aksesorë edhe pentlandit, i cili si rrjedhojë e veprimitarisë të mëvonshme eshtë tjetërsuar duke cliruar elementët e tij përbërës, të cilët kanë pasuruar tretësirat e ardhura.

Formimi i vendburimit sulfur të Lumthit, i përket më shumë se një gjeneracioni të veprimitarisë hidrotermale, e cila supozohet pa ndonjë ndërprerje të theksuar. Nga gjeneracioni i parë që eshtë më produktiv, eshtë formuar masa kryesore e pentlanditit dhe pak kalkopirit, që janë pothuaj të njëkohshëm me amfibolin, kloritin e antigoritin. Nga gjeneracioni i dytë formohet kalkopiriti e pak pentlandit. Ky gjeneracion eshtë më i zhvilluar në sektorin qëndror dhe dallohet qartë nga që ndërpërt e pjesërisht zëvendëson mineralizimin e gjeneracionit të parë.

Mbas kësaj veprimitarie, si rrjedhojë e pakësimit të elementeve të tillë si Ni, Cu, S në kushte oksiduese, formohet magnetiti i cili rrethon, ndërpërt e pjesërisht zëvendëson mineralizimin sulfur.

Për sa i përket pirotinës që takohen si grumbullime në sektorin

qëndror, mendojmë se mund të jetë formuar në stadin e fundit të kristalizimit magmatik, kurse tjetërsimi i saj ka ndodhur gjatë veprimit tarisë hidrotermale. Por gjithsesi ajo është formuar para pentlanditit të gjeneracionit të parë që përmban relikte të saj.

Mbas formimit të trupave xehore me mineralizim sulfur të bakër-nikelit, rajoni i është nënshtruar një veprimtarie tjetër dinamomë tamorfike, por me intensitet relativisht të ulët. Kjo veprimtarie shprehet në coptimin e mineraleve parësore sulfurë, ndërprerjen e zëvezë ndësimin e tyre prej damarëve të krizotil-asbestit, amfibolit e karbonatit si dhe në formimin e mineraleve të rinj si bravoiti, makinavit, valeriti, etj. të cilët takohen në zonat që i janë nënshtruar më intensivisht kësaj veprimtarie.

Të kufizuara tretësirash me temperaturë relativisht të ulët, prej të cilave janë formuar sasi të pakta kalkopiriti, pirotine, piritmarkaziti si dhe magnetiti.

Mbas kësaj veprimtarie në çarjet e krijuara kanë qarkulluar sasi

Si përfundim, duke gjykuar nga llojet shkëmbore, lloji i mineralizimit xehor, tekstrurat e strukturat e tij në marrëdhënie me shkëmbinj-të lokalizues të tyre, mund të themi se vendburimi i bakër-nikelit të Lumthit është formuar kryesisht nga veprimtaria hidrotermale-metasomatike (K. Gjata, 1982, M. Borova 1985).

### Përfundime

1. Mineralizimi xehor i vendburimit të Lumthit është i tipit hidrotermal-metasomatik, i formuar në shkëmbinj të ndrydhur tektonikisht, nga qarkullimi i tretësirave të pasura me nikel, bakër dhe elementë të tjerë jometalorë. Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie janë formuar amfibole, klorite, mineralet e serpentinës, të cilat janë ndërthurur me mineralet xehore të formuar pothuaj në një kohë me to.

2. Pentlanditi e kalkopiriti janë mineralet kryesore xehore të vendburimit të formuara në tre gjeneracione, por pa ndonjë ndërprerje të theksuar ndërmjet tyre. Këto mineralet e të tjerë që i bashkëshoqërojnë kanë një përhapje, tepër heterogjene, megjithatë krijojnë edhe grumbullime me përbajtje të larta duke formuar trupa me rëndësi industriale.

3. Pentlanditi formon kryesisht grumbullime me struktura kokrinozore e aggregate kokrrizore allotriomorfe që jo rallë në periferi ndërthurur me mineralet shkëmbformuese si amfibole, kloritet, me të cilët formon dhe struktura grafike.

4. Proceset pasmineralizuese kanë shkaktuar coptimin e mineraleve sulfure, por në ta kanë qarkulluar kryesisht tretësira të pakta të pasura me oksigjen e temperaturë relativisht të ulët, si rrjedhojë ka ndodhur një tjetërsim i lehtë i pjesshëm i mineraleve parësore dhe formimi i mineraleve me potencial të lartë oksidues si magnetiti.

### LITERATURA

1. Çina A. — Mineragrafia V. III.
2. Gjata K. 1980 — Petrologja dhe perspektiva e Ni-sulfur dhe sulfureve të tjera të kompleksit gabro-periodotit të Mirditës perëndimore. Disertacion.
3. Orova M. etj. 1985 — Raport mbi rezultatet e punimeve të kërkim-zbulimit të nikelit e bakrit sulfur në vendburimin e Lumthit.
4. Sinoimeri Z. etj. — Studime tematike përgjithësuese për sqarimin e përbajtjes së arit në zonat perspektive të rajoneve Librazhd-Mirditë-Lezhë-Pukë dhe për Ni-Cu-Pt në zonat perspektive të Matit e Librazhdit. Atlas strukturi i teksturi rudnik minerallov.
5. Minerali i paragjenezi minerallov hidrotermanih-mjestorozhdjenin.
6. Minerali i paragjenezi minerallov hidrotermanih-mjestorozhdjenii.
7. Betjektin A.G. — Strukturi i teksturi. Osobjenosti endogenih rud.
8. Isaenko M.P. — Opredelitel glavnjejshih minerallov rud votrazhenom svjetc.
9. Dushko — Zaharova — Geokimia i minerallogia Se-Te v mestorozhdjenia Cu-Ni.
10. Minerali i paragenezis minerallov rudnih mestorozhdjenia.
11. Osobjenosti strukturi hidrotermatnih rudnih mestorozhdjenii.
12. Randor P. — Rudnie minerali i ih srastania (Përkthim nga gjermanishtia).
13. Panaiu T Athanasion — Epi tu valeriti e petrias. Praktika tis Akademias Athinon Etos 1967: tomos 42.

Dorëzuar në redaksi në gusht 1990.

### Summary

**Features of mineral composition of Ni-Cu sulphur ores in lumthi deposit and their formation conditions**

The Ni-Cu sulphur mineralization of Lumthi ore deposit is of hydrothermal-type. It occurs in lherzolites transformed into serpentine-chlorite-amphibole rocks as the result of the circulation through them of the water solution rich in nickel, copper and other non-metallic elements. Pentlandite and chalcopyrite are the main ore minerals, formed mainly in three generations, but without any deep break among them.

The productive hydrothermal phase, is closed with the formation of magnetite due to the falling of temperature and the of oxidation potential.

The spreading of the main ore minerals is very heterogenous, even, conducting in formation of bodies with industrial values.

## HIDROGJEOKIMI

# PËRDORIMI I METODAVE HIDROKIMIKE, RADIOIZOTOPIKE E FLUORESHENTE NË STUDIMIN E LIDHJEVE HIDRAULIKE TË BURIMEVE KARSTIKE

— Nexhip Maska\* —

Artikulli nëpërmjet zbatimit të disa metodave komplekse trajton problemin e mundësisë së lidhjeve hidraulike të disa prej burimeve karstikë që ushqejnë ligenin e Shkodrës.

### H Y R J E

Nëpërmjet metodave të ndryshme e të pavarura, të paraqitura në këtë punim, kërkonet të hidhet dritë mbi disa nga veçoritë hidro-gjeologjike të një objekti karstik, me sipërfaqe rrëth  $1 \text{ km}^2$  siç janë: vërtetimi i lidhjeve hidraulike midis burimeve kryesore, shkalla e përzierjes së tyre nga infiltracionet sipërfaqësore, përcaktimi i shpejtësisë së vërtetë të rrjedhjes, etj. Si rezultat i studimit zgjidhet rryma më e pastër (Syri i Ragamit), më pak e kontaminuar nga «delta» e madhe e tërë rrjedhës.

#### 1. Rreth gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë së objektit

Burimet karstike të bregut të ligenit të Shkodrës në Ivánaj, i përkasin ekstremit më perëndimor të fushës së Bajzës. Ato kanë si zonë ushqimi pjesën jugperëndimore të Alpeve dhe përfaqësohen kryesisht nga gëlqerorë pllakorë të kretakut të poshtëm dhe jurasikut. Zhyten me një kënd rrëth 15 gradë në drejtim të perëndim-jugperëndimit dhe janë mjaft të karstëzuar. Çarjet dhe prishjet tektonike në këta shkëmbinj janë gjithashtu mjaft të zhvilluara.

\* N. Hidrogjeologjike në Tiranë.

Në fig. 1 janë treguar objekti i punës dhe pikat e burimeve kryesorë që i janë nënshtruar matjeve. Në sektorin përreth burimeve ndodhen mjaft hinka e gropë karstike; mjaft prej tyre kanë lidhje me rezervuarët në thellësi, por mjaft të tjera janë të taposura nga produktet e mbetjeve nga tjetërsimi. Përveç këtyre, gëlqerorët e objektit kanë çarje të fuqishme herë-herë vertikale me thellësi që shkon bili deri 10-12 m, të ngushta e me bimësi kacavjerrëse nëpër to, të cilat rrisin agresivitetin karstik më në thellësi të tyre.




Fig. 1 — Vendndodhja e burimeve kryesore të cilët i janë nënshtruar studimit.  
Location of the main studied sources.

## 2 — Hidrokimia dhe parametrat fiziko-kimikë

Burimet karstikë që diskutohen kanë natyrë të ngjashme, kështu që variacionet e treguesve hidrokimikë e izotopikë priten të mos kenë luhatje të mëdha.

Në fig. 2 kemi paraqitur variacionet e kationeve të ujrale të burimeve në funksion të distancës (largësisë së tyre), ndërsa në fig. 3 variacionet e anioneve.




Fig. 2 — Luhatjet e kationeve në burimet karstike që derdhën në ligenin e Shkodrës.  
The variations of cations in karst sources which flow into Shkodra Lake.


Këta grafikë janë ndërtuar nga vlerat e marra në Tab. 1, e cila jep në mënyrë të përbledhur vlerat e joneve kryesore të këtij «profil» burimesh. Nga grafikët bie në sy qartë, që vlerat më të ulëta të grupit  $\text{SO}_4^{2-}$  - dhe  $\text{HCO}_3^{-}$  i ka burimi i Syrit të Ragamit. E njëjtë gjë mund të thuhet për kationet  $\text{Fe}^{(2,3)+}$ ,  $\text{Ca}^{2+}$  si dhe të  $(\text{Na}+\text{K})^{+}$  për këtë burim.

Në fig. 4 kemi paraqitur variacionet e parametrave fiziko-kimikë. Edhe nga ky grup grafikësh vihet re se burimi i Syrit të Ragamit ka vlera minimale të parametrave të temperaturës, përgueshmërisë dhe mineralizimit total, ndërsa paraqet një ngritje të papërfillshme të pH-në krahasim me burimet e tjera. Prurjet e këtij burimi matur me metoda të thjeshta hidrogjeologjike janë afersisht  $2\text{m}^3 \cdot \text{s}^{-1}$ .

Tab. 1. Analizat kimike të burimeve të Ivanajt.



Tab. 1 Përbajtja e elementeve kryesorë në burimet e Ivanajt

BURIMI Nr	EMERTIM BURIMIT (Na+K)	KATIONET (mg·l⁻¹)			ANIONET (mg·l⁻¹)			pH	mg/l Mineral total	mg/l Mbetja total	
		Ca <sup>2+</sup>	Mg <sup>2+</sup>	Fe <sup>2+</sup>	HCO <sub>3</sub> <sup>-</sup>	Cl <sup>-</sup>	SO <sub>4</sub> <sup>2-</sup>				
1	Vija e Mullirit	12.65	41.26	5.36	0.66	157.38	5.32	16.04	7.60	238.67	148
2	Syri i Franit	9.43	39.30	4.76	0.57	145.18	7.10	9.87	7.85	216.21	158
3	Syri i Ragamit	10.35	38.31	4.76	0.28	142.74	8.86	8.22	7.80	213.53	130
4	Syri i Sheganit	13.57	38.31	4.76	0.28	145.96	8.87	14.39	7.60	224.14	146

Fig. 3 — Luhatjet e anioneve të burimeve.  
— Curves of anions of the sources.

Në fig. 5 — është treguar harta e izolinjave të përqueshmërisë elektrike të këtyre burimeve si dhe të disa daljeve të tjera ujore në lindje të tyre. Parametri i përqueshmërisë është një parametër kryesor dhe i qëndrueshëm. Ai është i varur drejtpërsëdrejti nga mineralizimi total (për të njëjtën ose gati të njëjtën temperaturë). Duket mjaft qartë se pikërisht burimet e Syrit të Franit dhe të Syrit të Ragamit krijojnë një «gropë» në topografinë e hartës së përqueshmërisë me vlerat minimale prej 75 dhe 73 (S. cm<sup>-1</sup>) respektivisht (zona e ravigjuar).

Kështu, nga analiza e parametrave fiziko-kimikë dhe variacionet e hidrokimisë së këtyre burimeve, rezulton se burimi i Syrit të Ragamit veçohet, ndonëse këto burime përbëjnë elementë të vegantë të rrjedhjes të një «delte» e cila i bashkon ata diku më larg në drejtim

Fig. 4 — Luhatjet e parametrave fiziko-kimikë të burimeve.  
— Curves of physic-chemical parameters of the sources.Fig. 5 — Harta e izolinjave të parametrëve përqueshmërisë të burimeve.  
— Map of isolines of source conductor parameters.

të lindjes. Meqenëse matjet e kryera tek motopompa (afërsisht 500 m nga burimet) dhe tek lijeni i Hurdhave (afërsisht 300 m nga burimet) tregonjë diferenca hidrokimike e fiziko-kimike, duhet thënë se vendi i bashkimit të «degëve të deltës» është jo më afër se 500-600 m me burimet. Hurdhat, siç u provua më pas, kanë lidhje hidraulike vetëm me burimin e Syrit të Sheganit.

### 3 — Tritiumi dhe jodi natyror.

Tritiumi ( $H^3$ ) është një izotop radioaktiv i hidrogjenit, beta rrezaues, me periudhë të gjysmë zberthimit 12,3 vjet. Ai është përdorur me shumë sukses në studimet hidrogeologjike, veçanërisht në ato që i përkasin viteve 1960-1980, pasi hynë lehtësish në ciklin e qarkullimit, nëpërmjet reshjeve. Tritiumi është prodhuar kryesisht nga shpërthimet e bombave bërthamore në atmosferë rrëth viteve 1950-1955. Më pas me konventa ndërkombëtare u ndaluan të tilla prova dhe si rezultat përqëndrimi i tritiumit në natyrë ka ardhur gjithmonë duke rënë. Shpërndarja e tij sot është mjaf e shrregullt. Burim i vazhdueshëm i tritiumit në ciklin hidrogeologjik është formimi i tij nga ndërveprimi i rrezatimit kozmik me azotin dhe oksigjenin në shtresat e sipërme të atmosferës. Meqenëse objekti ynë i punës është mjaf i vogël, infiltracionet do të jenë nga i njëjtë shi (që përban të njëtin koncentrim  $H^3$ ). Kjo përsa i përket reshjeve direkte mbi fushë, ndërsa infiltracionet më të largëta nuk do të kenë ndonjë peshë të madhe nga efektet regjionale, pasi barriera e maleve është mjaf pranë. Këshfu që çdo anomali e shfaqur në objekt do të ketë karakter konstitucional dhe mund të interpretohet. Mostrat e tritiumit u muarën me mjaf kujdes sipas metodikës ekzistuese. Me rezultatet e matjeve ndërtuan grafikun e paraqitur në fig. 6. Mostrat i kemi mbledhur në pranverë, pikërisht 2-3 ditë pas reshjeve të mëdha (20 prill), si dhe një herë tjetër në fund të verës (mes shtatorit 1990).




Fig. 6 — Grafiku i  $H^3$  në burimet e Ivanajt.  
— Graphic of  $H^3$  in Ivanaj sources.  
a — in spring; b — in the end of summer.

Duket që vlera më e ulët e përbajtjes së  $H^3$  i përket burimit të syrit të Ragamit. Meqenëse ky grafik i përket periudhës së reshjeve, del qartë përfundimi që burimi i Syrit të Ragamit ndikohet shumë më pak se burimet e tjerë nga shirat, ndërsa burimet e tjerë e kanë

kontributin e infiltrimeve nga shiu më të madh e si rrjedhojë edhe prurjen e tyre më të madhe. Lidhur me këtë, tipikë janë burimi i Syrit të Sheganit (rrëth  $10 \text{ m}^3 \text{ s}^{-1}$ ) dhe ai i Vijës së Mullirit (rrëth  $5 \text{ m}^3 \text{ s}^{-1}$ ).

Nga grafiku b i figurës 6 vihet re një qëndrueshmëri e  $H^3$ . Kjo tregon, se pasi janë shkaktuar sasitë më të mëdha të ujrate të përziera (me shirat) dhe meqenëse s'ka rënë më shi, koncentrimi i  $H^3$  në rezervuarët e nëndheshëm bie, pasi këto ujra «hollohen» nga ato që vijnë nga shkrirja e dëborës (e cila ka më pak  $H^3$ ).

Në këtë mënyrë hipoteza hidrogeologjike e mundësishë së diferençimit të këtyre burimeve prej njëri tjetrit vërtetohet dhe argumentohet plotësisht edhe me matjet radioizotopike të  $H^3$ .

Në fig. 7 kemi paraqitur përbajtjen e jodit natyror në ujrat e këtyre burimeve. Vitet e fundit herë-herë janë botuar artikuj të cilët trajtojnë mes të tjerash përdorimin e jodit natyror si indikator në hidrogeologji. Ujrat e rezervuarëve të paaktivizuar kanë gjithmonë një përbajtje më të lartë të jodit pasi ato kanë qëndruar për një kohe më të gjatë në kontakt me matriksin gëlqeror i cili nga ana e tij është shumë i pasur me jod të mbetjeve faunistike, bile përbajtja e jodit në më të shumtën e rasteve e kapërcen edhe nivelin e përbajtjes së tij në ujin e detit. Pra, në bazë të përbajtjes së jodit mund të diferencojmë lloje të ndryshme ujash si ato me shumë jod e shpejtësi të vogël ose qëndrimi në vend (rezervuar i pa aktivizuar) dhe ato me pak jod e shpejtësi të madhe (prurje e madhe).

Duket që burimi i Syrit të Ragamit (me përbajtjen më të lartë të jodit) është rezervuar i pa aktivizuar dhe pak i ndikuar nga reshjet të cilat, duke qënë se s'përbajnjë fare jod nuk e «hollojnë» ato.




Fig. 7 — Përbajtja e jodit natyror në burimet e Ivanajt.  
— The content of natural iodine in Ivanaj sources.


**4 — Vlerësimi i shpejtësisë së vërtetë, lidhjes hidraulike dhe konceptimi i modelit të rezervuarit nga gjurmuesit me ngjyrë.**

Për të vërtetuar plotësisht rezultatin nga interpretimi i analizave hidrokimike dhe atyre izotopike, përdorëm edhe metodën e gjurmuesve kolorimetrike. Mbi të gjitha, me anë të kësaj metode do të matej njëherësh edhe shpejtësia e vërtetë e rrjedhjes. Përdorimi i radioizotopave artificialë (si  $I^{131}$ ,  $Br^{82}$  etj.) mbështetet do të ishte më komod, por hoqëm dorë nga përdorimi i tyre për arësyen të ndotjes së mjedisit.

Për këtë qëllim përdorëm si ngjyrosës Rhodaminë B me peshë molekulare 479.02. Pa nevojën e matjeve instrumentale (vrojtimi me sy të lirë) ajo është e kapëshme në përqëndrime  $10 \text{ mgr.m}^{-3}$  e lartë (10 ppb). Përqëndrimet më të ulta mund të kafen mbas përqëndrimit paraprak me avullin. Rekomandohet që eksperimentet me Rhodaminë B të kryhen në një temperaturë jo më të madhe se  $30^\circ\text{C}$ , temperatura e ajrit gjatë eksperimentit tonë ishte  $19,6^\circ\text{C}$ , ndërsa ajo e ujërave në të cilat u hodh më pak se  $10^\circ\text{C}$ .

Eksperimentimi ashtu sikurse rekomandohet u krye 3 ditë pas reshjeve të fuqishme pas një dimri thuajse të thatë. Kjo bën të aktivizohen kanale e rezervuarë nëntokësorë të veçantë dhe të krijuhet rasti më i mundshëm që ata të bashkëveprojnë e komunikojnë. Duke llogaritur përafersisht volumin e ujit në rezervuarin nëntokësorë na u duk i mjaftueshëm përdorimi i 475 gr. lëndë. Nëse përqëndrimet do të ishin të pakapëshme do të pasuroheshin me avullim. Për t'i dallë përpresa çdo dështimi, hodhëm sasinë e lartëpërmendur në 500 lit. ujë të ndarë në dy porcione 250 lit. e para u hodhën në orën  $11^{45}$  (28.4.1990) dhe 250 lit. e tjetra 4 min. më pas ( $11^{49}$ ). Gjurma u hodh tek liqeni i Hurdhave. Vëndi i pritjes u organizua me vrojtues në çdo burim gjatë liqenit duke mbledhur prova uji (250 ml) çdo dy minuta. (në mënyrë që intervali midis dy heqjeve të mund të kapej). Nga eksperimenti rezultoi që koha e mbrritjes ishte ora  $12^{02}$  dhe ajo e arritjes së përqëndrimit maksimal ora  $12^{08}$ , ndërsa pastrimi u bë në orën  $12^{30}$ . Shfaqja e gjurmuesit u vu re vetëm tek Syri i Sheganit. Ky burim me gjithëse me prurjen më të madhe se të tjerët shfaqi ndotje të plotë të tij. Në të kundërt, burimet e tjerë me gjithëse me prurje mjaft më të vogël nuk patën asnjë shenjë ngjyre. Kjo u provua edhe me matje në laboratori.

Skematikisht, 2 hedhjet dhe kohën e mbrritjes i kemi paraqitur në fig. 8. Si kohë për llogaritjen e shfaqjes së gjurmës, zakonisht pranohet koha në të cilën gjurmuesi arrin 0.7 të vlerës së amplitudës maksimale të tij. Pra, intervali i kohës gjatë të cilët gjurmuesi qëndron në rezervuar është 15 min. Nga mesatarizimi i mjaft matjeve (me mënyra të thjeshta) i shpejtësisë së lëvizjes në hyrje dhe dalje të rezervuarit nëntokësor (respektivisht tek Hurdhat dhe Syri i Sheganit) rezulton se kjo shpejtësi është  $1.0 \pm 1.1 \text{ ms}^{-1}$ . Duke qenëse distanca mes pikës së hyrjes dhe asaj të daljes është rrëth 270 m, duhet që gjurma të shfaqej në dalje pas afro 5 minutash. Eksperimenti tregoi që kjo kohë është 3 herë më e madhe. Ne nuk mendojmë se



**Fig. 8 — Tabloja kohore e eksperimentit me Rhodaminë B.  
— View of the experiment with Rhodamine B during the Lime.**

kjo vonesë shkaktohet nga zgjatja e rrugës nëpër labirinte ose koridore të ngushta e të holla, pasi po të qe kështu, anomalia e F.E.N tek profili mbi këtë sektor do të ishte shumë e shprehur (p.sh. sikurse përftohet pak më në lindje të Syrit të Sheganit). Anomalia e fuqishme duhet interpretuar e lidhur me një koridor të ngushtë pranë sipërfaqes ose me një kaskadë nëntokësore ku ujrat kanë shpjetësi të madhe filtrimi, ndërsa vlerat e ulta të përftuara në profilin lindor (në mes të distancës hyrje-dalje) duhen parë të lidhura jo me mungesën e infiltrimeve, por me praninë e një rezervuari mjaft të madh, shpejtësia e lëvizjes së ujërave të të cilit është e vogël (fig. 9).

Duke i bashkëinterpretuar të dhënat e fituara me të gjitha metodat e përdorura mund të japim një ide mbi modelin e këtij rezervuari. (fig. 10).

## 5 — Përfundime

a — Studimi i fenomenit të karstit mund të bëhet më i plotë dhe më i lehtë duke përdorur një kompleks metodash, ku midis tyre një vend të posaçëm zenë gjurmuesit radioaktivë (ambientalë ose artificialë), ata kolorimetrikë si dhe hidrokimia.

b — Burimet e Ivanajt që derdhen në liqenin e Shkodrës nuk kanë lidhje midis tyre deri në një distancë të paktën 500-600 m nga bregu. Ata diferencohen nga vetitë e tyre fiziko-kimike, radioizotopike e hidrokimike.

c — Burimi i Syrit të Ragamit është i përshtatshëm nga ana hidjeno-sanitare (mineralizim e temperaturë më të ulët, ndotja nga reshjet e papërfillshme).




Fig. 9 — Prerje hipotetike Ligeni i Hurdhave-Syri i Sheganit.  
— Hypothesis section of Ligeni i Hurdhave-Syri i Sheganit.




Fig. 10 — Modeli i rezervuarit nëntokësor.  
— Model of underground reservoir.

d — Anomalitë e F.E.N. duhet të interpretohen vetëm të shoqëruara nga një kompleks metodash. Mungesa e tyre nuk do të thotë se një rezervuar ujëmbajtës nuk ekziston. Këtë e konfirmon mungesa e anomalisë mbi rezervuarin më të madh nëntokësor siç është ai midis Hurdhave dhe Syrit të Sheganit.

Në realizimin e këtij studimi kanë dhënë një ndihmë të qmuar sh. V. Kotro, Xh. Kumanova, G. Kallfa, Y. Xhakollari, M. Sinoimeri e K. Fishka, të cilët kryen analizat, standartiziminose ndihmuan në mblidhjen e provave.

#### LITERATURA

1. J.Ch. Fontes, G.S. Bartolami, G.M. Zuppi. 1978 — Isotope hydrology of the Mont Blanc massif» Isotope Hydrology, vol.1.
2. Schotterer et al. 1978 — Isotope study in the alpine karst region of Rawil, Switzerland» Isotope Hydrology, vol. 1.
3. G.S. Bartolami et al. 1978 — Isotope hydrology of the Val Corsaglia maritime alps Piedmont, Italy» Isotope Hydrology, vol. 1.
4. K. Przewołocki, Y. Yurtsever, 1974 «Some conceptual mathematical models and digital simulation aproach in the use of tree cers in hydrological systems». Isotope techniques in groundwater hydrology, vol. 2.
5. IAEA, «Nuclear techniques in grounfwater hydrology» Ground-water studies, Unesco, Paris 1972.
6. S. Mares et al 1974 «Geoelectrical methods» Introduction to Applied Geophysics, Prague,
7. J.Ch. Fontes, 1983 — «Groundwater in fractured rocks», Guidebook on Nuclear Techiques in Hydrology, Edition.

Dorëzuar në redaksi në shtator 1990

#### Summary

The usage of hydrochemical, radioisotopic and fluorescent methods in the study of hydraulic relations of karst sources

Based on the application of some complex methods the article treats the problem of possible hydraulic relations of some of karstic sources which flow into Shkodra Lake.

Ivanaj sources which flow into Shkodra Lake have no connections among them, at least up to a distace of 500-800 m.

They are distinguished by their physical-chemical, radioisotopic and hydrochemical properties.

Syri i Ragamit source is more suitable from the hygienic-sanitary point of view; the mineralization and temperature are low, the pollution by the precipitations is unconsiderable.

The anomalies of F.E.N. must be interpreted according to complex methods. Their absence does not mean that a water bearing reservoir doesn't exist. This is confirmed by the absence of the anomalies over the biggest underground reservoir as is that between Hurdhave and Syri i Sheganit.

**VLERËSIMI I VËLLIMIT TË UJIT TË LARGUAR GJATE  
KOMPAKTËSIMIT ME ANËN E METODAVE  
GJEOFIZIKE TË PUSEVE NË PRERJEN E  
PLIOCENIT TË RAJONIT DIVJAKË-BALLAJ**

Rushan Liço\*

Jepet metoda e llogaritjeve të vëllimit të ujit të larguar dhe të trashësisë fillestare të argjilave, për të gjykuar përmundësinë grumbullimit të hidrokarbureve.

HYRJE

Për restaurimin dhe gjetjen e saktë të trashësive argjilore në kohën e formimit të tyre është e nevojshme të kryhet një bilanc mbi bazën e asaj që përcaktohet sot.

Hidrokarburet që janë formuar në stendet e hershme të pasdeponitimit të materialit parësor do të lëvizin bashkë me ujin si një rrymë fluidi e shkaktuar nga kompaktësimi. Prandaj në kërkimin e naftës e të gazit është me shumë rëndësi të dihet jo vetëm drejtimi nga ka ardhur ky fluid por edhe sasia e tij. Shpesh edhe kur në prerje zbulohen trashësitë ranore, mbetet e dyshimtë gjetja e grumbullimeve të hidrokarbureve në sasi industriale nga që burimet nga furnizohen këtia ranorë mund të mos kenë lëndë të parë për ti ushqyer deri në sasitë industriale. Për zgjidhjen e një detyre të tillë u studiuva prerja ranore-argjilore e pliocenit të rajonit Ballaj dhe u bënën llogaritjet e sasisë së ujit që është larguar nga trashësia argjilore. Për këtë qëllim në mënyrë metodike u përdor kompleksi i matjeve gjeofizikë të puseve. Këtu po paraqesim vetëm metodën e llogaritjes së vëllimit të ujit të larguar dhe restaurimin e trashësisë fillestare të argjilave.

### Metoda e llogaritjes

Për llogaritjen e vëllimit të ujit të larguar vetëm nga kompakte simi u shqyrtua trashësia argjilore në thellësitet 750-1000 m të Ba-77. Thellësia 750 m është thellësia e bllokimit ose pengesa hidraulike e cila pengon ngjitjen e mësipërme të fluidit.

Për të llogaritur vëllimin e ujit që ka dalë nga kompaktësimi nga momenti i sedimentimit e deri tanë, është e nevojshme të dihet trashësia origjinale e argjilave. Meqenëse gjatë kompaktësimit ndryshon poroziteti, ndërsa përbajtja sasiore e kokrrizave mbetet e njëjtë, pështresën me trashësi h mund të shkruajmë:

$$h(1 - \bar{K}_p) = h_0(1 - K_{po}) \quad (1)$$

ku  $h_0$  dhe  $h$  janë trashësitet para dhe pas kompaktësimit, kurse  $\bar{K}_p$  dhe  $K_{po}$  janë porozitetet mesatare respektive.

Meqenëse porozitetin  $K_{po}$  e përcaktojmë nga drejtëza e trendit normal të kompaktësimit, duke e zgjatur atë deri në sipërfaqe (1) atëherë nga barazimi (1) llogaritet trashësia e sedimenteve  $h_0$  në kohën e sedimentimit, ndërsa kjo vlerësohet me njëren nga metodat e njohura gjeofizike të porozitetit.

Në sedimentologji është më e përshtatshme të përdoret si masë krahasuese për gjendjen e kompaktësimit përbajtja vëllimore e boshllëqeve. Prandaj u vendosën lidhjet midis matjeve gjeofizike dhe raportit të kokrrizave e boshllëqeve. Dihet gjithashtu që vëllimi total i shkëmbit është i barabartë me:

$$V_t = V_k + V_p \quad (2)$$

ku  $V_k$  dhe  $V_p$  — janë vëllimet e kokrrizave dhe të poreve. Atëherë mund të llogaritim raportin e kokrrizave:

$$K = \frac{V_k}{V_t} = \frac{V_t - V_p}{V_t} = 1 - K_p \quad (3)$$

Po kështu mund të shkruajmë raportin e boshllëqeve  $B$ :

$$B = \frac{V_p}{V_k} = \frac{V_p}{V_t} \cdot \frac{V_t}{V_t - V_p} = \frac{K_p}{1 - K_p} \quad (4)$$

Duke bërë kombinimin e barazimeve të mësipërme raporti i kokrrizave mund të shkruhet në formën:

$$K = \frac{1}{1 + B} \quad (5)$$

ndërsa ai i boshllëqeve

$$B = \frac{1 - K}{K} \quad (6)$$

$$K_p = 1 - K \quad (7)$$

dhe

Meqenëse poroziteti  $K_p$  lidhet me një varësi drejtvizore me kohën  $\Delta t$  që matet në pus, ose që fitohet nga vrojtime sizmike, atëherë, duke zëvendësuar në barazimin (3) dhe (4) vlerën e  $K_p$  në funksion të  $\Delta t$  gjejmë:

$$K = 1 - K_p = \frac{\Delta t_f - \Delta t}{\Delta t_f - \Delta t_m} \quad (8)$$

$$B = \frac{K_p}{1 - K_p} = \frac{\Delta t - \Delta t_m}{\Delta t_f - \Delta t} \quad (9)$$

dhe

$$\Delta t_f = 610 - 650 \mu\text{s}/\text{m}$$

$$\Delta t_m = 160 - 180 \mu\text{s}/\text{m}$$

Me anën e barazimit (8) dhe (9) u ndërtua varësia e fig. 1 dhe fig. 2, të cilat përfaqësojnë dhe dy nomograma të përdorimit praktik. Për ndërtimin e varësise, vlera e kohës së ecjes së valës në matriks u pranua vlera mesatare  $\Delta t_m = 170 \mu\text{s}/\text{m}$  dhe koha e ecjes së valës në fluid,  $\Delta t = 620$  dhe  $650 \mu\text{s}/\text{m}$ .




Fig. 1 — Varësia e raportit të kokrrizave nga  $\Delta t$ .  
— The dependence of the grains ratio on  $\Delta t$ .

Vlerësimi i  $\Delta t$  për intervalin e studuar u bë me një përafrim të naqshëm duke marrë të mesmen e ponderuar.

Në qoftëse pranojmë se një kub njësi ka një vëllim kokrrizash  $V_k = 0.2$ , pra  $\frac{V_k}{1} = 0.2 = K_o$ , atëherë raporti i boshillëqeve B nga barazimi (6) është i barabartë me 4.

Gjatë kompaktësimit të këtij shkëmbi, ndërsa raporti i boshillëqeve është zvogëluar, vëllimi i kokrrizave ka mbetur i pa ndryshuar. Duke lexuar vlerën  $\Delta t_m$  në intervalin 750 — 1000 të barabartë me  $290 \mu s/m$ , dhe duke e vendosur në monogramën (2) gjatë  $B = 0.33$ , atëherë raporti i kokrrizave midis këtyre dy etapave  $K/K_o$  është rritur (nga barazimet (5) dhe (6)) në 3.85 herë.

Vëllimi i ujit ( $V_u$ ) të nxjerrë gjatë kompaktësimit midis stadir filletar dhe përfundimtar është i barabartë me ndryshimet e porozitetit  $K_p$  pra:

$$V_u = \bar{K}_p - \bar{K}_p = \Delta \bar{K}_p = \frac{B_0}{1 + B_0} - \frac{B}{1 + B} \rightarrow 0.55 m^3$$

ose me anën e  $K_o$  dhe  $K$

$$V_u = (1 - K_o) - (1 - K) = 0.56 m^3$$

$K$  — u llogarit me nomogramën (1) dhe  $B$  me nomogramën (2)




Fig. 2 — Varësia e rapportit të boshillëqeve nga  $\Delta t$   
— The dependence of the empties ratio on  $\Delta t$




Fig. 3 — Varësia e rapportit të boshillëqeve nga F  
— The dependence of the empties ratio F

Meqenëse puset e vjetër madje dhe puse të rinj përmbyjnë vetëm matjet standarde të rezistencës dhe nuk kanë matje akustike dhe me qëllim që të rritet informacioni dhe të shtohet siguria në llogaritjen e ujit që largohej gjatë kompaktësimit, u studiuat edhe lidhja midis rapportit të kokrrizave  $K$  dhe rapportit të boshillëqeve me metodën e rezistencës.

Lidhja midis parametrave realizohet me anën e barazimit të njohur:

$$F_A = \frac{\delta_A}{\delta_u} = \frac{1}{K_p^m} \quad (10)$$

Duke zëvendësuar në këtë formulë vlerën e  $K_p$  me të barabartën saj që jepet nga barazimet (5), (6), dhe (7) gjendet lidhja:

$$F_A = \left( \frac{1+B}{B} \right)^m \quad (11)$$

Me anën e këtij barazimi u ndërtua varësia e fig. 3, e cila gjithashtu paraqet një nomogramë për llogaritjen e B. Nomograma është ndërtuar për dy vlera të fuqisë  $m = 2$  dhe  $1.8$ . Meqenëse trashësia e depozitimeve të pliocenit dhe tortonianit është e madhe, lindi nevoja e vlerësimi të faktorit të çimentimit  $m$ . Nga studimi i varësisë së  $m$ , në funksion të thellësisë që u bë në rajonin e Durrësit, që është një rajon fjinjë dhe me prerje analoge, u pa se kjo madhësi në intervalin  $1000$ - $3000$  m ndryshon nga  $1.4$  deri në  $1.8$ .

Për llogaritjen e B me anën e faktorit të formacionit u shfrytëzuan matjet me metodën induktive, e cila jep saktësi të mirë në përcaktimin e rezistencës së argjilave, për shkak të rrezes së madhe të studimit që ka metoda, dhe ndikimit të vogël të pusit. Me qëllim që  $F_A$  të llogaritet edhe me sonda të thjeshta (gradient) me potencial sonda, u ndërtua varësia e  $\rho_d/\rho_o = f(\rho_s/\rho_o)$  për  $\rho_{sh}/\rho_o = 1; 2; 3; 4; 5; 7$  dhe  $10$  për diametra pusi që ndryshojnë nga  $10$  deri  $40$  cm (fig. 4).

Rezistenca specifike e ujit në argjila u vlerësua me metodën e PS, duke supozuar që kripshmëria në shtresat ranore është e njëjtë me të argjilave. Në rastin kur ka të dhëna mbi kripshmëritë, problemi ka zgjidhje edhe më të thjeshta. Zbatimi praktik i kësaj metode u bë në disa puse të rajonit Divjakë, Ballaj dhe Durrës. Prerja e pliocenit që përmban disa shtresa gazi karakterizohet nga trashësi argjilore dhe ranore me madhësi nga  $1.2$  deri në disa dhjetra metra.

Në bazë të varësisë  $\Delta t = f(H)$  të ndërtuar në disa puse, në pjesën e sipërme vërehet kompaktësimi normal i argjilave, por edhe zona me presione mbi normale. Në fig. 8 jepet lakuja e  $\rho_d$  dhe PS të regjistruar në dy puse dhe bashkëlidhja midis tyre.

Për lehtësimin e llogaritjes së vëllimit të ujit të larguar gjatë kompaktësimit u ndërtuan edhe dy nomograma të tjera me anën e barazimeve të dhëna më sipër. Varësia e fig. 5 lejon përcaktimin fillestar të argjilës në bazë të raporteve të boshllëqeve të tanishme  $B$  dhe fillestare  $Bo$ .

Në diagramat e shfrytëzuara nga ne, në pjesën e miocenit të sipërmbë për  $Bo = 4$ ,  $\rho_A = 2.5 \Omega \text{ m}$ ;  $\rho_u = 0.1 \Omega \text{ m}$ ;  $m = 2$  dhe  $K_o = 0.2$  u gjet  $B = 0.25$ .

Vëllimi fillestar që kanë patur argjilat tregohet në drejtëzën e nomogramës me vlerë  $4$ , që do të thotë se vëllimi fillestar prej  $4 \text{ m}^3$  është zvogëluar në  $1 \text{ m}^3$ . Nga ku uji i nxjerrë nga kompaktësimi është  $Vo - V = 4 - 1 = 3 \text{ m}^3$ .

Nomograma e dytë (fig. 6) gjithashtu lejon përcaktimin e vëllimit të ujit nga argjilat duke përdorur madhësitë  $K$  dhe  $K_o$ .

Duke marrë  $B = 0.25$  dhe  $Bo = 4$  me anën e barazimit (5) gjejë  $K = 0.8$  dhe  $K_o = 0.2$ , nga ku me nomogramën (6) gjejmë  $Vo = 4$ . Në pjesën e prerjes ku  $F = 6$  ( $K_p = 0.25$ ) dhe  $B = 0.33$ ,  $Vo = 3.75 \text{ m}^3$  dhe vëllimi i ujit të nxjerrë gjatë kompaktësimit në pjesën e poshtme të pliocenit është:

$$V_o - V = 0.75 - 1 = 2.75 \text{ m}^3$$




Fig. 4 — Nomograma e llogaritjes së rezistencës së shtresës.  
Calculation nomogram of the layer resistance.

Meqenëse zakonisht vlerësohen trashësitat e tanishme të shtresave,  $h$ , atëherë mund të vlerësojmë trashësinë në kohën e depozitimit  $h_0$ .

Me ndihmën e barazimit (1), (3) dhe (5) mund të shkrumjë këto barazime për llogaritjen e vëllimit dhe trashësinë fillestare të argjilave

$$V_o = \frac{1 - Bo}{1 - V} \quad (12)$$

$$\text{dhe} \quad h_0 = \frac{1 - Bo}{1 + B} h \quad (13)$$




Fig. 5 — Nomograma e llogaritjes së  $h_o$  (Vo) me anën e  $B$ .  
Calculation nomogramme of  $h_o$  (vo) by means of  $B$ .

Konceptin e përaqitur më sipër mund ta shtrijmë edhe për vlerësimin relativ të ikjes së ujit nga një pikë thellësie në tjëtrin madje dhe të moshave të ndryshme. Humbja e fluidit për çdo  $m^3$  sedimente midis dy pikave të marra në tortonian dhe në argjilat e pliocenit të poshtëm është:

$$V_t - V_{pl} = 3 - 2.75 = 0.25 \text{ m}^3.$$

Kjo humbje fluidi i korespondon ndryshimet të porozitetit në mësinë 0.05.

Meqenëse rikonstruksioni i formacioneve shkëmbore është i ndërlikuar për shkak të gjendjes heterogjene të tyre u kalua në një formë më të thjeshtë llogaritjeje të vëllimit të ujit që largohet nga kompaktësimi. Për këtë qëllim barazimin (1) mund të paraqitet edhe në funksion të vëllimeve shkëmbore në formën:

$$V_o (1 - \bar{K}_{po}) = V (1 - \bar{K}_p)$$




Fig. 6 — Nomograma e llogaritjes së  $h_o$  (Vo me anën e K).  
Calculation nomogramme of  $h_o$  (vo) by means of  $K$ .

ku  $V_o$  dhe  $V$  janë vëllimet e argjilave dhe argjiliteve para dhe pas zhytjes. Në fillim u llogariten porozitetet pas zhytjes, gjatë gjithë trashësisë që u studiuia. Pasi u ndërtua trendi normal i porozitetit, u përcaktua poroziteti mesatar  $K_p$  poshtë barierës hidraulike, përparrë uljes. Meqenëse poroziteti mesatar poshtë barierës, pas uljes, është i njojur sepse janë kryer matjet gjeofizike ( $K_p$ ), po kështu është e njojur edhe trashësia ( $h$  ose  $V$ ), atëherë llogaritet vëllimi i argjilave dhe trashësia e tyre para zhytjes  $V_o$  dhe  $h_o$ :

$$V_o = V \frac{1 - \bar{K}_p}{1 - \bar{K}_{po}} \quad (14)$$

$$h_o = h \frac{1 - \bar{K}_p}{1 - \bar{K}_{po}}$$

Pasqyra 1

Pusi	Blloku	Poroziteti mesatar		$\bar{K}_{po} - K_p$	$\frac{1 - \bar{K}_p}{1 - K_{po}}$	Trashegio e orgjilave		Vëllimi fluidit të larguar $m^3$
		Par.Zhyt	Fas.Zhyt			Par.Zhyt	Fas.Zhyt	
B-1	A	0.26	0.22	0.04	1.054	55.86	53	2.23
	B	0.25	0.21	0.04	1.050	46.2	44	1.85
	C	0.28	0.24	0.04	1.060	65.72	62	2.62

Pasqyra 2

Pusi	Blloku	Poroziteti mesatar		$\bar{K}_{po} - K_p$	$\frac{1 - \bar{K}_p}{1 - K_{po}}$	Vëllimi i orgjilave		Vëllimi i përgjithshëm i fluidit të larguar $V_t$
		Par.Zhyt	Fas.Zhyt			Par.Zhyt	Fas.Zhyt	
B-1	A	0.26	0.22	0.04	1.054			
	B	0.25	0.21	0.04	1.050			
	C	0.28	0.24	0.04	1.060			




Fig. 7 — Ilustrim për llogaritjen e vëllimit të ujit të larguar nga kompaktësimi.

Nga ku u llogarit vëllimi i fluidit të kompaktësimit nga zona me presion mbinormal e poshtë:

$$U = \Delta \bar{K}_p \cdot V = (\bar{K}_{po} - \bar{K}_p) \cdot V \cdot \frac{1 - \bar{K}_p}{1 - \bar{K}_{po}} \quad (15)$$

Njëloj u veprua edhe për zonat me presion mbinormal e lartë. Për aplikimin e kësaj metode prerja u nda në bllqe me tregues të afërt fizik ( $\Delta t$ ,  $\phi$  etj.).

Rezultatet e llogaritjeve jepen në pasqyrat 1 dhe 2. (faqe 116)




Fig. 8 — Diagrama të përdhene PS në pusin N-77.

## P E R F U N D I M E

1. Metodika e propozuar mund tē shfrytëzohet jo vetëm pēr studimin e kompaktësimit tē argjilave dhe vlerësimin sasior tē tyre, por edhe pēr nxjerrjen e ujut qē shoqëron këtë proces.
2. Kjo metodë qē pērbën një drejtim tē ri tē zbatimit tē gjeofizikës krijon mundësi pēr resta urimin e trashësive tē depozitimit.
3. Metodika mund tē aplikohet në kushtet kur me matjet e kryera është bërë veçimi i argjilave nga alevrolitet dhe kolektorët.
4. Saktësia e metodës varet nga saktësia e leximit tē vlerave dhe mesatarizimi i tyre pēr trashësi tē veçanta.

## L I T E R A T U R A

1. R. Liço, N. Zendeli etj. 1987 — Disa zbatime tē reja tē gjeofizikës së puseve pēr vlerësimin sedimentologjik tē prerjeve dhe tē migrim-akumulimit tē gazit.
2. K. Magara 1978 — Compaction and fluid migration.
3. W.H. Fertl 1980 — Abnormal formation pressure.
4. O. Serra 1985 — Diagraphies differes.
5. V. Negita 1980 — Determinarea zonelor cupresiuni anormalesia densi tatii optime a norolului de fosaj cu ajutorul diagrafillor D.R.R. Min. Petrol si gaze Nr. 3.

## S u m m a r y

In this paper the results of a study on the compaction of the debris rocks are given. This paper treats shortly the estimation method of the water volume extraction from sediment's compaction by means of geophysical works etc.

The study presents interest for the extending of those estimations in oil and gas research.

Dorëzuar në redaksi në tetor 1988

## P E R ZBATIMIN E METODAVE ELEKTROMAGNETIKE TË FREKUENCAVE TË LARTA NË VENDBURIMIN E KRIPEZ DHROVJAN.

Kristaq Naska\*, Spiro Laska\*\*

Paraqiten rezultatet e punimeve elektromagnetike tē frekuencave tē larta pēr saktësimin e thherzave argjilogipsore brenda trupit kripor. Bëhet ballafaqimi i tyre me tē dhënat gjeologjike. Tē dhënat elektromagnetike ndihmojnë pēr gjeometrizimin më tē mirë tē thherzave argjilogipsore dhe pēr orientimin më drejt tē punimeve tē paraecjes dhe tē dhomave tē shfrytëzimit.

## H Y R J E

Metodat elektromagnetike tē radiovaleve nē minierën e kripës nē Dhrovjan, u pērdorën qysh nē vitin 1975, duke pērdorur punimet e shpimit dhe kishin pēr qëllim tē përcaktonin një zonë tē thatë tē kontaktit kripë-argjilogipse, ku do tē orientoheshin punimet e hapjes tē minierës së ardshme. Bashkërendimi i këtyre metodave me ato gjeologjike e hidrogeologjike bënë qē t'i arrihej qëllimit dhe punimet e hapjes pēr minierën e re u kryen nē kushte normale.

Pēr ecurinë e punimeve paraecjes pēr garantimin e rezervave tē përgatitura pēr shfrytëzimin nē minierën e kripës së gurit nē Dhrovjan del e nevojshme kontrollimi i zonave ndërmjetëse si pēr gjetjen e prezencës së shëllirave, ashtu dhe tē thherzave argjilogipsore. Ndërtimi gjeologjik i trupit kripor, sistemi i shfrytëzimit me dhoma e kolona si dhe mënyra e vendosjes së punimeve tē parashpénies pēr përgatitjen me rezerva, krijojnë mundësira pēr zbatimin me lehtësi tē metodave elektromagnetike. Nëpërmjet interpretimit tē anomalive tē marra dhe krasasimit me tē dhënat gjeologjike, del nē pah efikasiteti i kësaj metode nē veçimin e thherzave argjilo-gipsore, e cila çon nē kursimin e punimeve tē parashpénies qē hapen pēr qëllime kërkimi, si dhe orienton më drejt shfrytëzimin nē dhomat e prodhimit.

\* N. Gjeofizike nē Tirana

\*\* N. M. e kripës nē Sarandë.

### 1. Ndërtimi gjeologjik i trupit kripor dhe parametrat elektromagnetike të ambientit.

Suita halogjene kripëbartëse përfaqëson një diapir me gjatësi të madhe, e cila kontakton në perëndim me depozitim flishore të paleogenit dhe në lindje me depozitim karbonato-silicore të jurasikut, duke formuar një shtratim të valëzuar sipas shtrirjes dhe rënies, me fryerje e ngushtime në planin horizontal dhe në atë vertikal. Ashtu si vetë suita halogjene edhe trupi kripor ka formën e tre shtresothjerzave që pasojnë njëra tjetrën me drejtim juglindje-veriperëndim.

Suita halogjene e shtresothjerzës veriperëndimore, ku shtrihet miniera ekzistuese dhe u kryen punimet elektromagnetike, paraqitet kudo me ndërtim dy pakosh, ajo e shtratimit kripor dhe pakua e sipërme, argjilogipsore e cila bie nga prerja dhe shfaqet vetëm në pjesë të veçanta në formë gjurmësh, cipash me trashësi nga disa centrimetra deri në metrat e para, duke bërë që trupi kripor të kontaktojë direkt me depozitim flishore.

Trupi kripor ka trashësi 150-200 m në qendër, e cila vjen duke u ngushtuar deri më 20 m në drejtim jugor. Në drejtimin verior trupi pëson një zhytje, duke ruajtur pak a shumë trashësinë e tij. Shtrirja e përgjithëshme është 316-320°, kurse këndi i rënies të dyshemesë është 35-50° verilindje, ai i tavanit është horizontal në kokën e trupit, e cila vjen duke u rritur në drejtim të thellësisë në 10°, 15° deri 30-35°.

Brenda trupit kripor takohen thjerza argjilogipsore të madhësive nga metrat e para deri në 70-100 m në gjatësi dhe nga disa dhjetra centimetra deri në 20-30 m në trashësi, të cilat ruajnë në përgjithësi shtrirjen dhe rënien e vetë trupit kripor. Këto thjerza përbëhen kryesisht nga argjila me ngjyrë të kaltërt e të kuqëremtë e më pak nga gipsa, anhidrite, karbonate etj.


Vlera e rezistencës elektrike specifike e këtyre argjilave është  $\div 10^2$  om.m. Ky diapazon i ndryshimit të rezistencës ndërmjet trupit kripor dhe argjilave bën që edhe koeficienti i përthithjes të jetë i diferençuar: për kripën kap vlerat  $\div 0,006$  nep/m dhe për argjilat e thjerzës  $\div 0,4$  nep/m. Koeficienti përthithjes është parametër bazë dhe tregon, se sa dobësohet vala elektromagnetike në njësinë e diferençës. Duke qenë se rezistenca e ambientit të thjerzave argjilo-gipsore (3) është shumë më e vogël se e trupit kripor kjo bën që të veçohet me lehtësi në fushën e mg. Në rast se argjilat do të ishin të ngopura me ujë (gjë që deri më sot nuk është vërtetuar) kjo do të shkaktonte një përthithje (8) më të fuqishme të valëve emg, gjë që do të rriste më tej kontrastin e radiohapjes.

Parametër tjetër që është marrë parasysh është dhe koeficienti i ekranizimit, që përfaqëson raportin e intensitetit të fushës emg, të vrojtuar me intensitetin e fushës emg. normal. Sa më e ulët të jetë rezistenca e argjilave në krahasim me mineralin e kripës, aq më i madh është ky koeficient.

Konstantja dielektrike nga matjet e bëra ndryshon në kufij jo-shumë të gjërë.

### 2. — Metodika e punës dhe analiza e rezultateve.

Sistemi i shfrytëzimit, që përdoret është ai me dhoma e kolona sipas horizonteve të shfrytëzimit, të cilat vendosen mbi njera tjetrën. Horizontet e shfrytëzimit përshkohen në shtrirje me galeri, prej kunes traverbangjet që e presin kryq trupin mineral qdo 100 m. Nga traverbangjet nisin transversat, të cilat shërbejnë si pikë fillese e dhomave të shfrytëzimit (fig. 1). Kjo mënyrë hapjeje dhe shfrytëzimi të trupit kripor i jep përparsi metodave emg. në saktësimin e thjerzave argjilogipsore ndërmjet traverbangjeve, pa filluar shfrytëzimi në dhomat e prodhimit. Këto studime mund të kryhen edhe për zonat ndërmjet dy dhomave (fig. 2), kur kërkohet detalizim në pjesë të veçanta.



PRERJE TERTHORE E VENDBURIMIT





Fig. 1. Planimetria e nivelit të shfrytëzimit.

1 — Traverbank; 2 — galeri; 3 — traversë; 4 — dhomë e shfrytëzuar; 5 — celik kripor për ruajtjen nga ujrat e kontaktit; 6 — thjerza argjilogipsore.

— Planimetry of exploited level.

1 — Tunnel; 2 — Gallery; 3 — Traverse; 4 — Exploited room; 5 — Salty cupola for protection from contact waters; 6 — Clay gypsum lenses.



**Fig. 2. Konturimi i argjilogipseve me metodën e radiovalëve.**  
 1. Grafiku i fushës elektrike të vrojtuar F-6 Mc; 2. lakorja e koeficientit të ekranizimit; 3. lakorja e peshës normale.  
 — Contouration clay, gypsum by radioowaves method  
 1 — Graphic of the observed electric field F-6 Mc; 2 — Curve of the coefficient; 3 — Curve of normal meight.

Largësia ndërmjet traverngjeve është 100 m, kështu që dhe largësia ndërmjet dhënësit e marrësit për rastin më të keq, nuk i kalon të 130 m. Për raste të veçanta kur kërkohet detalizim këto përmasa zvogëlohen. Për kryerjen e punimeve me metodën e ndriçimit me zvogëlohen. Për kryerjen e punimeve me metodën e ndriçimit me radiovalë u përdor aparati i përbërë nga pulti i dhënësit, i cili nëpër-

mjet ushqyesit, gjeneratorit dhe antenës pikësore vertikale gjeneron frekuencat 1 Mc., 3 Mc dhe 6 Mc. Aparati marrës është i përbërë nga antena rrëthore, e drejtuar, ku induktohen valët emg. si dhe nga amplifikatori me miliamperimetrin për leximin e vlerave të fushës emg. Gjatë procesit të matjes dhënësi është i palëvizshëm, kurse marrësi ka lëvizur në largësi çdo 2,5-5 m.

Gjatë interpretimit të materialit grafik të përfthuar, rëndësi i kemi kushtuar përcaktimit të tre parametrave  $\rho$ ;  $\beta$ ;  $\epsilon$ , në bazën e të cilave është përcaktuar fusha normale për linjë vrojtimi dhe frekuencë. Për përcaktimin e fushës normale ( $H_T$ ) është përdorur formula:

$$H_T = H_0 \frac{e^{-\beta r}}{r} f(\theta)$$

Ku,  $H_0$  — energjia fillestare e rezatimit.

$r$  — distanca dhënës-marrës.

$f(\theta)$  — këndi i drejtimit të antenës marrëse

Duke bërë raportin e energjisë së fushës normale me atë të fushës së vrojtuar, kemi ndërtuar lakoret e ekranizimit, të cilat janë shuangje në rapport me fushën normale. (Fusha normale është ajo e ambientit të kripës, pa prani të argjilogipseve). Nëpërmjet veçimit të sektorëve anormal, të përfthuar nëpërmjet disa stacioneve të dhënësit, me metodikën e kryqëzimit të vijave u arrit të lokalizoheshin pozicionet hapsinore të thherzave argjilogipsore. Në fig. 2. nëpërmjet disa stacioneve të dhënësit (me frekuencë 3 Mc e 6 Mc) dhe vlerave të vrojtuar u ndërtua lakorja e intensitetit të fushës emg, si dhe nëpërmjet parametrave të njohur lakorja e fushës normale. Raporti i këtyre lakoreve na dha atë të ekranizimit. Prania e argjilogipseve shkaktoi një përrthithje të fuqishëm të valëve emg. deri në shuarje të plotë të sinjalit. Kjo shkaktohet nga pozicioni hapsinor i argjilogipseve në rapport me linjën bashkuese dhënës-marrës. Në këtë rast vija që bashkon pozicionin e dhënësit (pikdhënia 1) me pozicionin e marrësit kalon nëpër trashësi më të madhe të thherzës argjilo-gipsore dhe njëkohësisht linja e vrojtuar pret këtë thherëz.

Në fig. 3 shihet se studimi u krye në 2 pika dhënieje me frekuencë 3 Mc e 6 Mc. Nëpërmjet vlerave të matura dhe të llogaritura u përfthuan lakoret e intensitetit të fushës emg, të asaj normale dhe të koeficientit të ekranizimit. Lakorja e fushës së vrojtuar nga ajo normale, shmanget, por jo me atë intesitet si të rastit të mësipër. Anomalia e përfthuar nga stacioni (PK1) është e gjérë, pasi thherza argjilogipsore është shumë pranë saj. Me stacionet e tjera nuk vërehet ky fenomen.

Për rritjen e saktësisë të interpretimit në drejtim të përcaktimit të trashësisë dhe largësisë së thherzave argjilogipsore u ndërtua grafiku i varësisë së trashësisë nga intesiteti i fushës emg. të vrojtuar për distancë të ndryshme dhënës-marrës. Llogaritja intesitetit fillestar që rreztaton dhënësi është bërë për ambient kripe.




Fig. 3. Konturimi i zonave argjilogipseore me metodën e radiovalëve F-3-Mc, F-6Mc (shkalla 1:500).

- F-3-Mc, F-6 Mc (scale 1:500).  
 1. Grafiku i fushës normale; 2. Grafiku i fushës së vrojtuar;  
 3. Grafiku konstantes dielektrike.  
 — Contermination of clay gypsum zones by radiowaves method.  
 F-3 Mc; F-6 Mc (scale 1:500).  
 1 — Graphic of normal field; 2 — graphic of the observed  
 field; 3 — Graphic of dielectric constant.

## PERFUNDIME

1. Metodat elektrike janë mjaft efikase për veçimin e thjerezave argjillogipse brenda trupit kripor.
  2. Vlerat më të ulta të intensitetit të fushës emg., të vrojtuar me teknikën e frekuencave të larta, përftohen si rezultat i ekzistencës së kontrastit të rezistencave ndërmjet trupit të kripës dhe argjilogipseve.
  3. Distanca e studimit arrin deri në 150 m, gjë e cila është e mjaftueshme për studimin e hapësirave midis traverbaneve të të njëjtë nivel.
  4. Diapazoni i frekuencave të përdorura është i mjaftueshëm për lokalizimin e argjilogipseve në trupin kripor.
  5. Kombinimi i metodave elektromagnetike me të dhënat gjeologjike, çon në kursimin e punimeve të kërkimit dhe orientimin e drejt të punimeve të prodhimit.

## LITERATURA

1. Laska S. Qirjaqi V., 1979. — Relacion për disa ndryshime të profileve gjeologjike në raportin e vendburimit të kripës në Dhrovjan. Dhrovjan 1989.
  2. Naska K., Gjeverku Dh., 1985. — Relacion i punimeve elektromagnetike të frekuencave të ulëta dhe të larta për përcaktimin e zonave argjilore ujëmbajtëse të vendburimit të kripës Dhrovjan. Tiranë 1985.
  3. Papuç A., Korini L. 1978. Raport gjeologjik për vendburin qen e kripërave Dhrovjan Gjirokastër.
  4. Papuç A., Tafilaj I. Prenga Ll., Ballta R., 1975. — Raport mbi punimet suplementare gjeologo-hidrogjeologjike për studimin e kripave të Dhrovjanit. Tiranë.
  5. Ballta R. 1981. — Përdorimi i radiovalëve në përcaktimin e zonave të thata nga shëllirat në vendburimet e kripës së gurit. Përbledhje studimesh Nr. 1.

Dorëzuar në redaksi në korrik 1990

### *Summary*

## The application of high frequencies electromagnetic methods in Dhrovjan ore deposit.

The high frequencies electromagnetic methods are used to precise the clay-gypsum lenses within the salty body. The results of these works are given in this paper. The electromagnetic data helps for a better geometrization of the above mentioned lenses and the right orientation of underground mining works.

## METODIKE

### PARAMETRI TEKNIK I PËRMBAJTJES MESATARE TË MINERALEVE TË DOBISHME

— Resmi Kamberaj\* —

Parashtronet metodika e ponderimit të përmbajtjes mesatare midis dy punimeve duke eliminuar rastet e mbivlerësimit dhe nënvlërësimit të përmbajtjes së punimit me trashësi të vogël, që rrjedh nga përdorimi i metodave të zakonshme të ponderimit në llogaritjen e rezervave.

Qëllimi i parametrimit teknik të rezervave minerale të një vendburimi (ose të një apo disa trupave të veçantë të tij) është të ndihmojë për të zgjedhur midis projekteve të shumta teknikisht të mundshëm atë, i cili ka mundësitet më të mëdha që të arrijë rezultatet më të mira ekonomike në momentin e zbatimit të tij.

Kështu dalin në dukje dy anë, e para thjesht teknike dhe e dyta thjesht ekonomike. Pjesa e parë konsiston në përzgjedhjen që në fillim në bazë të 1 ose 2 parametrave teknike (për shembull për xherorët e bakrit parametri i parë dhe kryesorë është përmbajtja e elementit bakër ose bakër konvencional) të disa varianteve teknike plotësisht të pavarur nga konsideratat ekonomike. Që të realizohet kjo duhet që këto parametra të jenë të llogaritur drejt.

Këtu së pari po trajtojmë problemin metodik të vlerësimit të përmbajtjes së elementeve të dobishëm në xherorët e bakrit duke pozuar një metodikë ponderimi dhe duke e krahasuar këtë me metodat e zakonshme.

Llogaritja e përmbajtjes mesatare është një rast mjaft i përhapur, sidomos në kërkimin e zbulimin e vendburimeve të bakrit, kur kemi për të vlerësuar një blok (ose sipërfaqe) në formë trapezi si në fig. 1. Duke u mbështetur në rezultatet e dy takimeve (p.sh. shpimet 144 dhe 149, fig. 1), dihet që ka tre metoda praktike për vlerësimin e përmbajtjes mesatare të kësaj sipërfaqe:

1. Metoda e parë përcakton përmbajtjen mesatare arithmetike të metalit duke ponderuar përmbajtjet xa dhe xb të dy shpimeve me trashësitë a dhe b të trupit në këto dy takime ose duke u atribuar zona

influence çdo takimi, të cilat janë dy katërkëndësha me sipërfaqe përkatëse (a.b):2, (b.h):2, ose katërkëndëshat AA'AlAl' dhe BB' BIBI' (fig. 1), ku h — është largësia midis takimeve.




Fig. 1 — Trapezi (sipërfaqja) që vlerësohet.

1 — Shkëmbinj rrëthues; 2 — trupi xheror; 3 — trashësia e trupit (bazat e trapezit); 4 — shpimet; 5 — kufijtë e trupit; 6 — përbajtja e elementit të dobishëm.

The trapezium (surface) under estimation.

1. surrounding rocks; 2 — ore body; 3 — body thicknesses (trapezium basis); 4 — drillings; 5 — body borders; 6 — content of useful elements.

2 — Metoda e dytë, këtë trapez e ndan në dy trapeza me lartësi  $h/2$  të cilët janë një bazë të përbashkët e të njëjtë dhe dy të tjera janë përkatësish a dhe b (trapezat AA'MM' dhe BB'MM'), (fig. 1).

Përbajtja mesatare e vlerësuar  $Z^*$  ka këtë formë:

$$Z^* = (1 - \lambda) xa + \lambda xb$$

ku:  $\lambda$  — është një koeficient ponderues që për metodën e parë ka vlerë:  $\lambda = b/(a+b)$ , dhe për metodën e dytë ka vlerë:  $\lambda = 0.25 + 0.5(b/(a+b))$ .

Duket menjëherë që me metodën e parë, koeficienti ponderues e nënvlerëson përbajtjen me trashësi më të vogël (përkatësish përbajtjen e shpimit 149); ndërsa në metodën e dytë ky koeficient e mbibajtjen e shpimit 149). Në praktikën e zakonshme të llogaritjes së vlerëson këtë përbajtje. Në praktikën e zakonshme të llogaritjes së rezervave gati gjithmonë është prirja që të përdoret metoda e parë.

3 — Midis këtyre dy metodave të ponderimit ekziston një procedurë që do të jetë më e pranueshme dhe që në literaturën e fundit quhet *kriking* (Matheron 1962, 1963; Clark 1984; Journel 1977; Osmani S. 1987). Ky term ka të bëjë me vlerësimin e bloqeve gjeologjike. Kur një blok është studjuar me prova të shumta ose shpime, është mjaft një rëndësishme dhe mund të përmirësohet vlerësimi, p.sh. i përbajtjes, duke marrë parasysh edhe provat ose shpimet që janë jashtë blokut duke marrë parasysh edhe provat ose shpimet që janë jashtë blokut që vlerësojmë. Megjithatë aplikimi i Krikingut nuk është i rekoman-

duar kurdoherë dhe pa bërë më parë një gjykim të kujdeshëm (Matheron 1970).

Problemi i parë që duhet të zgjidhet është përcaktimi i vlerës së koeficientit  $\lambda$  me konditën e zakonshme që varianca të jetë minimale. Ky koeficient llogaritet me anë të formulës së mëposhtëme (Matheron G. 1963) e cila merr parasysh përmasat e trapezit:  $L = (a+b)/2$ ;  $e = (a-b)/2$ ;  $S = L \cdot m \cdot \sin \varphi$ ;  $m$  — përgjysmorja e bazave të trapezit;  $\varphi$  — këndi i përgjysmores me bazat.

$$\lambda = (Ga - Gb + Cab - \log a)/(2 Cab - \log a \cdot b) = N/D$$

ku:  $a;b$  — janë bazat e trapezit

$Ga$  — kovarianca e trapezit me bazën  $a$ ;

$Gb$  —  $\rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow b$ ;

$Cab$  —  $\rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow \rightarrow$  e dy bazave të trapezit;

$\log$  — logaritmi me bazë 2.7182818.

Të tria këto kovarianca llogariten duke marrë parasysh parametrat e sipërpërmendura të trapezit ( $L$ ,  $e$ ,  $m$ ,  $S$ ) dhe logaritmin e ekvivalentit linear të tij ( $V$ ), i cili llogaritet:

$$V = \log [L \cdot L + ee + m \cdot m - (e \cdot e \cdot m \cdot m / 3L \cdot L) + 2S]/2$$

Në numërueshin ( $N$ ) dhe emërueshin ( $D$ ) të formulës së llogaritjes së koeficientit ponderues ( $\lambda$ ) mund të futen përvëç shprehjeve të plota të tyre, të cilat janë shumë komplekse dhe jo të volitshme, edhe shprehjet e tyre të përaferta, të cilat për qëllimet praktike sigurojnë saktësi të mjaftueshme. Vetë këto shprehje të përaferta të numërueshit dhe emërueshit kërkojnë llogaritje të shumta, por kur llogaritja e rezervave është e informatizuar atëhere llogaritja e koeficientit ponderues nuk ka vështirësi.

Kur llogaritja e rezervave bëhet me dorë, atëhere për llogaritjen e koeficientit ponderues mund të përdoret një formulë akoma më e thjeshtëzuar, vlera e të cilës varet vetëm nga dy bazat e trapezit (më saktë nga raporti i brinjës së vogël mbi brinjën e madhe  $b/a$ ).

Kështu ky koeficient llogaritet:

$$\lambda = 0.5 + K_1/K_2$$

$$\text{ku: } K_1 = 0.5 (\log b/a + (a \cdot a - b \cdot b) / (a \cdot a + b \cdot b))$$

$$K_2 = \log ((a \cdot a + b \cdot b) / (2 \cdot a \cdot b) + 0.5 \cdot (a \cdot a - b \cdot b) / (a \cdot a + b \cdot b)^2)$$

Duke aplikuar këtë koeficient ponderues të llogaritjes në këtë mënyrë dhe duke krahasuar me dy metodat e tjera, duket që përbajtjet mesatare me anë të Krikingut janë më të besueshme dhe si vlera qëndrojnë midis rastit kur mbivlerësohet takimi me trashësi të vogël dhe rastit kur nënvlerësohet ky takim

Në tabelën nr 1 po jepim për krahasim të tre koeficientët e llogaritur në tri mënyrat e mundëshme, duke i shënuar përkatësish  $\lambda_1$ ,  $\lambda_2$  dhe  $\lambda_3$ . Si madhësi të raportit të dy bazave  $b/a$  janë marrë vlerat nga 0.01 deri 1.

Tabela e krahasimit të tre koeficientëve ponderues

Nr.	Raporti b/a	Metoda e I $\lambda_1$	Metoda e II $\lambda_2$	Metoda e Krikingut $\lambda_3$
1.	0.01	0.0099	0.255	0.0914
2.	0.02	0.0196	0.2598	0.1083
3.	0.04	0.0385	0.2692	0.1326
4.	0.06	0.0566	0.2783	0.1521
5.	0.08	0.0741	0.287	0.1693
6.	0.1	0.0909	0.2955	0.1851
7.	0.2	0.1667	0.3333	0.2516
8.	0.3	0.2308	0.3854	0.3048
9.	0.4	0.2857	0.3929	0.3484
10.	0.5	0.3333	0.4167	0.3845
11.	0.6	0.3750	0.4375	0.4147
12.	0.7	0.4118	0.4559	0.4405
13.	0.8	0.4444	0.4722	0.4628
14.	0.9	0.4737	0.4868	0.4824

Vërehet që koeficientet ponderues ndryshojnë shumë nga njëri tjetri. Koeficienti i  $\lambda_3$  ka vlera që lëkunden gjithmonë midis vlerave të dy koeficientëve  $\lambda_1$  dhe  $\lambda_2$ .

Për ilustrim të kësaj metodike po japim tabelën e mëposhtme, ku janë marrë shembuj nga punime shpimi (vendburjmi Munellë) dhe punime minerare (vendburimi Tuç). Me qëllim që të gjykohet më gjërësisht për këtë metodë ponderimi të propozuar janë marrë punime me trashësi e përbajtje shumë të ndryshme dhe njëkohësisht për 4 deri 5 elementë të dobishëm të ndryshëm.

Tabela e përcaktimit të përbajtjes mesatare me metodën e zakonshme (1) dhe me metodën e propozuar të Krikingut.

Tabela Nr. 2

Nr.	Objekt punime	Baza e trap. e madhe %	Baza e trap. e vogla %	Përbajtja sipas		Ndrysh. ndaj metod. bazë %
				Metoda e I	Krikingut	

## VENDBURIMI MUNELLE

1.	S 144	49/0.97	5.4/9.56	0.929	0.891	4.09
2	dhe 149	0.021	0.0104	0.02	0.019	4.99
3		43.2	40.56	42.938	42.691	0.57
4		0.7	0.74	0.704	0.708	-0.568
5	S 146	32.9/3.08	1.5/4.66	3.149	3.299	-4.763
6	dhe 152	0.01	0.055	0.012	0.016	-33.33
7		0.0062	0.042	0.008	0.011	-37.5
8		47.78	41.27	47.496	46.879	1.299
9		0.69	2.0	0.747	0.871	-16.599
10.	S 146	32.9/3.08	1.4/0.47	2.973	2.927	8.27
11	dhe 135	0.01	0.027	0.011	0.012	-9.09

(va zhdon tab. 2)

Nr.	Objekt punime	Baza e trap. e madhe %	Baza e trap. e vogla %	Përbajtja sipas		Ndrysh. ndaj metod. bazë %
				Metoda e I	Krikingut	
12		0.0062	0.0017	0.006	0.006	0.00
13.		47.78	4.86	46.028	41.974	8.80
14.	S 159	19.4/7.19	10.3/3.56	5.931	5.758	-2.910
15	dhe 156	0.0012	0.003	0.003	0.003	0.00
16		39.82	45.32	41.727	41.989	-0.6278
17		7.0	3.58	5.814	5.651	2.803
18	S 135	24/2.61	5.5/0.79	2.271	2.122	6.560
19	dhe 142	0.19	0.028	0.16	0.147	8.124
20		0.019	0.0053	0.016	0.015	6.25
21		31.28	10.75	27.452	25.773	6.1161
22		1.23	0.14	1.027	0.938	8.666
VENDBURIMI TUÇ						
23.	679	15.4/0.98	2/1.23	1.009	1.032	-2.279
24		40.4/1.46	15.4/0.88	1.3	1.262	2.923
25		48.4/1.08	20.6/0.55	0.922	0.89	3.470
26	661	47.2/1.2	13.2/0.62	1.073	1.027	4.10
27		47.2/1.2	46.2/1.59	1.392	1.394	-0.017

Duket që ndryshimi midis këtyre dy metodave është nga +9 % deri në -37% dhe vërehet gjithashtu që ndryshimin më të madh e kanë ato takime që ponderojnë përbajtje të ulëta të elementeve të dobishëm. Në tërsi vërehet që kemi ndryshim pozitiv, pra kemi një mbivlerësim të përbajtjes nga 27 raste vetëm 9 kanë përbajtje më të lartë se sa ajo që llogaritet me metodën e zakonshme. Këto 9 raste shpjegojnë me faktin që, kur krahasonë dy takimet që ponderojnë, ka një fazë korelacioni negativ midis trashësisë dhe përbajtjes. P.sh. numri rendor 4 në tabelën 2 ka ulje të trashësisë dhe rritje të përbajtjes. Vetëm se ky ndyshim nuk është proporcional; trashësia ulet 9 herë, ndërsa përbajtja rritet vetëm 5.71 %. E njëjtë gjë thuhet edhe për prirjet që kanë trashësia e përbajtja, për numrat rendorë 5,6,7,9, 16,23,27 të tabelës Nr. 2.

Një teknikë e tillë e vlerësimit të përbajtjes mund të përdoret me mjaft sukses në punimet minerare të shfrytëzimit, kur kërkohet të njihet mirë përbajtja e bloqeve për të bërë planifikim racional të nxjerrjes së metalit. Në varësi të rasteve të shumtë të vendosjes së punimeve konturuese të bllokut (fig. 2) ka shprehje të ndryshme të koeficientit ponderues (Matheron 1962). Veç kësaj mund të llogaritet edhe varianca e vlerësimit të përbajtjes për bllokun si rezultat i shtrirjes së përbajtjeve të punimeve kufizuese në krejt bllokun.

P.sh. për rastin e I të figurës 2, kemi këto shprehje të koeficientit ponderues (të punimit b) dhe variancës së vlerësimit të përbajtjes së bllokut  $\sigma^2 k$ ) në bazë të raportit  $t = b/a$ .

$$\lambda = 1 - (N/D)$$




Fig. 2 — Disa raste të konturimit të sipërfaqes që vlerësohet.

1. Sipërfaqja që vlerësohet; 2 — punimet kufizuese; 3 — përmasat e sipërfaqes.

Some cases of the contour of the estimated surface.

1 — the surface under estimation 2 — limited workings; 3 — surface dimensions.

$$\text{ku: } N = -\log t + 1 - 0.2617 t + 0.3611 t^2 - 0.3333 t^2 \log t + 0.0388 t^4 - 0.0083 t^6$$

$$D = -\log t + 1 - 0.4166 t^2 - 0.5 t^2 \log t + 0.075 t^4 - 0.0178 t^6$$

$$\sigma^2 = 0.5325 t - 0.125 t^2 + 0.0138 t^4 - 0.000416 t^6$$

$$\sigma^2 k \sigma^2 = \lambda (D - N)$$

Rastet e tjerë II dhe III të fig. 2 kanë shprehje të ndryshme nga këto të dhëna më lartë.

Kështu me anë të kësaj përbajtje tashmë të vërtetë (në fakt me variancë minimale) të filtruar nga çdo mbi — dhe nënvlerësim kemi mundësi që të krijohen disa variante p.sh. në bazë të përbajtjes kufi) dhe që varianti ekonomik optimal (kushdo që të jetë) do të bjerë domosdoshmërisht brenda kësaj familje projektesh teknikisht optimale.

## KONKLUSIONE

1. Kjo mënyrë ponderimi përdoret si në punimet e shpimit ashtu dhe në ato minerare.

2. Përbajtja e vlerësuar me anë të kësaj metodike është më afër të vërtetës dhe përjashton si mbivlerësimin ashtu edhe nënvlerësimin e punimeve me trashësi të vogël që rrjedh nga përdorimi i dy metodave të zakonshme të ponderimit.

3. Kur ekziston korelacion negativ midis trashësisë së trupit dhe përbajtjes së elementit të dobishëm metoda e zakonshme e ul përbajtjen në krahasim me atë që del nga metoda e propozuar e Krigingut.

4. Kjo metodë është e vlefshme kur ponderojmë rezultate që i përkasin një vendburimi apo trupi homogen. Kur p.sh. në njërin punim takohet një pjesë e pasur në raport me takimin tjetër atëherë midis këtyre dy takimeve nuk mund të bëhet fjalë për Kriging. Gjithashtu duhet që vendburimi të jetë izotrop. Në qoftë se ka një zonalitet oblik ose ortogonal kundrejt punimeve ponderuese atëherë kjo mënyrë ponde-

rimi mund të përdoret veçse kur punimet e kanë prerë trupin nga tavani në dysheme.

5. — Ponderimi me anë të teknikës së Krigingut është i përdorshëm edhe për xherorë të tjerë të dobishëm veç atyre të bakrit.

## LITERATURA

1. Osmanli S. (1978) — Gjeostatistika, Tiranë.
2. Clark I. (1984) — Practical Geostatistics, Elsevier.
3. Journel A. (1977) — Geostatistique minière. Tome I., II. Centre de geostatistique.
4. Matheron G. (1962) — Traité de géostatistique appliquée. Tome I. Paris.
5. Matheron G. (1963) — Traité de géostatistique appliquée. Tome II. Krigeage. Paris.
6. Matheron G. (1970) — La théorie des variables régionalisées et ses applications. Fontainebleau.

Dorëzuar për botim më gusht 1990

## Summary

### Ore reserves technical parametrization

This article treats the methodical problem of estimation of the average content of useful elements on the basis of Kriging technique. The calculation of average content by usual methods of estimation has either overestimation or underestimation of the working with less thickness. This difference scale is as much high as the content is low. The defining proposed method of the average content after Kriging is better, and has minimum variations and the calculated properties are always between the case of over-and underestimation.

The ponderous average content is calculated:

$$Z = (1 - \eta) \cdot x_a \lambda \cdot x_b$$

where:

$x_a$  — the content of working of a length (big base of trapezium).

$x_b$  — the content of working of b length (small base of trapezium).

— the ponderous coefficient which is calculated by means of an approximate formula.

$$\eta = 0,5 + \frac{0,5 \log \frac{b}{a} + 0,5 \frac{2a - b^2}{a^2 + b^2}}{\log \frac{a^2 + b^2}{2 \cdot a \cdot b} + 0,5 \left[ \frac{a^2 - b^2}{a^2 + b^2} \right]^2} \quad (\text{Matheron G. 1963})$$

log = logerithm of 27182818 base.

This ponderous way of content is available when the ore deposit is homogeneous and has a kind of isotropy when there is a anisotropy simply geometric then it is possible that the estimated trapezium will be transformed with an acceptable affinity and later on we can apply it. When there is any oblique or orthogonal zonality towards the trapezium bases then Kriging can be used on the condition that the working must cross the ore body from the top to the bottom.

This ponderous way can be used for all usefull elements of copper ore and other useful ores and presupposes that the reserves calculation ought to be done automatically because the calculation of the ponderous coefficient needs time and is unpractical by hand.

## NË NDIHME TË SPECIALISTËVE TË BAZËS

### SHKËMBINJTË BITUMINOZË NË VENDIN TONË PROBLEME GJEOLGO-GJEOKIMIKE TË PËRPUNIMIT E TRAJTIMIT TË TYRE

Fotoq Diamanti\*

Jepen njohuri të reja në konceptimin e shkëmbinjve bituminozë si lëndë e parë për burime konkrete hidrokarburesh, përdorim në ndërtim, në asfaltim, për prodhimin e mikroelementeve etj. Trajtohet kuptimi i shkëmbinjve bituminozë, kushtet e formimit, tipizimi i tyre nën një konteks të ri bashkëkohor, përaprja dhe karakteristikat kryesore gjeologo-tektonike të shkëmbinjve bituminozë (bitumeve natyror, rërave bituminoze, ose gëlqerorëve e dolomiteve bituminoze), duke i ilustruar me të dhëna konkrete gjeologjike, gjeokimike e teknologjike.

#### 1. Shënime të përgjithshme

Rezervat e lëndëve djegëse energjitime kryesore janë ato të naftës, të gazit dhe të qymyreve. Në nivelin e sotëm të teknikës e teknologjisë, gjithnjë e më shumë po tërheqin vëmëndjen burime të tjera hidrokarburësh: shkëmbinjtë bituminozë (SHB) dhe rreshpet djegëse bituminoze (R.D.B.).

Në disa vënde studimi i shkëmbinjve bituminoze është objekt i rëndësishëm studimesh eksperimentalo-laboratorike e përgjithësimesh kantjerale, të cilat kanë vënë në disponicion të specialistëve mjaft ide, teza, hipoteza e rezultate interesante e me vlera praktike. Është me mjaft dobi të njihen nga ne arritet në këtë fushë, meqënëse vendi ynë prej vitesh ka hyrë në rrugën e kërkimit, nxjerrjes dhe trajtimit të shkëmbinjve bitumionze, por jo me atë intensivitet që kërkon koha.

\* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave në Universitetin e Tiranës

## 2 — Kuptimi i shkëmbinjeve bituminozë; kushtet e formimit dhe tipizimi i tyre.

Bitumet, janë substansa natyrore me ngjyrë, fortësi dhe avullshmëri (volatilitet) të ndryshme, të përbëra kryesisht nga elementët C dhe H të shoqëruar me material tjetër organik. Ata janë sisteme koloidale, në të cilët mjedisin dispersiv e përbëjnë vajrat (të përbëre kryesisht nga hidrokarburet) dhe rrëshirat, kurse fazën e disperguar e përbëjnë asfaltet (komponime policiklike me peshë molekulare të lartë). Bitumet natyrore përbëjnë grupin e mineraleve organike djegëse të gjëndjes së ngurtë, gjenetikisht të lidhur me naftën.

Konferenca e Dytë Botërore e naftave të rënda rekomandoi që ndarja e naftave të rënda dhe e bitumeve të bëhet në bazë të madhësisë së viskozitetit në kushte shtresë në 10.000 cP, ç'ka diferencon naftën nga bitumet. Për krahasimin fiziko-kimike të bitumeve e naftave të rënda përcaktues të jetë parameri strukturor-fa, ose shkalla e aromatizimit që përcaktohet me metodën e analizës rentgeno-strukturore (Uspenski V.A. etj. 1961).

Për nga përbërja, madhësia e rezervave, karakteri dhe shkalla e imprenjimit, përqëndrimi i elementeve shoqërues etj.; bitumet janë të tipeve të ndryshme. Në përgjithësi tipi i tyre përcaktohet nga kushtet e shndërrimit të sistemeve hidrokarbure, si dhe nga natyra e lëndës organike fillestare. Janë përcaktuar 6 procese kryesore të bitumo-gjenezës: degradimi i naftës, përqëndrimi i përbërsve asfalto-rëshinorë gjatë migrimit, deasfaltizimi, diferençimi fazoro-migrues, shndërrimet termalo-metamorfike dhe destruktimi (Hunt. J.M. 1979).

Meqënëse në formimin e bitumeve, karakteri dhe drejtimi i procesit të shndërrimit të hidrokarbureve janë përcaktues, ndarja e tyre bëhet sipas kriterit gjenetik. Sipas proceseve të formimit dhe kushteve të shtrirjes diferencohen tri tipe gjenetiko-morfologjike të bitumeve: Tipi hipergjen, tipi fazoro-migrues dhe tipi termalo-metamorfik.

Shkëmbinje bituminozë janë rëra, ranore, gëlqerore, dolomite etj. Rërat e ranorët bituminozë janë shpesh kokëtrashë me assortim të mirë, porozë e të përshkueshëm. Ato janë hidrofile, dhe cipa e ujit nuç e kalon 10% të vëllimit të boshllëqeve. Bitumi vetë zë deri 18-20% të shkëmbit. Rërat dhe ranorët bituminozë gjënden me shumicë në depozitimet deltore dhe përhapen në sipërfaqe të mëdha, me qindra kilometra. Në gëlqerorët e dolomitet bituminoze bitumi ndodhet në hapësirat ndërkristalore, në çarjet, në kavernat e në stiliolite.

## 3 — Përhapja dhe karakteristikat kryesore gjeologo-teknike të shkëmbinjeve bituminozë në vendin tonë

Në vendin tonë shkëmbinjtë bituminozë i gjejmë në disa rajone të zonës së Krujës, Jonike e në ultësirën Pranëadriatike. (fig. 1).

### 3.1. Vendburimi i bitumit Selenicë

Daljet sipërfaqësore të bitumit në Selenicë janë njohur, përshkruar e vlerësuar nga shumë studjues, deri në ditët e sotme. Sipas të dhëneve më të reja biostratigrafike (Marku D. Etj. 1990), formimet bituminoze lidhen me depozitimet molasike të tortonianit, të cilat formojnë një monoklinal me rënie në drejtim të veriut dhe veriperëndimit. Ato vendosën transgresivisht mbi depozitimet më të vjetra të gëlqerorëve të kretak-paleogjenit ose mbi flishin e oligocen-akuitanianit (fig. 2).

Në lokalizimin e mineralizimit roli kryesor i përket faktorit litologjik e strukturor. Mineralizimi përqëndrohet në kontaktet formacionale të konglomerateve me alevrolitet ose të ranorëve me argjilat në përputhje me shtresëzimin e shkëmbinjeve (fig. 3). Të gjitha shtresat bituminoze kanë si horizont mbështetës një shtresë alevrolitore të ngopur me naftë ose më rrallë një horizont alevrolito-fosilmbajtës (Kamberi L. 1984).

Trupat bituminoze kanë trajtë shtresore (me rënie të butë deri në horizontale), damarorë (me rënie vertikale ose me kënde të thepisura) ose në formë shtoku me konfiguracion të komplikuar. Bitumet e Selenicës në bazë të përbërjes elementare, përbërjes grupore dhe karakteristikave optike janë të ndryshëm, nga produkte pak të shndërruara të naftës (malta) e deri në ato me një shkallë të lartë shndërrimi (asfaltite). Bitumet përmbajnë vajra në sasi 28-63%, rëshira benzoli 10-25%, rëshira alko benzoli 4-15% dhe asfalte 11-49%. (Diamanti F 1980, Uspenski V.A 1961 dhe 1964). Në bazë të karakteristikave optike të vajrave ata janë bitume migrues. Treguesit e strukturës aromatike tregojnë për një oksidim dytësor të naftës. Në prova të veçanta të bitumit eshtë përcaktuar edhe përmbajtja e V dhe Ni. Përmbajtja e V në 100 gr material fillestar asfalti lëviz nga 22-33-64 mg, ndërsa e Ni 3.41-16 mg. (Diamanti F 1980, Uspenski V.A etj. 1975). Në bazë të përmbajtjes së materialit terrigen brenda trupave bituminoze dalojnë bitume homogjene dhe bitume heterogjene me përmbajtje lëndësh sterile (ose zhavore bituminoze). Këto tipe sipas ndarjes lokale i përkasin një vargu kryesor bituminizimi që do të ishte:

→ Kerite

Naftë maltë asfalte asfaltite —

→ oksikerite

Ky vendburim eshtë rast i rrallë i ruajtjes në gjëndje minerale jo vetëm i aparatit eruptiv të daljes natyrore, por dhe i gjithë sistemit që lind në sajë të formimit bituminoz. Në këtë pikpamje shtratimi i bitumit në Selenicë ka vlerë të madhe dhe duhet të bëhet objekt i një studimi kompleks gjeologo-gjeokimik e teknologjik. Selenica, eshtë dhe një ilustrim i shkëlgjerë i fenomenit të oksidimit të bitumit në periferi të damarëve bituminoze. Në kontaktin e damarëve të bitumit me shkëmbinjtë rrëthues bitumi ka ngjyrë të murme ose të murme të verdhë, pa shkëlgim, me strukturë të hollë pluhurore. Ky varietet oksikeritik ka fortësi dhe dëndësi më të vogël, dhe peshë volumore që ulet sa më e çelët të bëhet ngjyra. Bitumi i murmë takohet në formë brezash edhe brenda bitumit të zi të zakonshëm, por trashësia e kë-




Fig. 1 Përhapja e shkëmbinjve bituminoze në zonat tektonike Jonike, Kruja dhe UPA.

1. Vendburimi i bitumit Selenicë, 2. rërat bituminoze — Kasnicë (Patos), 3. rërat bituminoze — Greshicë — Ballsh; 4. ranor bituminozë Kuçovë, 5. ranor bituminozë Pekisht, 6. ranor bituminozë Makaresh (Krujë), 7. ranor bituminozë-zhapokikë (Berat), 8. gëlqerorë bituminozë — Kremenarë, 9. gëlqerorë bituminozë — Golem (Gjirokastër) 10. Brekcie dolomítiko-bituminozë — Palasë, K. krahë i brëndshëm i UPA me molase mio-pliocenike, Kj — Krahë i jashtëm i UPA me molase pliocenike.

**Spreading of bituminous rocks on the Jonian, Kruja zones and Preadriatic depression.**

1 — Bitumen deposit, Selenicë; 2 — bituminous sandstone — Kasnicë (Patos); 3 — bituminous sandstone — Greshicë (Ballsh); 4 — bituminous sandstone — Kuçovë; 5 — bituminous sandstone — Pekisht; 6 — bituminous sandstone Makaresh Krujë; 7 — Bituminous sandstone-Zhapokikë (Berat); 8 — bituminous Limestone — Kremenarë; 9 — bituminous limestone — Golem (Gjirokastër) 10 — dolomitico-bituminous, breccia — Palasë; Preadriatic depression:

Kb — Inner side of UPA with mio — Pliocene molasse:

Kj — External side with Pliocene molasse.

tyre brezave në kontaktin me shkëmbinjtë copérizorë — mëdhenj (zakonisht gurale ca), si rregull, është më e madhe (0.20-0.25 m) se sa në kontakt me argjilat, ku gati gjithmonë mungon (Uspenski V.A. 1961). Në raste të rralla ky bitum i murmë ndërtion edhe damarë të veçantë ose thjerza me trashësi nën 0.3-0.4 m, pra trashësia e bitumit të murmës në shumicën e rasteve nuk i kalon 0.5 m. Prania e tij tregon për shndërrimin e bitumit të zakonshëm në kushte oksiduese. Këto ndryshime në ngjyrë, në shkëlqim, në plasticitetin por dhe në përbërjen dhe vetitë e tjera, si rezultat i oksidimit të bitumit ndikojnë në praktikën e shfrytëzimit të vendburimit sipas tipizimit të bitumeve në formën e maltës papazit, bitumit plastik, poroz, me shkëlqim, të zi, të kuqëremtë kafe, etj.

Në Selenicë, përvëç bitumeve njihen edhe komponime të afërtë me to, të quajtura bitumite (Vaso P etj. 1989) ose nga vendasit zhavore bituminoze që janë bashkësi grimcash bitumi të përzjer me material argjilo-alevrolitor. Përbajtja e lëndëve sterile luhatet nga 10-50-70%, çka ul edhe aftësinë e tyre kalorifike nga 9300 në 2000 kkal/kg. Ky lloj shkëmbi bituminoz përdoret gjërësisht në prodhimin e koksit, në sigurimin e fraksioneve hidrokarbure të lëngëta dhe të gazta dhe sidomos për djegje.

Mbështetur në format e shtrirjes, në marëdhëniet e bitumit me shkëmbinjtë rrethues, në përbërjen e vetitë fiziko-kimike si dhe në përapjen e bitumeve, arrihet në përfundimin se bitumi i Selenicës ka preardhje dytësore. Trupat bituminoze duhet të janë formuar nga shkatërrimi i një shtratimi naftë në thellësi, si rezultat i ngritjes së një strukture gëlqerore në sipërfaqen e ajrimit. Në shekullin tortonian, grumbullimi i sedimenteve në mjedisin ujor që mbulonte këtë strukturë, shoqërohej me derdhjen e naftës nga thellësia, duke formuar trupat (shtresat) bituminoze paralelisht me shtresëzimin. Nga punimet e kërkimit janë vërtetuar disa shtresa bituminoze që qëndrojnë njëra mbi tjetren ose që janë pak të spostuara. Trupat bituminozë lidhen krysish me depozitimet e formacionit alevrolitor të Selenicës, të formuar në pellg sedimentimi me ndikim të fortë të kontinentit (lagunoro-deltor) dhe pjesërisht me depozitimet e formacionit konglomeratoranorik të Hotimes, detar, me pak ndikim të kontinentit dhe me kripesi gjatë gjithë kohës normale (Marku D. etj. 1990). Bitumi i u nënshtrua ujrade të embla deri në fort të embësuara ose normale dhe pastaj varrosjes bashkë me sedimentet. Por pas mesinianit në pliocen dhe paspliocenit, lëvizjet tektonike intensive kanë ndikuar shumë në shkatërrimin e shtratimit të naftës në thellësi dhe në migrimin e saj nëpër prishjet e çarjet e formuara, ku si rezultat i bituminizimit janë formuar trupa të tjerë që ndërpresin bitumet — shtresorë (fig. 2). Formimi i bitumit të tillë në disa raste vazhdon edhe sot: në disa punime minerare pranë gëlqerorëve të kretak-paleogjenit janë takuar bitume të buta që nuk e kanë marrë ende formën e tyre përfundimtare, pasi kanë presione të larta dhe gaze të shumta.

Analiza e këtyre të dhënavë tregon se në Selenicë kemi të bëjmë me dy tipe bitumi: 1) Bitume të tipit hipergjen, të zonave të këmbimit të lirë të ujrade, me shtrirje shtresore në monoklinal dhe 2) bitume të

tipit fazoro-migrues, të shprehur në formë damarësh të ndërlikuar.




Fig. 2. Profil skematik i vendburimit të bitumit Selenicë.

1. Bitume shtresore; 2. Bitume joshtresore;




Fig. 3. Përgëndrimi i bitumit në kontaktin ranor-argjila.

Bitumen concentration in argilla sandstone contacts.  
Schematic section along bitumen deposit, Selenicë.

### 3.2. Rërat e ranorët bituminozë

Shkëmbinj të tillë në vendin tonë ka me shumicë dhe lidhen kryesisht me formacionin molasik (Kasnicë, Trebllovi, Pekisht, Makaresh etj.) me moshë tortonian, më pak me atë flishor-flishoidal (Zhapolikë, Osmanizezë) me moshë oligocen-miocen i poshtëm. Ata janë shtresore ose shtresorë-thjerzore me përmasa të mëdha. Shqipëria vlerësohet si një nga vëndet më të pasura me rezerva rërash bitumineze. Bitumi ndodhet deri në thellësi të mëdha (fig. 4, 5), duke kaluar në naftëmbajtëse (shtresa D<sub>2</sub> në Patos). Ranorët bituminozë i përkasin suitave Bubullima, Marinza, Driza, Gorani dhe Kuçova.




Fig. 4. Profil skematik i vendburimit të naftës në Kuçovë.

1 — Bitum; 2 — naftë.

Schematic section along oil deposit Kuçovë.

1. Oil, 2. Bitumevi.




Fig. 5. Profil skematik i ranorëve bituminozë të Patosit.

1. Ranorë bituminozë; 2 — Ranorë naftëgazmbajtës.  
Schematic section along bituminous sandstone-Patos.

Bitumet janë të tipit hipergjen të zonave të infiltrimit të ujравë të ëmbla, të këmbimit të lirë të ujравë e përrajrimit dhe të tapave tuminoze ose mbulesave (shtresa D<sub>2</sub> — Patos). Nga ky interpretim rrjedh mundësia e egzistencës në rënje e shtresave të tjera naftëmbajtëse, q'ka kërkon punime komplete gjeofizike.

Ranorët kanë porozitet të lartë dhe përbajnjë bitum; Në Trebllovi e Selenicë 10-11%, në Kasnicë e Visokë 10-15% e më rrallë deri 32-36%, në Kuçovë 5.25%, në Pekisht 5-12%, në Makaresh 5.08%, në

Greshicë 14.08% etj. Dallohen ndryshime të theksuara në përmbajtjen e bitumin, dhe në përbërjen e tij, si elementare, ashtu dhe grupore Përmbajtja e C dhe H por sidomos e O si tregues i shkallës së oksidimit të tyre gjithashtu luhatet. Në përbërjen grupore ndryshon përmbajtja e vajrave (të përbërë kryesisht nga hidrokarburet) dhe asfalteve. Për nga përmbajtja e vajrave diferencohen ranorë bituminozë me mbi 60% — varietete në Selenicë; 50-60% në Kuçovë, Pekisht, Selenicë; 30-40% në Greshicë, Osmanzezë dhe me përmbajtje të ulët 15-25% të vajrave në Patos-Visokë e Makaresh. Në funksion të përmbajtjes së vajrave ndryshon dhe përmbajtja e asfalteve. Ajo lëvizë nga 11-12% për përmbajtje të lartë vajrash (mbi 60%) në 50-58% deri 61,98% për përmbajtje të ulët vajrash (Diamanti F 1980, Uspenski V.A. 1961, Vaso P etj. 1989).

Përbajtja e ujit në shtresat bituminoze arrin deri 5-6% dhe lidhet me strukturën e rërës. Bitumet janë gjysëm të lëngshme dhe të lëvizshëm me dëndësi 1015 deri 1040 kg/m<sup>3</sup>, me pikë zbutje 20-40°C.

Në bazë të natyrës dhe të karakteristikave fiziko-kimike të përbërsave, rërat bituminoze janë ndarë në dy tipe:

Tipi i parë, që takohet më shpesh, përfshin rërat bituminoze të ndërtuara nga kokrrizat e rërave kuarcore të veshura me një cipë të hollë uji dhe bitumi rrëth tyre, duke mbushur, pak a shumë gjithë hapësirën boshe midis kokrrizave, në disa raste së bashku me një sasi të vogël gazi. Meqënëse bitumi lidhet dobët ose nuk lidhet fare me kokrrizat e rërës, largimi tij nga rëra kërkon forca relativisht të dobëta. Rëra të tilla bituminoze njihen në vendburimin e Kasnicës (Patos) në Treblovë (Vlorë) dhe në Visokë (Patos).

Tipi i dytë përfshin rërat bituminoze pa cipa të ujtit ose me cipë shumë të hollë, kështu që bitumi lidhet direkt me kokrrizat e rërës. Rrjedhimisht, për shkëputjen e tij nga kokrrizat e rërës do të duhen forca të mëdha, meqënjëse uji vepron si librifikues dhe mposht viskozitetin e lartë të bitumit. Këtij tipi i përkasin rërat bituminoze të Treblovës por dhe disa varietete në Kasnicë e gjetkë. Këto karakteristika përcaktojnë kushtet dhe parametrat teknologjike për ndarjen e bitumit nga rëra. Rëra e shplarë ka përbajtje të lartë kuarci.

Në të gjitha rastet, rërat e ranorët bituminoze takohen ne rajon me ndërtim gjeologjik dy katësor, formojnë struktura monoklinale tortoniane dhe kontaktojnë me gëlqerorët e përajruar të kretak-paleogenit. Formojnë stresa me trashësi 2-5 m.

### 3.3 Shkëmbinjtë bituminozë karbonatikë

Këta shkëmbinj në vendin tonë janë të shumtë dhe përfaqësohen nga gëlqerorë e dolomitë bituminozë të moshës mesozoiko-Kenozoike. Ata përhapen në strukturat antiklinale të të tri brezave strukturore të zonës Jonike dhe në zonën e Krujës, përqëndrohen në krahët e peri-klinaleve e të strukturave të eroduara (Kremenare, Molisht etj), së dhe në tektonikën shkëputëse krahinore (Palasë), Tepelenë etj. (Diamanti F 1980 a dhe 1980 b; Dhinulla J et. 1981). Vrojtimet dhe stu-

dimet tregojnë se janë formuar me anën e migrimit vertikal. Bitumi mbush hapësiqat ndërkrystalore të gëlqerorëve e dolomiteve si Kremenare, Molisht Selenicë etj., kavernat e mikrokavernat, stiliolitet, dhe sidomos çarjet. Hera herës bitumi përbën materialin cimentues duke lidhur brekcie gëlqeroro-bituminoze në Kremenare ose brekcie dolomiti-ko-bituminoze në Palasë.

Sipas shkallës së ruajtjes e të transformimit, bitumet i përkasin tipeve të ndryshme nga naftë e lëngshme dhe e rrjedhshme, në naftë të trashë e gjysëm të lëvizshme (maltë), asfalte e asfaltite e deri në bitume të ngurtë ose kerite. Përberja elementare e bitumit tregon se përpjestimi C/H është pak a shumë i njëjtë në të tri brezat strukturor të zonës Jonike dhe nuk e kalon shifrën 9 (Diamanti F 1980 a). Nga brezi në brez strukturor e sidomos në strukturat brenda tyre vihen re ndryshime në përbajtjen e heteroelementeve e në mënyrë të veçantë S dhe O. Më të oksiduar janë bitumet e vargut të Beratit, e më pak ato të brezit të Kurveleshit dhe të Çikës (Dhimulla I etj. 1981). Molisht-Plashniku, Maraku e Kremenara, kanë shkallë më të lartë ndryshimi. Këto veçori përcaktojnë ndryshimet në përbërjen grupore të bitumit kloroformik me mbizotërim, herë të komponenteve asfaltorë dhe herë të atyre vajore. Gati kudo mbizotëron përbajtja e asfalteve dhe rëshirave ndaj vajrave. Karakteristikat optike dhe termografike tregojnë për produkte të prishjes së shtratimeve.

Në bazë të kushteve të shtrirjes dhe karakteristikave kimiko-bitumologjike dallohen dy tipe bitumesh në shkëmbinjtë karbonatikë.

1 — Tipi hipergjen i formuar në struktura antiklinale të eroduara (Kremenare, Molishti etj.), me morfologji shtresore.

2 — Tipi fazoro-migrues (Palasë) me morfologji të tipit të çarjeve e prishieve krahinore ose lokale.

Nga këto, tani për tani paraqet interes studimi tipi fazoro-migrues, i vrojtuar në Palasë.

Në Palasë, në zonën e kontaktit tektonik midis strukturave anti-

klinale të Cikës dhe të Palasës dalin shkëmbinj bituminoze ne trajte brekçiesh gëlqeroror-dolomitore të çimentuara nga bitumi. Takohen damare e çarje (stiliolite) kalcitike me lëndë bituminoze të përhapura jo uniformisht në masën e shkëmbit. Bitumi është i tipit të rëndë, me ngjyrë kafe të errët në të zezë. Në çarje takohet edhe bitum i lehtë me ngjyrë më të çelët. Në bitum përbahen 22.7% vajra, 46.27% asfalte dhe pjesa tjetër rëshira. Karakteristikat spektale tre-gojnë për një bitum tipik migrues, sipas termogramave është i tipit të asfaltit dhe duhet të përkasë një produkti të prishjes së shratimeve.

4. Probleme të përpunimit kompleks dhe të përdorimit të shkëmbinive bituminozë.

Shkëmbinjtë bituminozë përbëjnë lëndë djegëse të prespektivës. Rezervat e tyre vitet e fundit janë rritur shumë jo aq nga zbulimi i vendburimeve të reja, sa nga rivlerësimi i rezervave të njoitura më parë. Mbi këtë bazë shumë shkencëtarë e ekonomista tërroqën vëmë-

ndjen që shfrytëzimi i shkëmbinjve bituminozë do të lehtësojë esençialisht krizen energjetike.

Në shumë vende të botës përpunimi i shkëmbinjve bituminozë bëhet në rrugën e ekstraktimit të tyre me benzol, me piridin, me sulfur karboni e tretës të tjerë organike ose me anën e përpunimit të tyre me ujë të nxehë e avull etj. Tani për tani rezulton më rentabël përdorimi i avullit dhe ujit të nxehë që siguron nxjerjen e 91-99% të bitumit nga shkëmbinj me kosto rrëth 90-120 dollarë për ton naftë. Por janë ndërtuar edhe pajisje origjinale që sigurojnë nxjerrjen e naftës nga shkëmbinjtë bituminozë nëpërmjet tretësave organike me kosto 85-90 dollarë për ton naftë.

Për vendin tonë, më me leverdi do të ishte përdorimi i skemës teknologjike të përpunimit të shkëmbinjve bituminozë për prodhimin jo vetëm të naftës sintetike, por edhe për nxjerrjen e vazhdueshme përdorimin e produkteve të tjerë me rëndësi ekonomike. Ky përpunim duhet të vlerësohet me llogaritje ekonomike. Llogaritjet ekonomike kanë treguar se përdorimi i shkëmbinjve bituminoze vetëm përdërtim rrugësh ka efekt ekonomik 5-6 herë më të ulët se sa përdorimi kompleks i tyre (Neftë-bituminoznie. 1988).

Problemet kryesore për shkëmbinjtë bituminoze të vendit tonë janë sigurimi e bazimi i rezervave, nxjerra e përpunimi kompleks dhe përdorimi i tyre, të cilët diktojnë:

1 — Organizimin dhe kryerjen e punimeve më të thelluara gjeologo-kërkuese e zbuluese në rajone të njohur e me perspektivë.

2 — Vlerësimin kompleks të rezervave të shkëmbinjve bituminozë si lëndë e parë për prodhimin e lëndëve djegëse, për industrinë kimike, metalurgjike e ndërtimin duke përcaktuar drejt drejtimet optimale të përdorimit të rezervave.

3 — Futjen e tyre në përdorim ekonomik në përputhje me përgatitjen e bazës tekniko-ekonomike të drejtimeve të përdorimit të bitumeve si dhe në varësi të arritjes së rentabilitetit teknologjik të nxjerrjes dhe përpunimit të tyre.

4 — Ndërmarrjen e një studimi kompleks gjeologjik, kimik e teknologjik duke përfshirë specialistë të fushave të ndryshme, të planifikuar e bashkërenduar në planin e zhvillimit ekonomik.

## LITERATURA

- Diamanti F. (1980 a) Kompleksi i metodave në studimin e gjeokimisë së lëndës organike dhe aftësive potenciale hidrokarbure formuese të formacionit karbonatik të zonës tektonike Jonike. Disertacion.
- Diamanti F. (1980 b) — Veçoritë termike të lëndës organike të depozitimeve karbonatike të zonës Jonike. Përb. Stud. Nr. 2.
- Douglas W. Waples (1985) — Geochemistry in petroleum exploration. D. Reidal Publishing Compani.
- Dhimulla I. etj. (1981) — Kushtet gjeologo-gjeokimike të formimit të shtratimeve të naftës e gazit në zonën Jonike. Fier.

- Hunt J.M. (1979) — Petroleum geochemistry and geology. Sanfrancisko, Freeman.
- Kamberi L. (1984) — Ndërtimi gjeologjik i vendburimit bitumit Selenic. Përbledhje Studimesh (Referate e kumtesa të Fakultetit të Gjeologjisë e Minierave).
- Neftëbituminozne porodi. Nauka, Alma — Ata. 1986.
- Prihti Dh. (1986) — Përcaktimi i origjinës së naftës së rajonit Kuçova mbi bazën e studimeve gazkromatografike. Buletini Nafta e Gazi Nr. 1.
- Spravoçnik po geologii nefti i gaza. Moskë. Nendra, 1984.
- Uspenski V.A. etj. (1961) — Osnovne puti preobrazovanija bitumov u prirode i vaprosi ih klasifikacii. Gostoptehizdat, Leningrad.
- Uspenski V.A. etj. (1975). — Metodi bituminologjesh issledo vanii. Leningrad. Nedra.
- Uspenski V.A. etj. (1964) — Osnovi genetičeskoi klasifikacii bitumov. Vipusk 230.
- Vaso P. Duni S. (1989) — Klasifikimi industrialo-morfologjik i bitumeve në vendin tonë. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 4.
- Vaso P. etj. (1989) — Raport mbi studimin tematik për sqarimin e perspektivës së bitumeve dhe ranorëve bituminozë në rajonin Selenicë — Kuçovë — Muriz.
- Vaso P. etj. (1989) — Përkatësia stratigrafike e pakove produktive të ranorëve bituminozë në vendburimin e Patosit, kriteret e vlerësimit dhe rëndësia e tyre. Buletini «Nafta dhe gazi» Nr. 2.
- Marku D. etj. (1990) — Të dhëna të reja për biostratigrafinë dhe ndërtimin gjeologjik të rajonit Selenicë-Kucul-Penkovë. Buletini i Shkencave Gjeologjike, Nr. 3.

Dorëzuar në redaksi në gusht 1990.

## Summary

### Bituminous rocks in our country-their geological-geochemical and treatment problems

This paper gives new knowledge about the conception of bituminous rocks for hydrocarbon production and as raw material used in construction, in asphalting, for the production of microelements etc. It treats the understanding of the bituminous rocks, their formation conditions and sypization under a new contemporary light. The spreading and the main geological-technical features of bituminous rocks, being, either in the form of natural bitumen, of bituminous coal or of bituminous dolomites and limestones; illustrated by geological, geochemical and technological data are given.

From the point of view of composition, reserves character and impregnation intensity concentration of elements association etc; bitumen are of different types. They are considered as products of degradation and of phasis-migration differentiation.

They spread in some regions of Jonian and Kruja zones and also in adriatic

depression (fig. 1). They are related to carbonatic, flyschy and molassic formations, but having a wider and more important spread in molassic formation. In general contain bitumen in 5-12-33% quantity. They produce the fuel, gaseous and liquid substances in 12-37% quantity. During the combustion, up to 9300 kkal/kg are assured.

Such varieties are used for the production of coke and of asphalt-concrete. In the future they may be used also successfully in other branches of the economy.

nga thesareve e shkencave gjeologjike që kanë qenë më parë ka tërhequr vëmëndjen e studiuesve të cilët dhanë me sensacion njoftimet e para gjeografiko-gjeologjike që zgjuan interesat ambicioze në qarqet kapitaliste të Europës për gjetjen e mineraleve të dobishme edhe në krahinën e Tropojës dhe që në fillim të këtij shekulli e bënë Tropojën akoma më të laktueshme për ta.

## GJURMUESIT POPULLORË TË TROPOJËS MBËSHTETJE E SHËRBIMIT GJEOLQJIK

(Pjesë nga kumtesa e mbajtur me rastin e 30 vjetorit të N. Gjeologjike të Tropojës).

Mehmet Doçi\*

Tropoja shekuj më parë ka tërhequr vëmëndjen e studiuesve të cilët dhanë me sensacion njoftimet e para gjeografiko-gjeologjike që zgjuan interesat ambicioze në qarqet kapitaliste të Europës për gjetjen e mineraleve të dobishme edhe në krahinën e Tropojës dhe që në fillim të këtij shekulli e bënë Tropojën akoma më të laktueshme për ta.

Në raportin e shoqërisë Italiane AMMI që mori në koncession shfrytëzimin e mineraleve të kromit në gjithë Shqipërinë, më 20 Tetor 1941 njoftohet se në zonën e Letaje janë hapur 24 kantiere shfrytëzimi, ku më të rëndësishmet ishin në Letaj, Perollaj, Zogaj-Lajthizë, Kepenek-Kam, Bytyç-Helshan dhe grupi i minierave të Kosovës, Deva-Babaj-Bokes Hromoseo etj.

Fashistët Italianë nuk qenë të parët as të vetmit që treguan interes për pasuritë tona minerale. Perandoria Austrohungareze që në fillim të këtij shekulli dërgoi edhe në Tropojë studiues të dëgjuar si Franc Nopçen. Ai dha njoftime me vlerë për pasuritë tona.

### Populli në kërkim të thesareve të veta.

«Gjeologët tu qepen me guxim pëllëmbë për pëllëmbë maleve e fushave, krah për krah me gjurmuesit popullor dhe të vlerësojnë me seriozitetin më të madh, çdo gjurmë, çdo të dhënë e çdo zbulim».

Enver

Tropoja radhitet në ato rrethe të vendit që para qirimit nuk njeh kurrrfarë zhvillimi industrial, ishte sinonim me prapambetjen, ku fjala industri sa ishte futur në fjalorin e krahinës dhe konceptohej si dicë që i jepte vendit zhvillim.

\* N. Gjeologjike në qytetin «Bajram Curri».

Pas çlirimt tē vendit i cili kaloi nēpēr rrugë gjaku, tan i nisi një rrugë tjetër e re, ajo e djersës, nēpērme së cilës fillonte një jetë plotë shpresa edhe pēr Tropojanin. Duhej tē ngrihej industria me forcat tona nē një vend agrar me mbeturina tē theksuara tē marëdhënieve feudale ku dega kryesore e ekonomisë ishte bujqësia.

Prapambetja shekullore duhej kaluar dhe dekadat e viteve duhet tē bënин punën e shekuje pēr këtë duheshin jo vetëm njerëz tē guximshëm por dhe tē mësuar që tē gjenin e tē shfrytëzonin pasuritë tona natyrore sidomos kërkim-zbulimin e minraleve tē dobishme pēr tē përbushur nē kohë porositë e shokut Enver: «Rëndësi tē madhe pēr jetën ekonomike tē popullit kanë minierat».

Shtrohej si detyrë urgjente por edhe kérkesë e prespektivës studimi i gjeologjisë sipërfaqësore, kërkimi dhe gjetja e minraleve tē dobishme që dalin nē sipërfaqe, ndërsa kërkimi i vendburimeve pa dalje nē sipërfaqe ishte detyrë e prespektivës, pēr tē cilën u mendua qysh atëhere.

Pēr tē arritur këto synime nē rrethin e Tropojës nisma e parë eshtë ajo e vitit 1955 kur nga Bulqiza erdhën teknik gjeologët Hamit Noka dhe Sabri Lita pēr tē dokumentuar nē Kam disa punime tē kryera më parë.

Detyra pēr gjetjen e minraleve u kthye nē një frysëzim popullor i cili dita ditës bëhej më i fuqishëm sepse popullin e shtynte përparrë një ideal fisnik, pikërisht fakti se po punonte pēr tē lulëzuar truallin tonë tē lashtë.

Kështu u shtuan «rradhët» e gjeologëve popullor tē cilëve u vlonë pasioni me fisnik, ai i gjurmuesit e i tē mbledhurit vullnetarisht tē thesarëve tē tokës së vet, pasion ky që u shndërrua nē sadisfaksion moral i gjetësit tē minraleve, duke e bërë gjeologjinë tonë një nga profesionet më tē dashura e më popullorë.

Ky frysëzim popullor iu përgjigj besnikërisht kohës së vet duke nxjerrë gjurmues tē talentuar që nuk e ndërprenë aktivitetin e tyre tē jetën si Nikoll Mushaku, puna e tē cilit u bë e njohur nē shkallë vendi pēr afro 3 dekada. Ai ju përkushtua tērësisht me një detyrim shëmbullor gjetjes së minraleve nē rrëthet Tropojë-Kukës-Pukë dhe puna e tij u vlerësua me medalje dhe urdhëra pune nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Nikolla tregonte i mallëngjyer si relikën më tē vyer dhe më tē dhëmbshme fotografinë që kishte dalë me shokun Adil Çarçani nē ato vité, kur ai ishte Ministër i Industrisë dhe Minierave.

Punë këmbëngulëse e plotë vëtmohim bënë edhe gjurmuesit e tjerë popullorë si Galan Nuha, Arif Qerimi e shumë e shumë tē tjerë. Puna e gjurmuesve i dha një shtytje, një hop shërbimit gjeologjik. Një ndër detyrat që shoku Xhafer Spahiu (ish Kryetar i Komisionit shtetëror tē Gjeologjisë) i vinte ndërmarrjes së Tropojës pēr vitin 1959 ishte: Të organizohet kontrolli i pikave tē mineralizuara dhe nē bashkëpunim me grupin e revizionimit tē kontrollohen 200 pikat e gjetura nga Nikoll Mushaku.

Me punën e palodhur tē gjeologëve tanë, si dhe duke ndjekur edhe njoftimet e gjurmuesve popullorë u arrit që ekspedita tē intensifikonte punimet gjeologjike dhe rezultatet pozitive tē përfituar e çuan nē nevojën e ngritjes së ndërmarrjes gjeologjike, nē Janar tē vitit 1959.

Tashmë si specialistët edhe gjurmuesit popullor kishin fituar përvojë pune dhe krijimi i ndërmarrjes krijoj mundësinë e organizimit dhe pjesëmarrjen nē fushatën e parë gjeologjike nē verë tē vitit 1959, e cila pati vlera shumë tē mëdha nē sqarimin e mineralogjisë sipërfaqësore nē rrethin e Tropojës.

### Gjurmuesit popullor nēpēr vite

Në vitin 1959 nē çdo zonë ishin tē afirmuar gjurmuesit popullor tē minraleve tē cilët e kishin pjesë tē krenarisë së tyre këtë emër tē thjeshtë. Ata aktivizuan gjurmues tē tjerë nē zonën e vet, grumbullonin njoftimet e bëra nga populli i kësaj zone dhe ua sillnin specialistëve pēr vlerësim dhe përcaktim. Pēr tē propoganduar rëndësinë e gjurmuesve popullor dhe punën që bënin pēr gjetjen e minraleve shfrytëzonin pēr biseda tē lira mbledhjet e organizuara nē popull, nē shkolla, reparte ushtarake etj.

Eshtë i njohur fakti se shumë shfaqje tē mineralizuara janë njoftime tē popullit, shumë prej tē cilëve mendimi kolektiv i specialistëve i ka kthyer dora dorës e kohë pas kohe nē vendburime. Në këto arritje tē ngrihen përpara marëdhëniet e mira tē specialistëve me masat dhe figura e gjeologëve popullor. E theksojmë këtë sepse tani aktualisht, eshtë krijuar njëfarë shkëputje me masivizimin e kërkimeve gjeologjike dhe aktivizimi i gjurmuesve popullor eshtë zbehur.

Aktivi kombëtar i kromit i organizuar nē B. Curri nē vitin 1968 i dha një impuls tē ri kërkimeve gjeologjike, ku mendimi shkencor spikati dukshëm nē mundësinë e shtrirjes së punimeve gjeologjike dhe rritjes së volumit fizik tē tyre, duke argumentuar nevojën e ringritjes së ndërmarrjes gjeologjike nē Janar 1969. Më vlera tē mëdha pēr shërbimin gjeologjik nē Tropojë ishte dhe aktivi kombëtar i gjeologjisë që u mbajt nē B. Curri nē vitin 1976.

Pēr masivizimin e kërkimeve gjeologjike duhen detyra tē qarta e konkrete si p.sh. çdo inxhinier gjeolog tē ketë nē patronazh një shkollë nē territorin ku ai kryen punime, tē pajis qendrat administrative me kampione minralesh, tē organizojë ekspozita e tē bëjë biseda me popullin etj. Ashtu siç ka rrethe tē tjetra si instrumentist, gjeograf etj. duhet tē ketë dhe rrethe gjeologësh duke organizuar edhe konkurse nē këtë fushë. Duhet tē ngrihen e tē funksionojnë shtabet e zonave, tē nxiten iniciativat e punëtorëve pēr tē punuar si gjurmues popullor mbas punës etj. Nga ndërmarrja gjeologjike tē preqatitet udhëzues me madhësinë e xhepit që tē trajtojë llojet e minraleve tē dobishme tē rrethit tonë dhe vlerat e përdorimit tē tyre.

### Praktikës së prodhimit ti veshim dituritë shkencore.

Mungesën e specialistëve pēr tē kërkuar e pēr tē gjetur thesaret tona e plotësoi vet populli, nga ku dolën gjurmuesit popullor gjetjet e tē cilëve nuk ishin me simbol vetëm i rastësisë, por dhe i punës së tyre.

Pasionit të gjurmuesve që ata i karakterizonte deri në vetmohim i shtuan edhe disa «sekrete të zanatit». Ata mësuan jo vetëm të njohin mirë disa lloje mineralesh të dobishme, por dhe të organizojnë kërkimin e mineraleve si p.sh. kur gjente në faqe të malit një copë minerali të rënë atëhere kërkohej shkëmbi rrënjesor, pastaj ai maste disa elementë të shfaqjeve të mineralizuar si gjatësinë, rënien etj.

Arritjet në këtë fazë të përgatitjes tekniko-profesionale të gjurmuesve popullor ishin atëhere jo vetëm suksese, por dhe ndihmë për specialistët, të cilët ishin të pakët në numër e nuk mbulonin nevojat e kohës.

Në preqatjen tekniko-profesionale të punëtorëve dhe gjurmuesve popullor ndihmuani edhe kurset e kualifikimit me punëtorët dhe gjurmuesit të cilët në vitin 1959 kishin njëfarë stazhi pune, përpjekje këto për të krijuar armata njerëzish që u hapeshin horizonte pune e zhvillimi, ku praktika e tyre e punës do të sqarohej, do të pasurohej me teorinë dhe ata vetë e ndien nevojën dhe domosdoshmërinë e të mësuarit.

Punëtorët dhe gjurmuesit popullor ne i bëmë bashkëpunëtorët dhe kolegët tanë shpesh edhe për problemet mjaft të komplikuara që kërkonin njohuri shkencore në fushën e shkencës gjeologjike. Punëtorët, ndonëse me eksperiencë në punë fare të vogël dhe me arsim minimal, njoftojnë se shfaqjet e mineralizuara nuk janë rastësi, por pjesë të veçanta të një të tere. Kështu mendimi shkencor dhe puna konkrete çoi në zbulimin e disa vendburimeve të kromit.

Specialistët tanë të mbështetur edhe me këto mendime filluan të arsyetojnë se shfaqjet e mineralizuara nuk janë rastësi, por pjesë të veçanta të një të tere. Kështu mendimi shkencor dhe puna konkrete çoi në zbulimin e disa vendburimeve të kromit.

Janë shumë të njohura rastet kur punëtorët propozonin vazhdimin e shpimeve sipas shenjave që ata dallonin në ballin e pusit. Këtë veprim kryesondisti nuk e kryente spontanisht, por në bazë të një njohje teoriko-praktike që ai e kishte fituar gjatë punës në zbulimin e mineraleteve.

Mënyrat për edukimin shkencor të punëtorëve e specialistëve janë të shumta. Vazhdimi i kurseve të kualifikimit me punëtorët, teknikët dhe specialistët e lartë dhe tërheqja sistematike dhe e kualifikuar e eksperiencës së përparuar mbeten detyra gjithnjë aktuale.

Plenumet e fundit të KQ PPSH që i kushtohen thellimit dhe shtrirjes së mëtejshme të demokratizimit të jetës së vendit, shtrojnë detyrën para nesh që jo vetëm të mos harrojmë traditën e vjetër në aktivizimin e bashkëpunimin me gjeologët popullorë, por këtë traditë ta pasurojmë më tej që të ecim krah për krah me gjurmuesit popullorë e të vlerësojmë çdo të dhënë e zbulim të bërë prej tyre.

## PËRMBAJTA E LËNDËS (CONTENTS)

### L. Langora

Studimet gjeofizike nëntokësore duhet të zenë vendin e duhur në kompleksin e zbulimit gjeologjik të vendburimeve të kromit dhe të bakrit. ....  
(The underground geophysical studies must have a place in geological prospecting of chromium and copper deposits).

### GJEOLOGJI (GEOLOGY)

I. Hoxha, S. Meço, A. Matoshi. Vendosja transgresive e formacionit konglomerato-ranoro-kuarcor mbi formacionin terrigjeno-rreshpor dhe formacionin vulkanogjeno-sedimentar në rajonin e Gashit. ....  
(The transgressive emplacement of the conglomerato-sandstone-quartzous formation on the terrigjeno-schistous and volcanogeno-sedimentary ones in Gashi region).

M. Shallo — Boninite ndërmjet ofioliteve «lindore» të Shqipërisë. ....  
(Boninites among the «eastern» ophiolites of Albania).

L.H. Peza, D. Shkupi, I. Turku, I. Terolli — Gjeologjia e rajonit të Vermoshit. ....  
(Geology of Vermoshi region).

Th. Gjata D. Marku — Stratigrafia e jurasikut të sipërm-Kretakut të poshtëm të Albanideve Lindore dhe disa probleme gjeologjike. ....  
(Stratigraphy of Upper Jurassic-Lower Cretaceous of Eastern Albanides and some geological problems).

### MINERALOGJI-GJEOKIMI-PETROLOGJI (MINERALOGY-GEOCHEMISTRY PETROLOGY) mbmb mbm

I. Alliu, N. Kuka — Korigjimet e ndikimit të serpentinizimit mbi përbërjen kimike të shkëmbinjve ultrabazikë. ....  
(Verifications of the influence of the serpentinization on the chemical composition of the ultrabasic rocks).

E. Vllaho — Veçoritë e përbërjes minerale të xherorëve të Ni-Cu në vendburimin e Lumthit dhe kushtet e formimit të tyre. ....  
(Features of mineral composition of Ni-Cu sulphur ores in Lumthi deposit and their formation conditions).

## HIDROGJEOKIMI (HIDROGEOCHEMISTRY)

- N. Maska — Përdorimi i metodave hidrokimike, radioizotopike e fluoreshente në studimin e lidhjeve hidraulike të burimeve karstike. .... 95  
(Usage of hydrochemical, radioisotopic and fluorescent methodes in the study of hydraulic relations of karst sources).

## GJEOFIZIKË (GEOPHYSICS)

- R. Liko — Vlerësimi i vëllimit të ujit të larguar gjatë kompaktësimit me anën e metodave gjeofizike të puseve në prerjen e pliocenit të rajonit Divjakë-Ballaj. .... 107  
(Estimation of extruded water volume during the compaction process by means of well geophysical works in Pliocene section of Divjakë-Ballaj region).
- K. Naska, S. Laska — Për zbatimin e metodave elektromagnetike të frekuencave të larta në vendburimin e kripës Dhrovjan. .... 119  
(The application of high frequencies electromagnetic methods in Dhrovjan salt ore deposit).

## METODIKË (METHODICS)

- R. Kamberaj — Parametri teknik i përbajtjes mesatare të mineraleve të dobishme. .... 127  
(Technical parametre of the average content of mineral ores).
- F. Diamanti — Shkëmbinjtë bituminozë në vendin tonë, disa probleme gjeologo-gjeokimike të përpunimit e të trajtimit të tyre. .... 135  
(Bituminous rocks in our country, some geological geochemical problems of their processing and treatment).
- M. Doçi — Gjurmuesit popullor të Tropojës mbështetje e shërbimit gjeologjik. .... 147  
(Amateur geologists of Tropoja — a great help to geological service).